

A

Kontrata e Përgjithshme Kombëtare për sektorin kryesor të ndërtimitarisë 2012–2015 (KPK 2012)

**Kontrata e Përgjithshme
Kombëtare për sektorin
kryesor të ndërtimitarisë**

**2012–2015
(KPK 2012)**



PALËT KONTRAKTUESE TË KPK-SË:

PËR SHOQATËN E MJESHTËVE TË NDËRTIMTARISË (SHMN)

Weinbergstrasse 49, Postfach
8042 Zürich
Telefon 044 258 81 11, Fax 044 258 83 35
www.baumeister.ch

SINDIKATËN UNIA

Weltpoststrasse 20, Postfach
3000 Bern 15
Telefon 031 350 21 11, Fax 031 350 22 11
www.unia.ch

SINDIKATËN SYNA

Römerstrasse 7, Postfach
4601 Olten
Telefon 044 279 71 71, Fax 044 279 71 72
www.syna.ch

Legjenda r fotografisë: Ura Poyat në Friburg (Curt M. Mayer)

Editues: Sindikata Unia

Kontrata e Përgjithshme Kombëtare për sektorin kryesor të ndërtimitarisë 2012–2015 (KPK 2012)

28 mars 2012

*Shoqata e Mjeshtërive të Ndërtimitarisë
Sindikata Unia
Sindikata Syna*

Tekstet

Kontrata e Përgjithshme Kombëtare për sektorin kryesor të ndërtimitarisë botohet në gjuhën gjermane, frënge dhe italiane (teksti në gjermanisht është burimor).

Shkurtesat

DO	E drejta e obligimeve (OR-CO)
KPK	Kontrata e Përgjithshme Kombëtare 2012–2015 (LMV-CN-CMN)
KPP	Kontrata e Përgjithshme e Punës (GAV-CCT)
KPP-P	Kontrata e Përgjithshme për pensionimin e mëhershëm (GAV FAR-RA-PEAN)
KZPZ	Komisioni Zvicëran Paritar i Zbatimit (SVK-CPSA)
LFSF	Ligji Federal mbi Sigurimin e Fatkeqësive (UVG-LAA-LAINF)
LKP	Ligji i kompensimit të Pagës (EO-APG-IPG)
MS	Marrëveshja shtesë
QAP	Qendra e Aftësisimit Profesional në Sursee (SHMN)
Rr	Rregullore (VO-O)
SECO	Sekretariati Shtetëror i Ekonomisë
SHMN	Shoqata e Mjeshtërve të Ndërtimitarisë (SBV-SSE-SSIC)
SPT	Sigurimi i pensionit të Pleqërisë dhe Trashëgimtarëve (AHV-AVS)
SUVA	Instituti Zvicëran i Sigurimit të Fatkeqësive
Syna	Sindikata Syna
Unia	Sindikata Unia

PS. Aty ku shkruan «ndërmarrje» mendohet në «punëdhënës» në kuptimin ligjor; në vendet ku shkruan «punonjës» mendohet «punëtor e punëtore». Në përgjithësi përdoret «punonjës».

Përmbajtja

PJESA E PARË:

Dispozitat e përgjithshme (Dispozitat mbi detyrimet e ndërsjella)

Faqe

1. Vlefshmëria (Juridiksioni)

Neni 1:	Juridiksioni territorial	9
Neni 2:	Juridiksioni ndërmarrësor	9
Neni 2 ^{deri} :	Juridiksioni ndërmarrësor për ndërmarrjet e përziera....	10
Neni 2 ^{ter} :	Korrigjimi i juridiksionit të ndërmarrjes	12
Neni 3:	Juridiksioni Personal	12
Neni 4:	Shmangia nga juridiksioni dhe kontratat për kantiere të veçanta të punës	12
Neni 5:	Shpallja e obligueshme e Kontratës për tërë degënfuqizimi	13

2. Marrëdhëniet midis palëve kontraktuese

Neni 6:	Ngritja e mëtejme profesionale.....	13
Neni 7:	Obligimi për paqe sociale	14
Neni 8:	Kostoja për zbatimin, arsimim dhe ngritjen e mëtutjeshme	14
Neni 9:	Marrëveshjet shtesë.....	16

3. Raporti me KPP-të e tjera

Neni 10:	KPP-të lokale	16
Neni 11:	Kontratat e bashkangjitura.....	17

4. Zbatimi i KPK-së

Neni 12:	Aplikimi dhe zbatimi i KPK-së	17
Neni 13:	Komisioni Zviceran Paritar i zbatimit KZPZ.....	17
Neni 13 ^{deri} :	Kompetencat dhe detyrat e KZPZ	18
Neni 14:	Gjykata Zvicerane e Arbitrazhit.....	19
Neni 15:	Procedura e ndërmjetësimit dhe pajtimit në përgjithësi	19
Neni 16:	Masat ndëshkuese	20
Neni 17:	Shfuqizohet.....	20

PJESA E DYTË:

Dispozitat e kontratës së punës (dispozitat normative)

1. Fillimi dhe përfundimi i marrëdhënies së punës

Neni 18:	Afati provues.....	21
Neni 19:	Prishja definitive e marrëdhënies së punës.....	21
Neni 20:	Dispozitat e veçanta për punëtorët stinorë dhe me leje qëndrimi afatshkurtër.....	22
Neni 21:	Mbrojtja nga largimi prej punës.....	22
Neni 22:	Mbyllja e ndërmarrjeve dhe largimi nga puna	23

2. Orari i punës

Neni 23:	Nocioni orari i punës.....	24
Neni 24:	Orari vjetor i Punës (totalj vjetor i orëve).....	24
Neni 25:	Orari javor i punës dhe puna me ndërrime	25
Neni 26:	Orët e tepërta të punës.....	27
Neni 27:	Ditët e lira të punës	27
Neni 28:	Orari i shkurtuar i punës dhe mbyllja e ndërmarrjeve gjatë motit të lig	28
Neni 29:	Shfuqizohet.....	28
Neni 30:	Shfuqizohet.....	28
Neni 31:	Shfuqizohet.....	28
Neni 32:	Shfuqizohet.....	28
Neni 33:	Shfuqizohet.....	28

3. Pushimet

Neni 34:	E drejta e përgjithshme për pushime.....	29
Neni 35:	E drejta në pushime (pro-rata)	29
Neni 36:	Përcaktimi i kohës së pushimit, shfrytëzimi i pushimit ...	29
Neni 37:	Ndalesa e kompensimit të pushimit me të holla dhe e punës gjatë pushimeve.	30

4. Festat, mungesa në punë, shërbimi ushtarak, i mbrojtjes dhe ai civil

Neni 38:	Ditët festive.....	30
Neni 39:	Mungesat e shkurtra	31
Neni 40:	Shërbimi i obligueshëm ushtarak, i mbrojtjes dhe ai civil.....	31

5. Pagesa e rrogës

Neni 41:	Rrogat bazë.....	33
Neni 42:	Kategoritë e rrogave.....	34
Neni 43:	Klasifikimi në kategoritë e rrogave.....	35
Neni 44:	Kualifikimi dhe përshtatja e rrogës	35

Neni 45:	Rregullimi i rrogës në raste të veçanta.....	35
Neni 46:	Rroga për punën në akord.....	36
Neni 47:	Pagesa e rrogës dhe mënyra e pagesës.....	36
Neni 48:	Shfuqizohet.....	36

6. Rroga e trembëdhjetë

Neni 49:	E drejta në rrogën e trembëdhjetë	36
Neni 50:	Rregullat për pagesën e rrogës	37

7. Përshatja e rrogës

Neni 51:	Parimi themelor	37
----------	-----------------------	----

8. Shtesat e rrogës

Neni 52:	Në përgjithësi	38
Neni 53:	Shfuqizohet.....	38
Neni 54:	Koha e udhëtimit	38
Neni 55:	Puna e përkohshme gjatë natës.....	38
Neni 56:	Puna të dielave.....	39
Neni 57:	Puna në ujë dhe në baltë.....	39
Neni 58:	Puna nën tokë	39

9. Shtesat, mbulimi i shpenzimeve, kompensimet

Neni 59:	Shtesa për punë të vazhdueshme natën	40
Neni 60:	Mbulimi e shpenzimeve gjatë transferimit në një vend tjetër pune, kompensimi i drekës dhe i kilometrave të kaluara	40

10. Pagesa e rrogës gjatë motit të lig (shfuqizohet)

Neni 61:	Shfuqizohet.....	40
Neni 62:	Shfuqizohet.....	40
Neni 63:	Shfuqizohet.....	40

11. Sëmundja, fatkeqësia

Neni 64:	Sigurimi i rrogës në rast të sëmundjes.....	41
Neni 65:	Sigurimi nga fatkeqësitë.....	42

12. Pagesa e mëtutjeshme e rrogës në rast vdekjeje, kompensimi me rastin e largimit nga vendi i punës, përkujdesja profesionale (shfuqizohet)

Neni 66:	Shfuqizohet.....	43
Neni 67:	Shfuqizohet.....	43
Neni 68:	Shfuqizohet.....	43

13. Të drejtat dhe obligimet e përgjithshme, masat ndëshkuese

Neni 69: Shfuqizohet.....	43
Neni 70: Ndalimi i punës në të zezë	43
Neni 71: Sjellja në kundërshtim me kontratën nga ana e punëdhënësit	44
Neni 72: Sjellja në kundërshtim me kontratën nga ana e punëtorit	44

14. Dispozita të veçanta

Neni 73: Ligji mbi bashkëveprim	45
Neni 74: Strehimi i punëtorëve, higjiena dhe rregulli në kantiere	45

PJESA E TRETË:

Dispozitat e zbatimit dhe ato përfundimtare

1. Zbatimi i dispozitave normative

Neni 75: Kompetencat	46
Neni 76: Komisionet lokale profesionale të paritetit: Formimi, kompetencat dhe detyrat	46
Neni 77: Gjyqi lokal i arbitrazhit: Krijimi dhe detyrat.....	48
Neni 78: Marrëveshja dhe arbitrazhi lokal në mes të palëve kontraktuese lokale	49
Neni 79: Masat ndëshkuese / Sanksionet	49

2. Dispozitat përfundimtare

Neni 80: Dispozitat sipas të Drejtës së Obligative	51
Neni 81: Selia juridike dhe gjyqësore	51
Neni 82: Kohëzgjatja e KPK-së	51

PJESA E KATËRT:

Shtojcat

1	Marrëveshja protokollare e KPK mbi «Kushtet e punës së shegertëve» si dhe «Të drejtën për nënshkrimin e kontratave shtesë bashkangjitura».....	
2	Marrëveshja shtesë për përshtatjen e rrogave individuale.....	
3	Shfuqizohet	
4	Shfuqizohet	
5	Marrëveshja shtesë «Bashkëveprimi në sektorin kryesor të ndërtimtarisë» «Marrëveshja për bashkëveprim».....	
6	Marrëveshja shtesë mbi strehimin e punëtorëve, higjienën dhe rregullin në kantiere «Marrëveshja për strehimin»	55
7	Marrëveshja protokollare për juridiksionin e ndërmarrësorë përputhje me nenin 2 KPK 2012–2015.....	
8	Tabela për llogaritjen procentuale të rrogës së pushimve dhe rrogës së trembëdhjetë	63
9	Rrogat bazë	
10	Udhëzues «sigurimit të rrogës në rast të sëmundjes» për sektorin kryesor të ndërtimtarisë	
11	Shfuqizohet	
12	Marrëveshja shtesë për KPK për punën nën tokë «Marrëveshja për punën nën tokë».....	67
13	Marrëveshja shtesë «Ndërtimtaria e ulët tokësore dhe ajo speciale në thellësi».....	75
14	Shfuqizohet	
15	Katalog për kriteret e klasifikimit për Kategoritë A dhe Q si dhe fletë udhëzimi i KZPZ mbi pranimin e kualifikimeve profesionale të arritura jashtë Zvicrës.....	81
16	Parimet themelore të punës me ndërrime	
17	Marrëveshja shtesë për sektorin e prerjes së betonit	87
18	Marrëveshja shtesë «Gjenevë»	

PJESA E PESTË:

Adresat e Komisioneve të Paritetit për sektorin kryesor të ndërtimtarisë

PREAMBULA

Shoqata e Mjeshtërive të Ndërtimtarisë (SHMN) nga njëra anë dhe

Sindikata Unia,
Sindikata Syna,

në anën tjetër:

me synimin

- që të sigurojnë punësim të plotë në sektorin kryesor të ndërtimtarisë dhe ruajtjen e pakufizuar të paqes sociale,
- që interesat e organizatave profesionale t'i avancojnë në favor të përgjithshëm të punëdhënësve dhe punonjësve,
- që marrëveshjet e tyre të kenë për bazë parimin e besnikërisë dhe të mirëbesimit të ndërsjellë gjatë zbatimit të tyre dhe vënies në veprim të institucioneve sociale të krijuara bashkërisht me ç'rast duhet të çmohen me mirëkuptim të plotë interesat e dyanshme,
- që t'i prosperojnë interesat e përbashkëta profesionale, siç janë:
 - shpallja dhe zbatimi bashkëkohor i ankandeve (licitacioneve),
 - punësimi i rregullt,
 - dhënia e punëve publike të ndërtimtarisë apo punëve të ndërtimtarisë që bashkëfinancohen nga buxheti shtetëror vetëm atyre ndërmarjeve, të cilat respektojnë detyrimet e Kontratës së Përgjithshme,
 - luftimin e konkurrencës së pandershme, e cila ofron çmime joserioze dhe më të ulëta nga të tjerët,
 - nxitjen e kualitetit,
 - nxitjen e arsimimit profesional,
 - rritjen e sigurisë në punë, ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit,

më 28 mars 2012, në Cyrih

Për Shoqatën e Mjeshtërive të Ndërtimtarisë (SHMN)

D. Lehmann, W. Messmer, H. Bütikofer

Për Sindikatën Unia

H.U. Scheidegger, A. Rieger, A. Kaufmann

Për Sindikatën Syna

E. Zülle, K. Regotz, P.-A. Grosjean

lidhin këtë Kontratë të Përgjithshme të Punës
(Kontrata e Përgjithshme Kombëtare):

PJESA E PARË: Dispozitat e përgjithshme

Pjesa e parë përmban obligimet e ndërsjella ligjore, të cilat rregullojnë marrëdhëniet në mes të palëve kontraktuese të KPK.

1. Vlefshmëria (Jurisdiksioni)

Neni 1 Juridiksioni territorial

1 Kontrata e Përgjithshme Kombëtare (KPK) për sektorin kryesor të ndërtimitarisë vlen në mbarë territorin e Konfederatës së Zvicrës.

2 Përjashtim bëjnë ndërmarrjet zdrukthëtare të kantoneve Freiburg, Graubunden, Vad, Valis, Neuenburg, Gjenevë, Jura dhe Jura e Bernës.

Neni 2 Juridiksioni ndërmarrësor

1 Kontrata e Përgjithshme Kombëtare (KPK) vlen për të gjitha ndërmarrjet përkatësisht pjesë të ndërmarrjeve vendore dhe të huaja të cilat kryejnë veprimtarinë e tyre në Zvicër, subndërmarrjet, akordantët e pavarur të cilat punësojnë punëtorë¹, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre kryesore, dmth. karakteristike, në degën e ndërtimitarisë kryesore.

2 Karakteristika e ndërtimitarisë kryesore është atëherë kur, një apo më shumë veprimtari të përafërta kryhen nga një ndërmarrje apo pjesë e ndërmarrjes, dmth, kryejnë kryesisht këtë punë.

- a) Ndërtimtaria e lartë dhe e ulët (përfshirë edhe ndërtimtarinë e ulët speciale), puna nëntokësore në tunel dhe ndërtimi i rrugëve (përfshirë ndërtimin e shtresës së epërme të rrugës).
- b) Gërmimi, rrënimi, ndërmarrjet e deponimit dhe të riciklimit; përjashtohen punëtoritë stacionare të riciklimit jashtë kantierit dhe të punësuarit në to.
- c) Sektorit të gurorëve si dhe të gdhendjes e shtrimit të rrugëve me gurë.
- d) Sektori i mermerit dhe granitit.
- e) Skelari, punë në fasada, ndërmarrjet e izolimit të fasadave, duke përjashtuar ndërmarrjet të cilat kryejnë veprimtarinë e veshjes e godinës. Shprehja veshja e ndërtesës përfshinë: pullazet e lakuar, pullazet e poshtëm, pullazet e rrafshëta dhe veshjet e fasadave (me ndërtimin e brendshëm për ruajtjen e ngrohjes).

¹ Si shtruesit e betonit, të hekurit muratorët etj.

- f) Ndërmarrjet e shtupimit dhe të izolimit për punët në veshjen e godinës në kuptim të gjerë dhe punë ngjashme në ndërtimin e ulët dhe ndërtimin nëntokësor.
- g) Ndërmarrjet për injektimin dhe mirëmbajtjen e betonit, ndërmarrjet e shpimit dhe të prerjes së betonit.
- h) Ndërmarrjet që kryejnë veprimtari asfaltimi dhe shtrimi të dyshe-meve.
- i) ndërmarrjet e kopshtarisë, nëse veprimtaria e tyre karakteristike është ndërtimtaria kryesore, dmth. shtrihet kryesisht në kuptimin e ndërmarrjeve me këtë sferë të veprimtarisë, si punët e ndërtimtarisë, sheshimit, punët e muratorit etj.
- j) Shfuqizohet
- k) Transporti për në kantier dhe nga kantieri. Përjashtim bëjnë furnizimi me materiale të prodhuara ndërtimore (psh. Tulla, sende betoni, hekuri i armaturës, betoni për transport dhe materiali për sipërfaqen e rrugëve etj.).
- l) Shfuqizohet

3 Listën e detajuar të veprimtarive tjera mund ta gjeni në shtojcën 7. Nëse shtojca 7 e KPK 2012–2015 përban ndryshime nga Neni 2. Jurisdiksioni i ndërmarrësor, atëherë vlen (ka përparësi) Neni 2. i ri para shtojcës 7.

4 Nëse një ndërmarrje që i nënshtrohet KPK huazon personelin për të punuar tek një ndërmarrje e tretë (ndërmarrje ndërmjetësuese), ndërmarrja që huazon punëtorë duhet t'i vërtetojë ndërmarrjes së parë se i përmbahet plotësisht kushteve të punës në përputhje me KPK.

Neni 2^{deri} Juridiksioni ndërmarrësor për ndërmarrjet e përziera

1 *Ndërmarrjet me aktivitet të përzier të vërteta dhe të pavërteta:* Parimisht dallohen ndërmarrjet e përziera pa pjesë të pavarur të ndërmarrjes (të ashtuquajtura ndërmarrje të pavërteta të përziera) si dhe ndërmarrje me pjesë të pavarur të ndërmarrjes (të ashtuquajtura ndërmarrje të përziera të vërteta).

2 *Ndërmarrjet e përziera të pavërteta, Parimi i unifikimit tarifor:* Për ndërmarrjet e përziera të pavërteta në sektorin kryesor të ndërtimtarisë vlen parimi i unifikimit tarifor. Si punonjësit e sektorëve të huaj ashtu edhe reparte të tëra të sektorëve të huaj do të evidentohen në Kontratën e Përgjithshme të Punës, të cilës i nënshtrohet ndërmarrja kryesore. Kjo do të thotë se të gjithë punëtorët parimisht i nënshtrohen Kontratës së Përgjithshme Kombëtare KPK për sektorin kryesor të ndërtimtarisë. Me këtë rast, individualisht duhet përcaktuar se cila veprimtari përcakton realisht aktivitetin e ndërmarrjes.

3 *Ndërmarrjet e përziera të pavërteta Përcaktimi i aktivitetit kryesor:* Kriteri kryesor për përcaktimin e aktivitetit kryesor të ndërmarrjes parimisht është numri i orëve të punuara në raport me aktivitetin në të cilin kryhet ky verifikim. Nëse ky përcaktim nuk është i mundur për ndonjë arsye, atëherë si alternativë merret parasysh përqindja e vendeve të punës. Nëse edhe nga ky verifikim nuk arrihet deri tek ndonjë rezultat i qartë atëherë do të merren parasysh kriteret ndihmëse si qarkullimi dhe fitimi, bartja në regjistrin tregtar dhe anëtarësia në shoqatën e punëdhënësve.

4 *Ndërmarrjet e përziera të pavërteta, Kriteret:* Një ndërmarrje e përzier e pavërtetë në sektorin kryesor të ndërtimitarisë kryen aktivitetin në së paku një sektor që nuk i takon sektorit kryesor të ndërtimitarisë. Një ndërmarrje është e përzier e pavërtetë nëse i përmban shumicën e elementeve në vijim:

- a) Punëtorët veç e veç nuk mund të jenë qartë të përfshirë në një pjesë të ndërmarrjes;
- b) Puna e pjesës së ndërmarrjes të sektorit të huaj në raport me aktivitetin tjetër të ndërmarrjes ka karakter ndihmës në kuadrin e përgjithshëm të ndërmarrjes;
- c) Pjesa e ndërmarrjes me aktivitet të sektorit të huaj nuk shfaqet si ofertues i pavarur në treg;
- d) Pjesët veç e veç të ndërmarrjes nuk mund të njihen nga jashtë si të tilla.

5 *Ndërmarrjet e përziera të vërteta. Kriteret:* Ndërmarrjet e përziera të vërteta i posedojnë dy apo më shumë pjesë të ndërmarrjes të pavarura. Një pjesë e pavarur e ndërmarrjes është atëherë kur plotësohen këto kushte të gjitha së bashku:

- a) Punëtorët veç e veç mund të jenë qartë të përfshirë në një pjesë të ndërmarrjes, ata krijojnë kështu një njësi të veçantë organizative;
- b) Puna e pjesës së ndërmarrjes të sektorit të huaj në raport me aktivitetin tjetër të ndërmarrjes nuk kanë vetëm karakter ndihmës;
- c) Pjesa e ndërmarrjes me aktivitet të sektorit të huaj nuk shfaqet si ofertues i pavarur në treg;
- d) Pjesët e veçanta të ndërmarrjes mund të njihen nga jashtë si të tilla.

6 *Ndërmarrjet e përziera të vërteta, Përfashtime nga parimi i unifikimit tarifor:* Tek ndërmarrjet e përziera të vërteta, sipas paragrafit 5 vjen deri tek shkelja e parimit të unifikimit tarifor. Për pjesën e pavarur, të ndërmarrjes me aktivitet të sektorit të huaj, si dhe për të gjithë punëtorët e saj vlen KPP për sektorin gjegjës. Për pjesën e ndërmarrjes me aktivitet të sektorit kryesor të ndërtimitarisë zbatohet Kontrata e Përgjithshme Kombëtare KPK për sektorin kryesor të ndërtimitarisë.

7 Karakteri i ndërmarrjes bazohet në llojin e veprimtarisë së ndërmarrjes apo të pjesës së pavarur të ndërmarrjes dhe shprehet në këtë mënyrë:

1. Në radhë të parë do të shikohet kriteri i «Angazhimit të llogaritur në orë pune në lidhje me veprimtarinë në degët përkatëse»;
2. Nëse ky klasifikim është i pamundur për shkaqe të ndryshme, si formë alternative do të shikohet përqindja e angazhimit në vendin e punës;
3. Nëse edhe në këtë rast nuk arrihet një rezultat i qartë, do të konsultohen kritere ndihmëse si qarkullimi dhe fitimi, bartja në regjistrin tregtar dhe anëtarësia në shoqatën e punëdhënësve.

Neni 2^{ter} Korrigjimi i juridiksionit të ndërmarrjes

Nëse sfera e juridiksionit është në kundërshtim me Kontratat tjera të Përgjithshme të Punës atëherë është e domosdoshme një marrëveshje e kufizimit me të gjitha palët kontraktuese e cila krijon qartësi.

Neni 3 Juridiksioni Personal

1 KPK vlen për punëtorët e punësuar në ndërmarrje sipas Nenit 2 të KPK (pa marrë parasysh mënyrën e pagesës dhe vendin e punësimit), të punësuar në kantiere ndërtimtarie dhe në ndërmarrjet ndihmëse të ndërmarrjeve ndërtimore. Për punëtorët që janë duke marrë zanat, pa marrë parasysh moshën e tyre, vlen shtojca 1 e KPK. Personeli i kanti-nës dhe i pastrimit i nënshtrohet juridiksionit të kësaj kontrate nëse nuk i është nënshtruar Kontratave të Përgjithshme të Punës të zyrtarizuara për sektorin e hotelierisë si dhe të personelit të pastrimit.

2 Përjashtim bëjnë (këtu nuk përfshihen):

- a) udhëheqësi i kantierit (gj. Poliri) si dhe mjeshtri i punëtorisë;
- b) personeli udhëheqës;
- c) personeli teknik dhe administrativ.

Neni 4 Shmangia nga juridiksioni dhe kontratat për kantiere të veçanta të punës

1 Nëse në disa pjesë lokale që përfshihen nga KPP-të në bazë të rrethanave të veçanta është e domosdoshme të hiqet dorë nga KPK-ja, palët kontraktuese të KPK-së kanë të drejtë që palët lokale t' i lirojnë nga respektimi i pjesëve të veçanta të KPK-së.

2 Nëse KPP-të lokale të cilat për shkak të rrethanave të veçanta gjeografike dhe klimatike si dhe kantiere të mëdha, ku puna zakonisht zgjat shumë, marrëdhëniet në punë i rregullojnë në mënyrë të pamjaftu-

eshme apo kur bëhet fjalë për rrethana të veçanta, atëherë palët kontraktuese lokale mund të lidhin marrëveshje të tjera.

3 Nëse është fjala për një kantier me interes kombëtar, palët kontraktuese të KPK-së mund të hartojnë një marrëveshje shtesë që nuk është në përputhje me KPK-në.

Neni 5 Shpallja e obligueshme-fuqizimi

Marrëveshjet e reja shtesë, sidomos ato mbi shtimin e rrogave, parimisht hyjnë në fuqi më 1 janar të vitit vijues bashkë me shpalljen të obligueshme të kontratës për të gjithë-fuqizimi. Palët kontraktuese të KPK-së angazhohen me vendosmëri që deklarata mbi detyrimet e përgjithshme gjithashtu të jetë e gatshme për t'u fuqizuar më 1 janar. Më tejherë pas lidhjes së marrëveshjes palët kontraktuese paraqesin kërkesë për Fuqizim e shpalljes së obligueshme-fuqizimi.

2. Marrëdhëniet midis palëve kontraktuese

Neni 6 Ngritja e mëtejme profesionale

1 Palët kontraktuese përkrahin dhe ndihmojnë arsimimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve të sektorit kryesor të ndërtimitarisë. Përmes organeve të tyre këto organizata informojnë mbi mundësitë e arsimimit të vazhdueshëm profesional, kurse punëdhënësve dhe punëtorëve u preferojnë që arsimimit të vazhdueshëm profesional t'i kushtojnë rëndësinë e duhur. Punëtorët që janë të aftë dhe të gatshëm për t'u arsimuar më tutje duhet të kenë mundësi që këtë ta bëjnë përmes kurseve të arsimimit fillestar dhe atij të mëturshëm.

2 Me qëllim të nxitjes së arsimimit të vazhdueshëm profesional punëtorët kanë të drejtë për çdo vit të shfrytëzojnë më së shumti pesë ditë pune për të ndjekur ndonjë kurs mbi arsimimin e vazhdueshëm profesional. Gjatë këtyre ditëve ata janë të lirë nga puna në ndërmarrje. Lirimin nga puna parimisht duhet kuptuar si ditë të lira pa pagesë dhe shpenzimet nuk hiqen nga punëdhënësit. Punëtorët duhet të dëshmojnë se kanë ndjekur me rregull kursin për arsimimin e vazhdueshëm profesional dhe duhet të caktojnë me kohë afatin e lirimit nga puna, duke pasur parasysh nevojën e punëdhënësit dhe marrëveshjen para-prake me të.

3 Ndjekjes së kurseve për arsimimin e vazhdueshëm profesional me pjesëmarrjen financiare të punëdhënësit (pagesa e plotë apo e pjeshme e rrogës respektivisht shpenzimeve të kursit) duhet t'i paraprijë dhënia e pëlqimit nga punëdhënësi. Në raste të tilla punëdhënësi dhe punëtori gjithmonë merren vesh mes veti mbi kohëzgjatjen dhe datën e ndjekjes respektivisht fillimit të kursit si dhe për kontributin e punëdhënësit, duke pasur parasysh mundësitë financiare Fondi paritar për ndërtimtari (Parifondi) dhe institucioneve të tjera të ngjashme të paritetit.

4 Me mbaroni me sukses një kursi për arsimimin e vazhdueshëm profesional punëtori nuk e fiton të drejtën që automatikisht të punësohet në atë kategori që i përgjigjet aftësive të tij profesionale.

Neni 7 Obligimi për paqe sociale

1 Në përpjekje për të ruajtur paqen sociale, e cila është në interes të mbarë ekonomisë zvicerane, palët kontraktuese të KPK-së të gjitha mosmarrëveshjet dhe kundërshtimet e mundshme duhet t'i zgjidhin me *besnikëri dhe mirëbesim* të ndërsjellë. Zgjidhjen duhet kërkuar gjithnjë duke u bazuar në dispozitat mbi zbatimin e KPK-së.

2 Palët kontraktuese zotohen që së bashku me seksionet dhe anëtarët e vetë do të ruajnë paqen sociale gjatë gjithë kohëzgjatjes së obligimeve nga kjo kontrate, duke u bazuar në nenin 357a paragrafi 2 të së Drejtës së Obligimeve. Për pasojë ndalohet çdo përpjekje për grevë, kërcënim me grevë, thirrje për grevë, kundërshtim pasiv si dhe çdo ndëshkim masiv dhe masa të tjera kundërshtuese si p.sh. bllokimi i punës apo largimi i punëtorëve.

Neni 8 Kostoja për zbatimin, arsimim dhe ngritjen e mëtutjeshme

1 *Fondi i paritetit për ndërtimtari*: Fondi i paritetit për ndërtimtari i (Parifond-Bau) themeluar nga palët kontraktuese të KPK-së është kompetent për mbledhjen dhe administrimin e kostos, zbatimin dhe kontributet për arsimimin dhe ngritjen e mëtutjeshme dhe ka formën ligjore të një shoqate.

2 *Jurisdiksioni*: Fondit të paritetit për ndërtimtarinë në aspektin hapësinor, personal dhe të ndërmarrjeve i nënshtrohen të gjithë punëdhënësit dhe punëmarrësit e punësuar, përfshirë edhe nxënësit, në ndërmarrjet që bien nën juridiksionin e Kontratës së Përgjithshme Kombëtare. Nga kjo përjashton ndërmarrjet për përfitimin e rërës dhe të zhavorrit. Po ashtu përjashtohen edhe kantonet, përkatësisht rajonet nën juridiksionin e Kontratës Gjenevë, Nojshatel, Tesinë, Vadit dhe Valis. Marrëveshjet ekzistuese kantonale shtesë për fondet sociale të pari-

tetit mbeten në fuqi. Poqese Fondi i paritetit të ndërtimtarisë bëhet përgjithësisht i detyrueshëm, juridiksioni i saj varet nga përcaktimet përkatëse të Shpallja e obligueshme-fuqizimi.

3 *Qëllimi i Fondit të paritetit për ndërtimtarinë:* Fondi i paritetit për ndërtimtarinë në njërën anë synon mbulimin e shpenzimeve për zbatimin e KPK (përfshirë edhe KPP) si dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera kryesisht me karakter social. Në anën tjetër, Fondi i paritetit për ndërtimtarinë synon rekrutimin dhe promovimin profesionistëve të rinj, promovimin e arsimimit dhe ngritjes së mëtutjeshme si dhe përkrahjen e masave për shmangien e fatkeqësive dhe të sëmundjeve profesionale.

^{3deri}Shfuqizohet

4 *Kontributet:* Të gjithë punëmarrësit nën juridiksionin e KPK, përfshirë edhe nxënësit, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre në shoqata, duhet të paguajnë një kontribut prej 0.55% të pagës së tyre të obligueshme sipas Ligjit për sigurimin e fatkeqësive² për zbatimin si dhe arsimimin e ngritjen e mëtutjeshëm. Punëmarrësi kujdeset për ndalesat dhe për bartjen e kontributeve në Fondin e paritetit për ndërtimtarin. Punëmarrësit nën juridiksionin e KPK-së, për zbatimin dhe arsimimin e ngritjen e mëtutjeshme do të paguajnë një kontribut prej 0.4% të pagës së obligueshme sipas LFSF për punëmarrësit nën juridiksionin e KPK-së, përfshirë edhe nxënësit. Punëmarrësit që zhvillojnë veprimtarinë e tyre deri në 90 ditë në Zvicër, do të paguajnë kontributet në lartësi 0.3% të pagës së obligueshme sipas LFSF (0.25% kontributi i punëmarrësit dhe 0.25% kontributi i punëdhënësit) për punëmarrësit që janë nën juridiksionin e KPK-së, përfshirë edhe nxënësit, së paku CHF 20.– në muaj dhe për punëdhënësit.

^{4deri}Rregullimi i kontributeve të sipërpërmendura (Neni 8, par. 4), do të verifikohet nga palët kontraktuese rregullisht (së paku njëherë në vit). Nëse konstatohet se vlera e përgjithshme e Fondit të paritetit për ndërtimtarinë do të bie apo ka rënë në nivelin e gjysmës së domosdoshme për nevojat vjetore, palët kontraktuese e rivlerësojnë menjëherë situatën dhe ujdisen për një përshtatje të pranueshme të kontributeve, me kusht që të ruhet raporti i deriatëhershëm prej 0.7 për punëmarrësit dhe 0.5 për punëdhënësit (në rast të punëdhënësve të huaj, raporti do të jetë pesë [5] për punëmarrësin dhe një [1] për punëdhënësin). Ndryshimi i kontributeve hyn në fuqi në vitin e ardhshëm kalendarik.

5 *Rregullat e zbatimit:* Hollësit si organizimi në shoqata, shfrytëzimi i mjeteve, rregullimi i kontributeve dhe zbatimi (Rregullat e zbatimit) do

² Kjo është e me shumën e pagës sipas SUVA.

të rregullohen në statutin e shoqatës dhe rregulloret e Fondit të paritetit për ndërtimtarinë. Statuti i Shoqatës dhe rregulloret janë pjesë përbërëse e Kontratës së Përgjithshme Kombëtare.

6 Kohëzgjatja dhe shuarja e Fondit të paritetit për ndërtimtari: Fondi i paritetit për ndërtimtarinë përkatësisht Neni 8 i KPK hyn në fuqi më 1 janar 2010 dhe parimisht varet nga kohëzgjatja e KPK-së. Nëse eventualisht Kontrata e Përgjithshme Kombëtare shfuqizohet, Fondi i paritetit për ndërtimtarinë megjithatë vazhdon të mbetet në fuqi, dmth. të gjithë punëmarrësit nën juridiksionin e KPK-së, përfshirë edhe nxënësit si dhe ndërmarrjet nën këtë juridiksion, do të vazhdojnë të paguajnë kontributet e përcaktuara sipas kuptimit të shtojcës 4 të këtij Neni, për Fondin e paritetit. Mirëpo, Fondi i paritetit për ndërtimtari mund të shuhet nga secila palë e KPK-së përmes njoftimit me shkrim për ndërprerje, si në vijim:

- a) Në muajin e parë pas shfuqizimit të KPK-së në fund të muajit pasardhës;
- b) Që nga muaji i dytë pas shfuqizimit të KPK-së, pas një afati tremujor për ndërprerje në fund të muajit.

Neni 9 Marrëveshjet shtesë

Në qoftë se palët kontraktuese të KPK-së miratojnë marrëveshje shtesë respektivisht protokollare, atëherë edhe këto janë pjesë përbërëse dhe integrale të KPK-së.

3. Raportet me KPP-të e tjera

Neni 10 KPP-të lokale

1 KPP-të lokale mund të përmbajnë rregulla specifike për hapësirën e tyre kontraktuese. Për të qenë të vlefshme ato duhet të nënshkruhen nga palët kontraktuese të KPK. Ky kusht vlen si për përfundimin e një KPP të re lokale, ashtu edhe për ndryshimin e saj, duke përfshirë përshtatjet në ndryshimet e KPK-së.

2 Të gjitha palët kontraktuese të KPK-së kanë të drejtë të jenë gjithashtu edhe palë kontraktuese për KPP-të lokale.

3 KPP-të lokale në përbërjen e tyre duhet të kenë këtë përmbajtje të obligueshme:

- a) Përshkrimi i hapësirës së vlefshmërisë, duke respektuar nenin 1 të KPK-së;
- b) Zbatimin e kontratës si dhe zgjidhjen e dallimeve sidomos gjatë emërimit të komisionit të paritetit

- c) Shfuqizohet
- d) përcaktimin e ditëve të paguara të festave (neni 38 KPK)
- e) dispozita më të sakta mbi pagesën e drekës (neni 60 KPK) dhe kohën e udhëtimit (neni 54 KPK).

4 Për sa i përket përmbajtjes, e cila nuk përmendet në nenin 10 paragrafi 3 KPK, në KPP-të lokale mund të ketë marrëveshje dhe përcaktime të mëtutjeshme vetëm me pëlqimin e palëve kontraktuese të KPK-së. Për kantiere të veçanta të punës vlen neni 4 i KPK-së.

5 Po qe se palët lokale kontraktuese nuk arrijnë marrëveshje për një Kontratë të përgjithshme lokale, atëherë ato duhet t'u drejtohen palëve kontraktuese të KPK-së. Palët kontraktuese të KPK-së luajnë rol ndërmjetësues.

Neni 11 Kontratat e bashkangjitura

1 Organizatat e punonjësve i vënë vetes për detyrë që në interes të palëve kontraktuese të kujdesen që KPP-të lokale të nënshkruhen dhe të respektohen edhe nga ndërmarrjet e huaja dhe ato të cilat nuk janë të organizuara në regjionet ku janë në fuqi KPP-të lokale.

2 Marrëveshja protokollare (shih shtojcën nr. 1) përcakton të drejtën e palëve kontraktuese të KPK-së për miratimin e kontratave të bashkangjitura me organizatat e tjera.

3 Palëve kontraktuese të KPK-së dhe seksioneve të tyre u ndalohet shprehimisht që të lidhin KPP të njëjta apo të ndryshme me ndonjë organizatë, e cila nuk përmendet në marrëveshjen protokollare sipas nenit 2. Shmangia nga kjo marrëveshje mund të bëhet vetëm me pëlqimin e ndërsjellë të palëve kontraktuese të KPK-së.

4. Zbatimi i KPK-së

Neni 12 Aplikimi dhe zbatimi i KPK-së

1 Palët kontraktuese të KPK-së zotohen për vete, seksionet dhe anëtarët e tyre që të respektojnë dispozitat e kësaj kontrate si dhe të KPP-ve lokale.

2 Për realizimin dhe zbatimin e KPK-së kujdesen palët kontraktuese të KPK-së (shih dispozitat nën nenin 75 deri 79 të KPK-së).

Neni 13 Komisioni Zviceran Paritar i Zbatimit KZPZ

1 Me qëllim të realizimit dhe zbatimit të KPK-së gjatë tërë kohëzgjatjes së plotfuqishmërisë palët kontraktuese të KPK-së formojnë KZPZ,

i cili përbëhet nga shtatë përfaqësues të Organizatës së punëdhënësve dhe të Organizatës së punonjësve që bëjnë pjesë në KPK.

2 Organizatat e punonjësve janë të përfaqësuara në KZPZ si vijon: katër përfaqësues të Sindikatës Unia dhe tre përfaqësues të Sindikatës Syna.

2^{deri} KZPZ delegon detyrat të cilat nuk janë të rezervuara vetëm për këtë komision punues, një komisioni të përbërë nga gjashtë anëtarë të komisionit KZPZ. Organizatat e punonjësve janë të përfaqësuara si në vijim: Dy përfaqësues të Sindikatës UNIA dhe një përfaqësues i Sindikatës Syna.

3 KZPZ konstituohet vetvetiu dhe harton rregulloren.

Neni 13^{deri} Kompetencat dhe detyrimet e KZPZ

1 Komisioni Zviceran Paritar i zbatimit KZPZ si komision i përgjithshëm vendos mbi interpretimin e çështjeve të përgjithshme të KPK-së dhe çështjet e rëndësisë mbarë zvicerane, në rast se komisioni punues sipas nenit 2^{deri} nuk arrin pajtueshmëri të plotë.

2 Shfuqizohet

3 KZPZ lëshon udhëzime të përgjithshme në lidhje me plotësimin e detyrave të zbatimit dhe u raporton në lidhje me të Komisioneve Profesionale lokale të Paritetit.

4 Komisioni punues ka autorizim për koordinimin dhe përkrahjen e aktivitetit të Komisionit profesional të paritetit si dhe shkollim e këshillim gjatë zbatimit të KPK-së. Komisioni punues vendos mbi çështjet e autorizimit në mes të komisioneve profesionale të paritetit dhe ka mundësi të lëshojë udhëzime në raste të veçanta. Komisioni punues është i autorizuar të bëjë kontroll mbi aktivitetin e komisioneve profesionale të paritetit dhe të koordinojë zbatimin e KPK-së me organet tjera të zbatimit dhe entet federale si dhe me organet tjera jashtë vendit.

5 Në rast të mospajtimeve të pakalueshme në KZPZ çështja do t'u dërgohet brenda një afati të arsyeshëm palëve kontraktuese për trajtim si dhe vendim të çështjes.

6 KZPZ formon një sekretariat të përhershëm të KZPZ-së.

Neni 14 Gjykata Zvicerane e Arbitrazhit

1 Me qëllim të realizimit dhe zbatimit të KPK-së palët kontraktuese të KPK-së formojnë një Gjyq të Arbitrazhit. Gjyqi i Arbitrazhit përbëhet nga:

- a) një gjyqtar profesional si kryetar dhe
- b) nga katër gjyqtarë profesional të arbitrazhit, të cilët emërohen nga palët kontraktuese të KPK-së.

2 Kryetari i Gjyqit të Arbitrazhit emërohet nga palët kontraktuese të KPK-së gjatë gjithë kohëzgjatjes së plotfuqishmërisë së kontratës. Nëse palët kontraktuese nuk pajtohen mbi emërimin e tij, atëherë me emërimin e kryetarit ngarkohet Gjyqi i Lartë i Kantonit të Cyrihut, i cili gjatë marrjes së vendimit do t'i ketë parasysh edhe propozimet eventuale të parashtruara nga palët kontraktuese.

3 Gjyqtarët profesional të arbitrazhit nga palët kontraktuese të KPK-së rriemërohen pas çdo procesi të arbitrazhit. (Ri)emërimi i tyre duhet të bëhet brenda 30 ditëve pas krijimit të Gjyqit të Arbitrazhit. Organizatat e punonjësve duhet të merren vesh mes veti nga rasti në rast mbi emërimin e gjyqtarëve të tyre të arbitrazhit. Parimisht është e nevojshme që secila organizatë e punonjësve të jetë e përfaqësuar me nga një gjyqtar të arbitrazhit.

4 Selia e përhershme e Gjyqit të Arbitrazhit është në Cyrih. Veprimtaria e Gjyqit të Arbitrazhit bazohet në marrëveshjet ndërkantonale mbi arbitrazhin gjyqësor dhe dispozitat e proceseve civile të kantonit të Cyrih-ut.

Neni 15 Procedura e ndërmjetësimit dhe pajtimit në përgjithësi

1 Mospajtimet dhe mosparrëveshjet në mes të palëve kontraktuese të KPK-së mbi zbatimin dhe interpretimin e çështjeve, të cilat janë të rregulluara në KPK apo pjesë e një marrëveshje plotësuese integrale mund t'i dërgohen KZPZ. Nëse nuk arrihet pajtueshmëri në KZPZ e as përmes procedurës sipas nenit 13^{deri} paragrafi 5 e KPK-së çështja mund të dërgohet te Gjyqi i Arbitrazhit.

2 Nëse nuk arrihet ndonjë marrëveshje apo nëse njëra palë e hedh poshtë propozimin për ndërmjetësim të KZPZ-së, atëherë gjithë rasti, bashkë me kërkesën me shkrim dhe të argumentuar, në afat prej 30 ditësh, bartet në Gjyqin e Arbitrazhit sipas nenit 14 të KPK-së (për mospajtimet lidhur me përshtatjen e rrogës në përputhje me shtrenjtimin vlen neni 51 i KPK-së). Vendimi i Gjyqit të Arbitrazhit është përfundimtar përveç në rastet e paraqitjes së kërkesës për anulim të vendimit gjyqësor.

3 Paditë kundër shkeljes së lojalitetit në punë nga ndonjë organizatë që është nënshkruese e kësaj kontrate duhet t'i parashtrohen drejtpërdrejt Gjyqit të Arbitrazhit, por duke hequr dorë nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni. Gjyqi i Arbitrazhit ka të drejtë që në bazë të vlerësimit të lirë të aprovojë të gjitha masat dhe urdhëresat, të cilat ai i konsideron të domosdoshme.

4 Gjatë kohëzgjatjes së procesit para KZPZ-së dhe para Gjyqit të Arbitrazhit është i ndaluar çdo diskutim publik mbi rrjedhën dhe përmbytjen e seancave. Informimi real i anëtarëve është i lejuar.

Neni 16 Masat ndëshkuese

1 Në rastet e shkeljes së kontratës Gjyqi i Arbitrazhit shqipton dënim ndaj palës fajtoare duke u mbështetur në marrëveshjen konvencionale. Lartësia e dënimit varet nga dimensionin e shkeljes dhe kap shumën minimale prej CHF 15.000.-.

2 Për shkelje të rëndë të kontratës Gjyqi i Arbitrazhit palës së dëmtuar – në rast se paraqitet kërkesa – mund t'i ndajë edhe dëmshpërblim. Me këtë rast duhet pasur parasysh rrethanat dhe dimensionin e shkeljes së kontratës.

3 Dënimi sipas marrëveshjes konvencionale, dëmshpërblimi dhe shpenzimet e ngarkuara nga procesi duhet të paguhet brenda 30 ditëve pas plotfuqishmërisë së vendimit gjyqësor.

Neni 17 Shfuqizohet

Pjesa e dytë: Dispozitat kontratës së punës

Kjo pjesë përmban dispozita normative, të cilat janë pjesë përbërëse e kontratës mes punëdhënësit dhe punëtorit.

1. Fillimi dhe përfundimi i marrëdhënies së punës

Neni 18 Afati provues

1 Për punëtorët që punësohen për herë të parë në ndërmarrje është paraparë që afati provues të jetë gjatë dy muajve të parë. Afati provues mund të zgjatet në marrëveshje me shkrim (maksimalisht një muaj).

2 Shfuqizohet

3 Gjatë afatit provues marrëdhënia e punës mund të prishet çdo ditë nga të dy palët, duke iu përmbajtur këtu afatit pesëditor të punës.

Neni 19 Prishja definitive e marrëdhënies së punës

1 Pas skadimit të afatit provues marrëdhënia e përhershme e punës mund të prishet nga të dyja palët pavarësisht a punon punëtori me rrogë mujore apo me orë dhe atë si vijon:

- a) në vitin e parë të punësimit, respektivisht në rast të marrëdhënies së pakufizuar sezonale të punës prej gjithsejtë jo më pak nën 12 muaj kohëzgjatje, duke iu përmbajtur afatit për prishjen e kontratës prej një muaji, në fund të muajit përkatës.
- b) prej vitit të dytë deri në vitin e nëntë të punësimit, respektivisht në rast të marrëdhënies së pakufizuar sezonale të punës prej gjithsejtë jo më shumë se 12 muaj kohëzgjatje, duke iu përmbajtur afatit për prishjen e kontratës prej dy muajsh me përfundim në fund të çdo muaji.
- c) nga viti i dhjetë i punësimit duke iu përmbajtur afatit për prishjen e kontratës prej tre muajsh, në fund të muajit përkatës.

1^{deri} Për punëmarrësit që kanë mbushur moshën 55 vjet, afati i paralamërim të ndërprerjes në vitin e parë të punës, një muaj pas përfundimit të kohës provuese, prej vitit të 2 deri në vitin e 9 të punësimit, katër muaj dhe prej vitit të 10 të punësimit, gjashtë muaj.

2 Afatet për prishjen e kontratave sipas nenit 19 paragrafi 1 dhe shtojca 1^{deri} të KPK-së nuk guxojnë të ndryshohen (shkurtohen) në dëm të punëtorit.

3 Shfuqizohet

4 Shfuqizohet

5 Nëse gjatë vitit vijues ekziston e drejta e pensionimit sipas Kontrata e përgjithshme kolektive për pensionimin e mëhershëm (FAR-RA-PEAN), atëherë palët pajtohen në formë të shkruar deri në mesin e vitit të mëparshëm për kontributet e tërhequra dhe njoftojnë për të fondacionin e paritetit. Me fillimin e tërheqjes së kontributeve pensionale marrëdhënia e punës përfundon automatikisht. Nëse në ndërkohë të dy palët heqin dorë nga kontributet, atëherë marrëdhënia e punës vazhdon.

Neni 20 Dispozitat e veçanta për punëtorët stinorë dhe me leje qëndrimi afatshkurtër

1 Punëdhënësit informojnë punëtorët stinorë dhe punëtorët me lejeqëndrim afatshkurtër me kohë, parimisht katër javë paraprakisht, e së paku 14 ditë para përfundimit të sezonit, dhe pas vlerësimit të vëllimit të punës, mbi mundësinë e punësimit të serishëm në sezonin e ardhshëm. Punëtorët stinorë që për shkak të kualifikimit të pamjaftueshëm apo mungesës së punës nuk mund të punësohen në të ardhmen, duhet të informohen me shkrim. Me këtë rast duhet pasur parasysh dispozitat eventuale ligjore.

2 Punëdhënësit angazhohen që gjatë dhënies së vendeve të punës përparësi të kenë punëtorët e deritanishëm stinorë dhe me lejeqëndrim afatshkurtër para punëtorëve të rinj stinorë e me lejeqëndrim afatshkurtër me kualifikim dhe gatishmëri të njëjtë për punë. Punëtorët stinorë dhe punëtorët me lejeqëndrim afatshkurtër të punësuar deri më tani, të cilët në sezonin e ardhshme nuk duan të punojnë në ndërmarrjen e njëjtë, janë të obliguar që ta informojnë gjithashtu me kohë punëdhënësin e deritanishëm.

3 Nga informatat sipas kuptimit të nenit 20 paragrafi 1 dhe 2 e KPK-së, respektivisht lënies pasdore të këtyre informatave, nuk mund të kërkohet kurrfarë e drejte, sidomos kërkesa për pagesën e rrogës.

4 Nëse komisionet lokale të paritetit konstatojnë keqpërdorime evidente, atëherë pason lajmërimi tek enti kantonal, i cili ka bërë lëshimin e lejes së punës

5 Shfuqizohet

Neni 21 Mbrojtja nga largimi prej punës

1 *Parimi themelor:* Prishja e marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit pas skadimit të afatit provues përveç në rastet e kushtëzuara sipas kuptimit nenit 21 paragrafi 2 dhe 3, është e ndaluar derisa sigurimi

i pagës ditore apo sigurimi i obligueshëm i fatkeqësisë paguajnë rrogë për punëtorin përkatës.

2 *Paga ditore dhe pensioni invalidor*: Nëse përveç mëditjeve nga sigurimi punëtori merr edhe pension të sigurimit invalidor, atëherë lejohet largimi i tij nga puna prej datës kur fillon e drejta në pension invalidor, duke iu përmbajtur afateve të rregullta për prishjen e kontratës.

3 *Sëmundja pas largimit nga puna*: Në rastet kur punëtori sëmuret gjatë kohëzgjatjes së afatit për largim nga puna, rrjedha e mëtutjeshme e këtij afati ndërpritet sipas nenit 336e paragrafi 2 Drejtës obligative. Nëse nuk kemi të bëjmë me rishfaqje të sëmundjes së mëhershme, rrjedha e mëtutjeshme e afatit ndërpritet si vijon: në vitin e parë të punësimit maksimalisht 30 ditë, në vitin e dytë deri në vitin e pestë të punësimit maksimalisht 90 ditë dhe nga viti i gjashtë i punësimit maksimalisht 180 ditë. Në rastet kur afati përfundimtar (parimisht në fund të muajit) nuk përputhet me afatin e zgjatur të largimit nga puna, atëherë ky afat shtyhet deri në afatin tjetër përfundimtar në fund të muajit të ardhshëm.

4 *Fatkeqësia pas largimit nga puna*: Nëse punëtori pëson fatkeqësi pas marrjes së vendimit për largim nga puna, rrjedha e mëtutjeshme e afatit ndërpritet derisa sigurimi i obligueshëm i fatkeqësisë është duke paguar rrogë.

5 *Largimi nga puna në rastet kur saldoja e orëve fleksibile është pozitive*: Nëse në kohën e marrjes së vendimit për largim nga puna ekziston një saldo pozitive e orëve fleksibile dhe nëse kjo saldo nuk mund të shfrytëzohet në muajin e parë të afatit për largim nga puna, atëherë afati për largim shtyhet për një muaj.

6 Largimi nga puna nuk guxon të bëhet, nëse kjo ndodhë vetëm për faktin se punëtori është bartës i zgjedhur i detyrave në sindikatë si delegat apo funksion tjetër. Këtu vlejnë edhe nenet 336, 336 a dhe 336 b të së Drejtës Obligative.

Neni 22 Mbyllja e ndërmarrjeve dhe largimi nga puna

Kalimi i ndërmarrjes në pronësi të tjetërkujt, mbyllja e ndërmarrjeve dhe largimi masiv nga puna janë të rregulluara në marrëveshjen mbi «Bashkëveprimin në sektorin kryesor të ndërtimtarisë», (shih shtojcën nr. 5). Kjo marrëveshje është pjesë përbërëse dhe integrale e KPK-së.

2. Orari i punës

Neni 23 Nocioni orari i punës

- 1 Si orar i punës vlen koha gjatë së cilës punëtorët duhet të jenë në dispozicion të punëdhënësit.
- 2 Si orar i punës nuk llogaritet:
 - a) rruga për në vendin e punës dhe anasjelltas. Sa i përket kohës së udhëtimit vlen neni 54 i KPK-së.
 - b) Pauza e orës 9.00 me ndërprerje të paraparë të punës.
- 3 Një kontratë e punës me orar të reduktuar duhet të rregullohet me shkrim. Kontrata duhet të përmbajë pjesën e orëve nga orari vjetor i punës. Pjesa e orarit javor të punës pa pagesë shtesë si dhe orët e llogaritura për arsye të festave, pushimit, sëmundjes, fatkeqësisë etj duhet të llogariten dhe të reduktohen.

Neni 24 Orari vjetor i Punës (shuma vjetore e orëve)

- 1 Orari vjetor i punës është orari i parashikuar bruto në vitin kalendarik, gjatë së cilit punëtori është në dispozicion të punëdhënësit dhe para zbritjes së orëve të përgjithshme gjatë së cilave nuk punohet, siç janë festat e paguara dhe orët e mungesës individuale, siç janë pushimet, sëmundja, fatkeqësia, ditët e shërbimit etj.
- 2 Shuma orientuese e orëve vjetore të punës është për gjithë hapësirën kontraktuese 2112 orë (365 ditë : 7 = 52,14 javë x 40,5 orë).
- 3 Për festat, pushimet si dhe mungesat individuale për arsye të sëmundjes, fatkeqësisë dhe mungesat të tjera shuma e orëve për ditë do të llogaritet sipas kalendarit vjetor ekzistues të punës në ndërmarrje gjegjësisht sipas kalendarit seksional të punës në fuqi në vendin e ndërmarrjes.
- 3^{deri} Në rast të fillimit apo mbarimit të marrëdhënies së punës gjatë vitit, llogaritet orari i punës proporcionalisht sipas kalendarit të orarit të punës në nivel të ndërmarrjes apo të seksionit. Për të punësuarit me rrogë mujore në rast largimi i llogariten edhe pjesa e orëve të vitit në përputhje me paragrafin 2 si shtesë e rrogës në orë.
- 4 Për orarin ditor, javor dhe mujor punëdhënësi duhet të mbajë një kontroll të detajuar.

Neni 25 Orari javor i punës dhe puna me ndërrime

1 Orari javor i punës (orari normal i punës): Orari javor i punës përcaktohet më së voni deri në fund të vitit nga ndërmarrja duke u bazuar në të dhënat sipas pikës 2. Palët kontraktuese hartojnë dhe vënë në dispozicion një mostër të orarit vjetor të punës. Nëse ndërmarrja nuk e përcakton dhe nuk i njofton punëtorët për kalendarin vjetor të orarit të punës, atëherë vlen orari regjional i punës në vendin e ndërmarrjes, që lëshohet nga komisioni lokal i paritetit për çdo vit. Duke marrë parasysh kushtet e veçanta gjeografike dhe klimatike në hapësirën e vepimit të ndërmarrjes, nëse është e domosdoshme, ka mundësi të devijohet nga zbatimi i pikës 2. Kalendar i punës së ndërmarrjes nuk guxon të tejkalojë kufijtë e caktuar nga Komisioni i paritetit. Kalendar i punës së ndërmarrjes duhet t'i dorëzohet Komisionit profesional të paritetit deri në mesin e muajit janar.

1^{deri} Vendimet e Komisionit të Paritetit: Komisionet e pariteti marrin vendime mbi kufijtë sipas paragrafit 1 me shumicë të kualifikuar. Një vendim i fundit i kryetarit nuk është i mundshëm. Para një votimi është i duhur një pjesëmarrje e barabartë.

2 Korniza e orarit ditor dhe javor të punës: Në parim orari javor i punës është :

- a) minimal 37,5 orë në javë (= 5 x 7,5 orë) dhe
- b) maksimal 45 orë në javë (= 5 x 9 orë).

3 Përjashtimet: Ndërmarrja ka mundësi të ndryshojë orarin e punës për pjesë të ndërmarrjes (kantiere) duke marrë parasysh paragrafin 2 dhe numrin maksimal të orëve të punës vjetore për arsye të mungesës së punës, motit të keq apo të pengesave teknike. Në të tilla raste lejohet tejkalmimi i numrit minimal të orëve javore dhe numri maksimal i orëve gjatë javës deri në 48 orë pune. Zgjatja e orarit javor të punës duhet të qëndroj detyrimisht një lidhje me shkakun e shkurtimi të orarit të punës, qe paraprakisht shpinte deri tek reduktimi i orarit të punës. Një përshtatje e përsëritur e kalendarit të orarit të punës është e mundshme.

3^{deri} Modalitetet: Ndryshimet e mëpastajshme të kalendarit të orarit të punës në përputhje me paragrafin 3 mund të ketë ndikim vetëm në të ardhmen. Të drejtat e fjalës së punonjësve në përputhje me nenin 48 të ligjit të punës dhe nenit 69 të rregullores 1 të ligjit të punës duhet të zbatohen. Kalendar i orarit të punës dhe ndryshimet e tij të mundshme duhet të bisedohen me të gjithë punonjësit e prekur.

3^{ter} Trajtimi orëve të papunuara, të humbura: Nëse më vonë kërkohet më pak punë në krahasim me orarin e punës paraprakisht të reduktuar,

atëherë Dallimi merret përsipër nga punëdhënësi, d.m.th. si pasojë punëdhënësi nuk ka të drejtë të reduktojë rrogën e punëtorit në fund të vitit edhe pse punëtori në përgjithësi ka punuar më pak. Një bartje në formën e orëve rezervë nuk është e mundshme.

4 Nëse kalendari i orarit të punës i shkel dispozitat e Kontratës së Përgjithshme të Punës apo të legjislacionit atëherë Komisioni i autorizuar profesional i paritetit mund të apeloj dhe të shfuqizoj kalendarin e orarit të punës.

5 *Puna me turne / ndërrime – Nocioni:* Puna me ndërrime paraqet një sistem të orarit të punës, sipas të cilit një apo më shumë grupe të punëtorëve (personelit) punojnë në kohëra të ndryshme në vendin e njëjtë të punës.

6 *Puna me ndërrime – parakushtet:* puna me ndërrime lejohet³ në rastet

- a) kur ndërmarrja (respektivisht bashkësia punonjëse) zakonisht paraqet kërkesë të argumentuar dhe me shkrim së paku dy javë para fillimit të punës,
- b) kur ekziston një nevojë objektive dhe veçanta,
- c) kur është përpiluar një plan për punë me ndërrime,
- d) kur të jenë respektuar parakushtet ligjore dhe ato që lidhen me kontratën e përgjithshme.

7 *Puna me turne / ndërrime – kompetenca:* kërkesa duhet t'i paraqitet komisionit përkatës profesional të paritetit dhe nga ky do të merret përgjigje brenda afatit javor pas pranimit të kërkesës, në rast se janë plotësuar kushtet e përmendura në pikën 6 të këtij neni⁴.

8 *Shtesat e punës me ndërrime:* Punëtori që punon me turne / ndërrime, do të përfitoj nga një bonus në kohë prej 20 minutash për çdo ndërrim, apo një shtesë prej 1 frang për çdo orë të punuar në vend të bonusit në kohë. Në kërkesën për punë me ndërrime duhet të jetë e bartur edhe rregullorja e shtesave.

9 *Kushtëzimi i punës për ndërtimtarinë nën tokë:* Për punët nën tokë vlen edhe më tej marrëveshja plotësuese të KPK-së, shtojca 12 «Marrëveshja për punën nën tokë».

10 KZPZ ka lëshuar një udhëzim për punën me turne/ndërrime (shtojca 16) për sektorin kryesor të ndërtimtarisë në Zvicër, i cili gjen përdorim plotësues.

³ Për Ndërtimtarinë nën tokë vlen marrëveshja plotësuese «Puna nën tokë», shtojca 12.

⁴ Për Ndërtimtarinë nën tokë vlen marrëveshja plotësuese «Puna nën tokë», shtojca 12.

Neni 26 Orët e tepërta të punës

1 Orët e punës të realizuara pas orarit të rregullt të punës sipas kalendarit vjetor të punës quhen orë të tepërta të punës. Shërgertët guxojnë të punojnë pas orarit të rregullt të punës vetëm me një maturi të veçantë, duke e marrë parasysh moshën dhe detyrimet e shkollës

2 Nëse numri i orëve të punës gjatë javës i kalon 48 orë, atëherë numri i orëve që kalon këtë shifër duhet të paguhet në fund të muajit me pagën me një shtesë prej 25%. Në rastet tjera gjatë muajit është e mundur të punohen 20 orë më tepër dhe orët të barten në llogarinë e re vetëm nëse nuk tejkalohet numri i përgjithshëm prej 100 orësh. Të gjitha orët tjera që kalojnë këto shifra duhet të paguhen në fund të muajit me pagën bazë.

3 Punëdhënësi ka të drejtë të kërkojë nga punëtori barazimin e plotë apo të pjesshëm të kontos së orëve të tepërta duke i kompensuar me kohë të lirë për të njëjtën kohë. Ai duhet të merr parasysh dëshirat dhe nevojat e punëtorëve sa është e mundshme duke lejuar ditë të plota të lira për kompensimin e orëve të tepërta.

4 Saldoja e orëve të tepërta të vitit paraprak duhet të barazohet plotësisht deri në fund të marsit të vitit aktual. Nëse për shkak të nevojave të ndërmarrjes ky kompensim nuk është i mundshëm, atëherë numri i tepërt i orëve duhet të paguhet me pagën bazë të muajit mars me një shtesë prej 25%.

5 Gjatë përfundimit të marrëdhënies së punës brenda vitit kalendarik pjesa e orarit të punës do të llogaritet ngjashëm me pikën 4 me procedurën e sistemit pro rata

6 Orët e mangëta (minus) mund të llogariten në fund të marrëdhënies së punës me llogarinë e fundit të pagës, nëse ato janë si pasojë e fajësisë së punëtorit dhe llogaria nuk është e tepruar në dëm të punëtorit.

Neni 27 Ditët e lira të punës

1 Të dielave, gjatë festave kantonale dhe ditëve të lira publike, si dhe të shtunave dhe më 1 gusht nuk punohet.

2 Në rastet e argumentuara mund të punohet edhe gjatë ditëve të lira të punës (neni 27 paragrafi 1 KPK). Për punë gjatë ditëve të lira ndër-marrja duhet të njoftoj me shkrim së paku 24 orë para fillimit të punës komisionin profesional të paritetit.

3 Për të gjitha orët e punuara të shtunave duhen paguar patjetër në të holla shtesë prej 25 përqind. Shtesa tjera më të larta kontraktuese (shih shtojcat) mbeten të rezervuara.

Neni 28 Orari i shkurtuar i punës dhe mbyllja e ndërmarrjeve gjatë motit të lig

1 Për të urdhëruar dhe kompensuar orarin e shkurtuar dhe për mbylljen e përkohshme të ndërmarrjes vlejnë dispozitat ligjore. Për orarin e shkurtuar kërkohet pajtueshmëria me shkrim e çdo punëtori.

2 Për arsye të motit të lig, që rrezikojnë shëndetin e punëtorëve dhe/apo e bëjnë të pamundshme rrjedhën eficientë të punës (si shiu, bora, vetëtimja, të ftohtit e madh), duhet të ndërpritet puna, nëse ndërprerja është e mundur teknikisht.

3 Ndërprerja e punës bëhet me propozimin/urdhërimin e punëdhënësit apo të përfaqësuesit të tij. Ai duhet t'i i dëgjon punëtorët para lëshimit të urdhërimit.

4 Gjatë ndërprerjes së punës si pasojë e motit të lig punëtorët duhet të jenë në dispozicion të punëdhënësit apo përfaqësuesit të tij, me mundësi të rifillimit të punës në çdo kohë, por jo nëse punëdhënësi i lejon punëtorët të jenë të lirë në këtë kohë. Përveç kësaj punëtorët duhet të jenë të gatshëm të kryejnë edhe punë tjera të arsyeshme nëse punëdhënësi apo përfaqësuesi i tij urdhëron.

5 Si punë e arsyeshme vlen çdo punë, e cila profesion është në përgjithësi zakonisht dhe i përgjigjet aftësisë së punëtorit.

6 Kush e kompenson ndërprerjen e punës me një sigurim ligjor (sigurimi i papunësisë) duhet të llogaritë ditët ligjore të papaguara me orët mesatare të punës (Neni 24 paragrafi 3) me orarin vjetor të punës. E drejta e kompensimit të punëtorëve përcaktohet duke u bazuar në dispozitat ligjore.

Neni 29 Shfuqizohet

Neni 30 Shfuqizohet

Neni 31 Shfuqizohet

Neni 32 Shfuqizohet

Neni 33 Shfuqizohet

3. Pushimet

Neni 34 E drejta e përgjithshme për pushime

1 Punëtori ka të drejtë në pushim si vijon:

	Punëtorët Me rrogë mujore	Punëtorët me pagë orë
Pas moshës 20-vjeçare deri në atë 50-vjeçare	5 javë (=25 ditë pune)	10,6%* për qind të rrogës (baras me 5 javë pushim)
deri në moshën 20-vjeçare dhe pas moshës 50-vjeçare	6 javë (=30 ditë pune)	13,0%* për qind të rrogës (baras me 6 javë pushim)

*Llogaritja bëhet si vijon: $5/(52.14-5) \times 100$ resp. $6/(52.14-6) \times 100$

2 Përqindja e rrogës së pushimit llogaritet sipas tabelës në shtojcën 8. Përqindja e rrogës së pushimit e përcaktuar në nenin 34 paragrafi 1 të KPK-së depozitohet për çdo muaj bashkë me fletëpagesën e rrogës. Gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës shprehimisht është i ndaluar kompensimi i pushimit me të holla.

3 Festat që bien gjatë pushimit nuk llogariten si ditë pushimi dhe mund të shfrytëzohen më vonë.

Neni 35 E drejta në pushime (pro-rata)

1 *Parimi themelor:* Për vitin kalendarik në të cilin fillon dhe përfundon marrëdhënia e punës, pushimet duhet të paguhen sipas nenit 34 të KPK-së dhe duke u mbështetur në kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës në vitin përkatës kalendarik.

2 Shfuqizohet

3 Shfuqizohet

Neni 36 Përcaktimi i kohës së pushimit, shfrytëzimi i pushimit

1 *Përcaktimi i kohës së pushimit:* Koha e shfrytëzimit të pushimit duhet të diskutohet me kohë mes punëdhënësit dhe punëtorit. Nevojat e ndër-marrjes dhe dëshirat e arsyeshme të punëtorit duhet të merren parasysh.

2 *Dy javë pushim pandërprerë:* Me përjashtim të mungesës së pushimit punëtorit duhet t'i jepen së paku dy javë pushim pa ndërprerje (neni 329c paragrafi 1 i të Drejtës Obligative).

3 *Pushimet e ndërmarrjes*: Pushimet eventuale të ndërmarrjes përcaktohen nga vetë ndërmarrja në marrëveshje me punëtorët respektivisht me përfaqësuesit e ndërmarrjes.

Neni 37 Ndalesa e kompensimit të pushimit me të holla dhe e punës gjatë pushimeve

1 *Shfrytëzimi i pushimit*: Parimisht pushimet duhet të shfrytëzohen gjatë vitit kalendarik përkatës. Ato nuk mund të kompensohen me kontribute në të holla apo me privilegje të tjera (neni 329d paragrafi 2 DO).

2 *Puna gjatë pushimeve*: Nëse gjatë pushimit punëtori kryen punë me kompensim financiar për një person apo organizatë tjetër dhe nëse në këtë mënyrë shkelen interesat e drejta të punëdhënësit, atëherë ky i fundit mund të refuzojë rrogën dhe të kërkojë kthimin e të hollave, të cilat tashmë ai i ka paguar për kompensimin e pushimit (neni 329d paragrafi 3 DO). Mbetet e rezervuar padia e punëdhënësit pranë komisionit kompetent të paritetit sipas nenit 70 KPK («Ndalesa e punës në të zezë»).

4. Festat, mungesa në punë, shërbimi ushtarak, i mbrojtjes dhe ai civil

Neni 38 Ditët festive

1 *Festat që kompensohen*: Punëtorët kanë të drejtë në kompensim të rrogës gjatë ditëve të festave, të cilat bien gjatë ditëve të punës. Festat që kompensohen janë të përcaktuara në KPP-të lokale (së paku tetë ditë feste në vit, nëse ato bien në ditë pune). Në rastet kur ditët e festës përkojnë me pushime, ato megjithatë duhet të kompensohen.

2 *Kompensimi për punëtorët me pagë ore*: Për llogaritjen e kompensimit të ditëve të festave përcaktuese janë orët mesatare në ditë (krahaso nenin 24 paragrafi 3), të cilat duhet të paguhet me rrogën bazë. Paguesa e kompensimit bëhet në fund të periudhës së llogaritjes së rrogës në të cilën bien festat.

3 *Parakushtet për kompensim*: Punëtori ka të drejtë në kompensimin e ditëve të festës nëse në ndërmarrje ka punuar së paku gjatë një jave para festës. E drejta në kompensim nuk vlen nëse punëtori:

- a) mungon në punë gjatë tërë javës në të cilën bie festa;
- b) mungon në punë në ditën e fundit të punës para festës apo në ditën e parë të punës pas festës;
- c) merr mëditje për festën përkatëse nga ndonjë arkë e sigurimit të të sëmurëve, nga SUVA apo nga arka e papunësisë.

4 *Punëtorët stinorë dhe punëtorët me leje qëndrim afatshkurtër*: Punëtorët stinorë dhe punëtorët me lejeqëndrim afatshkurtër të cilët

në vitin përkatës kalendarik janë të punësuar në ndërmarrje së paku shtatë muaj, ditët e festës gjatë Kërshëndellave dhe Vitit të Ri – maksimalisht dy ditë – u paguhen në shenjë shpërblimi për lojalitet në punë (nëse këto ditë nuk janë ditë të lira pune).

Neni 39 Mungesat e shkurtra

1 Punëtori, marrëdhënia e punës e të cilit ka zgjatur më shumë se tre muaj apo është punësuar për më tepër se tre muaj, ka të drejtë në kompensim të rrogës për këto mungesa të pashmangshme në punë si vijon:

- a) lirimi nga shërbimi ushtarak, gjysmë dite. Nëse vendi ku bëhet inspektimi është aq larg sa që punëtori nuk mund të kthehet në punë në të njëjtën ditë, atëherë ai ka të drejtë në një ditë të plotë të lirë.
- b) martesja e punëtorit dhe lindja e fëmijës 1 ditë
- c) në rast vdekjeje në familje (bashkëshortja apo fëmijët) e punëtorit 3 ditë
- d) në rast vdekjeje të motrave apo vëllezërve, prindërve dhe vjehërrisë 3 ditë
- e) ndërrimi i banesës (nëse punëtori është në marrëdhënie të rregullt pune) 1 ditë

2 Nëse punëtori pengohet në punë nga shkaqet të cilat nuk qëndrojnë në personin e tij dhe pa fajin vetjak, vlen neni 324a DO.

3 Për mungesat e shkurtra të numëruara nën nenin 39 paragrafi 1 KPK dhe për orët e humbura paguhet ajo rrogë të cilën punëtori do ta kishte fituar sikur të punonte normalisht në ditën përkatëse (sipas kalendarit në fuqi mbi orarin e punës).

4 Kompensimi paguhet në fund të asaj periudhe të rrogës në të cilën kanë rënë mungesat e dëshmuara.

Neni 40 Shërbimi i obligueshëm ushtarak, i mbrojtjes dhe ai civil

1 *Shuma e kompensimit:* Gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak, të mbrojtjes dhe atij civil në kohë pageje, punëtori ka të drejtë në kompensim. Kompensimi përkatës për pagën e orës, atë javore dhe mujore është si vijon:

	Beqarët	Të martuarit dhe të pamartuarit me obligime të përkujdesjes
Gjatë kohëzgjatjes së shkollës së rekrutëve	50 për qind	80 për qind
gjatë kryerjes së shërbimeve të tjera ushtarake, mbrojtëse dhe civile: – në katër javët e para – prej javës së pestë deri në javën e 21-të – prej javës 22 shërbyes të përhershëm	100 për qind 50 për qind 50 për qind	100 për qind 80 për qind 80 për qind

2 *Parakushtet për kompensim:* E drejta për kompensim parashihet nëse marrëdhënia e punës:

- a) ka zgjatur më shumë se tre muaj para shkuarjes në shërbim ushtarak, mbrojtës apo civil ose
- b) nëse duke llogaritur shërbimin ushtarak, mbrojtës dhe atë civil marrëdhënia e punës ka zgjatur më shumë se tre muaj.

3 *Llogaritja e kompensimit:* Llogaritja e kompensimit në orë, javë apo muaj duhet të paraqitet së bashku me orët e realizuara, të cilat pastaj shqyrtohen në bazë të rregullores ligjore mbi kompensimin e rrogës.

4 *Zbritjet nga rroga:* Nëse punëtorit për shkaqe administrative nga kontributet e rregullores ligjore mbi kompensimin e rrogës i ndalen kontributet e SUVA-së dhe të Fondit paritar të ndërrimtarisë (Pari-fondi), atëherë këto kontribute nuk kthehen prapa. Kompensimet sipas nenit 40 paragrafi 1 KPK vlejné si shkurtesa të këtyre kontributeve.

5 *Koordinimi me kontributet e Ligji i kompensimit të pagës (EO-APG-IPG):* Në rast se kontributet e Rregullores ligjore mbi kompensimin e rrogës tejkalojné kompensimet e punëdhënësit sipas nenit 40 paragrafi 1 KPK, shuma e cila kalon mbi këtë i takon punëtorit.

6 Me përmbushjen e të drejtave të lartpërmendura, obligimi për pagesën e rrogës nga punëdhënësi sipas nenit 324a dhe 324b DO është përfundimtar.

5. Pagesa e rrogës

Neni 41 Rrogat bazë

1 Për kategoritë e poshtë numëruara të rrogave vlejnjë këto rroga bazë në mbarë territorin zviceran, në të cilat punëtori ka të drejtë në kuptim të rrogës minimale. Të rezervuara janë rastet e veçanta (speciale) sipas nenit 45 KPK.

2 Rrogat bazë për çdo kategori të rrogave në franga zvicerane (CHF) për muaj përkatësisht për orë (Klasifikimin e gjeni në shtojcën 9):

a) Rrogat bazë që nga data 1 prill 2012

Zonat	Kategoritë e pagave				
	V	Q	A	B	C
E KUQE	6281/35.70	5583/31.70	5375/30.55	5066/28.80	4507/25.60
E KALTËR	6026/34.25	5503/31.25	5300/30.10	4933/28.05	4437/25.20
E GJELBËR	5770/32.80	5429/30.85	5226/29.70	4800/27.30	4373/24.85

b) Rrogat bazë nga 1 janari 2013

Zonat	Kategoritë e pagave				
	V	Q	A	B	C
E KUQE	6312/35.90	5611/31.90	5402/30.70	5091/28.95	4530/25.75
E KALTËR	6056/34.40	5531/31.40	5327/30.25	4958/28.20	4459/25.35
E GJELBËR	5799/32.95	5456/31.00	5252/29.85	4824/27.45	4395/24.95

3 Rroga bazë në orë do të llogaritet sipas kësaj formule: Rroga mujore sipas paragrafit 2 të këtij neni pjesëtuar për 176 (ky pjesëtues përfitohet nga numri i orëve të punës vjetore pjesëtuar për numrin e muajve të vitit, tani është: $2112 : 12 = 176$).

Neni 42 Kategoritë e rrogave

1 Për rrogat e përcaktuara bazë në nenin 41 KPK vlejné këto kategori:

Kategoritë e rrogave		Parakushtet
a) Punëtor ndërtimtarie		
C	Punëtor ndërtimtarie	Punëtor ndërtimtarie pa njohuri profesionale
B	Punëtor ndërtimtarie me njohuri profesionale	Punëtor ndërtimtarie pa dëftesë profesionale të ndërtimtarisë, i cili në bazë të kualifikimit të mirë nga punëdhënësi është klasifikuar nga kategoria C e në kategorinë B të rrogave. Me rastin e ndërrimit të vendit të punës në një ndërmarrje tjetër punëtori mbetet në kategorinë B.
b) Punëtor i kualifikuar ndërtimtarisë		
A	Punëtor i kualifikuar i ndërtimtarisë	Absolvent i arsimimit dyvjeçar si praktikant i ndërtimtarisë EBA/Praktikant në ndërtimin e rrugëve EBA (certifikata federale e profesionit) Punëtor i kualifikuar i ndërtimtarisë pa librezë profesionale, por: <ol style="list-style-type: none"> 1. Me dëftesë profesionale kursiste të pranuar nga ana e KZPZ-së. 2. Nga ana e punëdhënësit shprehimisht i pranuar si punëtor i kualifikuar i ndërtimtarisë. Me rastin e ndërrimit të vendit të punës në një ndërmarrje tjetër punëtori mbetet në kategorinë A. 3. me një dëftesë profesionale të huaj dhe që nuk pranohet në kategorinë e rrogës Q nga KZPZ.
Q	Punëtor i kualifikuar i ndërtimtarisë profesion	Punëtor i kualifikuar si p.sh. murator, ndërtuesit e rrugëve të trafikut etj., me librezë profesionale të pranuar nga ana e KZPZ-së (Dëftesa konfederale e pjekurisë apo dëftesë e huaj e pjekurisë me vlerë të njëjtë) dhe së paku tri vite veprimtari në kantiere të ndërtimtarisë (koha e përvetësimit të profesionit njihet si veprimtari).
c) Kryepunëtor		
V	Kryepunëtor	Punëtor i kualifikuar i ndërtimtarisë, i cili ka kryer me sukses një shkollë të pranuar nga KZPZ për kryepunëtor ose është emëruar nga punëdhënësi si kryepunëtor.

2 Në një katalog të hartuar nga KZPZ është përcaktuar se cilat shkollime profesionale, kurse dhe dëftesa japin të drejtën e klasifikimit në kategorinë A të rrogave. Për pranimin njohjen e kurseve parimisht duhet nisur nga një shkollim prej së paku 300 orë mësim.

Neni 43 Klasifikimi në kategoritë e rrogave

1 Klasifikimi në kategoritë gjegjëse të rrogave bëhet në përputhje me nenin 330b të DO gjatë punësimit nga punëdhënësi. Klasifikimi duhet të evidentohet në listën individuale të rrogës.

2 Rroga bazë për punëtorët e kualifikuar të ndërtimtarisë, si mura-tor, zdrukthëtar dhe ndërtues rrugësh etj. (Klasa e pagave Q), pas përfundimit të suksesshëm të arsimimit profesional, në rast të punësimit të pakufizuar mund të jetë më e ulët më së shumti për 15% në vitin e 1-rë, 10% në vitin e 2-të dhe, 5% në vitin e 3-të.

3 Paga bazë për një Praktikant ndërtimtarie të arsimuar apo Prakti-kant për ndërtimin e rrugëve (Klasa e pagave A), pas përfundimit të suksesshëm arsimimit profesional në rast të punësimit të pakufizuar mund të zbritet më së shumti në nivelin e Pagës bazë të Klasës C të pagave në vitin e parë, më së shumti 15% në vitin e 2-të, 10% në vitin e 3-të dhe, 5% në vitin e 4-të.

Neni 44 Kualifikimi dhe përshtatja e rrogës

1 Punëtori vlerësohet nga punëdhënësi për çdo vit gjatë katër muajve të fundit të vitit kalendarik. Vlerësimi bëhet në bazë të gatishmërisë në punë, aftësive profesionale, kontributit në punë dhe të kujdesin ndaj sigurisë. Njëkohësisht bëhet edhe përshtatja eventuale e rrogës.

2 Për rregullimin e përshtatjes së rrogës në përputhje me Kontratën e Përgjithshme Zvicerane vlejné dispozitat e nenit 51 të KPK-së.

Neni 45 Rregullimi i rrogës në raste të veçanta

1 *Rastet e veçanta:* Për punëtorët e numëruar më poshtë rrogat duhet të përcaktohen individualisht dhe me shkrim (me përjashtim të pikës b), në mes të punëdhënësit dhe punëtorit, duke iu referuar këtij neni, kurse rrogat e përcaktuara bazë vlejné vetëm si rekomandim që nuk është i obligueshëm:

- a) punëtorët që fizikisht dhe/apo mentalisht nuk janë plotësisht të aftë për punë;
- b) të rinjtë që ende nuk kanë arritur moshën 17-vjeçare, praktikantët, nxënësit dhe studentët, marrëdhënia e punës e të cilëve gjatë vitit kalendarik nuk zgjat me shumë se dy muaj;
- c) punëtorët të sektorëve të tjerë, marrëdhënia e punës e të cilëve në sektorin e ndërtimtarisë gjatë vitit kalendarik nuk zgjat me shumë se dy muaj;
- d) punëtorët e kategorive A dhe B sipas nenit 42 të KPK-së, klasifikimi i të cilëve në kategorinë gjegjëse të rrogës është ndryshuar nga një

punëdhënës i ri, duke bërë njëkohësisht edhe lajmërimin në komisionin përkatës profesional të paritetit.

2 *Diferencat në mendime:* Në rast të diferencave mbi përshtatshmërinë e kategorisë së rrogës mund të kyqet komisioni përkatës i paritetit.

Neni 46 Rroga për punën në akord

1 *Marrëveshja me shkrim:* Përmes marrëveshjes me shkrim në mes të punëdhënësit dhe punëtorit mund të arrihet pëlqimi që të drejtat (pre-
tendimet) legjitime që dalin nga KPK-të të jenë pjesë e rrogës akord
respektivisht në preminë e punës.

2 *Mungesa e një marrëveshjeje me shkrim:* Në rast se mungon një mar-
rëveshje me shkrim lidhur me rrogën e 13-të, pushimet, kompensimit të
festave dhe sigurimit të pagës ditore gjatë sëmundjes, atëherë dispozitat
e sanksionuara në KPK vlejnë edhe për punëtorët, të cilët nga punë-
dhënësi janë të inkuadruar direkt në marrëdhënie pune me rrogë akordi.
Kjo vlen edhe për punëtorët të cilët përpos rrogës marrin edhe premi

Neni 47 Pagesa e rrogës dhe mënyra e pagesës

1 *Pagesa e nivelizuar mujore:* Nëse rroga paguhet në bazë të orëve të
punës, atëherë këto orë duhet të llogariten në një rrogë mesatare
mujore në rastet kur marrëdhënia e punës ka zgjatur më shumë se
shtatë muaj. Në këtë mënyrë mund të bëhet pagesa e një rroge kon-
stante mujore, e cila i përgjigjet kualifikimit të punëtorit. Me këtë rast
duhet mbështetur në llogaritjen vijuese: pagesa e rrogës x orët e për-
gjithshme vjetore të punës pjesëtuar me 12.

2 *Pagesa:* Rroga paguhet për çdo muaj dhe zakonisht në fund të mua-
jit në dorë ose përmes mënyrave të tjera (bankare etj.). Pavarësisht nga
rroga punëtori ka të drejtë në një listë të detajuar mujore të rrogës, e
cila duhet të përmbajë edhe një llogari të orëve të punuara.

3 Shfuqizohet

Neni 48 Shfuqizohet

6. Rroga e trembëdhjetë

Neni 49 E drejta në rrogën e trembëdhjetë

Me fillimin e marrëdhënies së punës punëtorët kanë të drejtë në rrogën
e trembëdhjetë mujore. Nëse marrëdhënia e punës nuk ka zgjatur gjatë

tërë vitit kalendarik, atëherë punëtori ka të drejtë në këtë rrogë sipas parimit proporcional për muajt e punuara.

Neni 50 Rregullat për pagesën e rrogës

1 Pagesa kur marrëdhënia e punës zgjat gjatë tërë vitit: Nëse marrëdhënia e punës ka zgjatur gjatë tërë vitit kalendarik, punëtorëve të punësuar me pagë ore në fund të vitit u paguhet 8,3 për qind e rrogës orientuese të vitit vijues kalendarik në formë shtesë (llogaritja bëhet sipas tabelës në shtojcën nr. 8). Punëtorëve të punësuar me rrogë mujore dhe atyre me pagë konstante mujore në fund të vitit u paguhet një rrogë mesatare mujore në formë suplementare (llogaritja bëhet sipas tabelës në shtojcën nr. 8).

2 Pagesa pro-rata (në këste): Nëse marrëdhënia e punës nuk ka zgjatur gjatë tërë vitit kalendarik, atëherë punëtorëve me rastin e pagesës së fundit të rrogës u paguhet plus 8,3% të rrogës orientuese, e cila është marrë gjatë vitit vijues kalendarik (llogaritja bëhet sipas tabelës në shtojcën nr. 8).

3 Kompensimi i pushimeve: Në kuadër të rrogës së trembëdhjetë nuk paguhet kompensim për pushim.

7. Përshtatja e rrogës

Neni 51 Parimi themelor

1 Palët kontraktuese të KPK-së për çdo vit – gjatë tremujorit të fundit të vitit negociojnë këto përshtatje:

- a) rrogat bazë të regjioneve në përqindje apo shumë të hollash;
- b) rrogat efektive në përqindje apo shumë të hollash në përgjithësi ose individualisht.

2 Palët kontraktuese të KPK-së me rastin e përshtatjes së rrogës synojnë një zgjidhje të qëndrueshme sektoriale dhe ekonomike. Ndër të tjera ata marrin parasysh kriteret e zhvillimit të treguesit shtetëror të çmimeve për konsumatorë, situatën ekonomike, prodhimin, fitimin dhe vëllimin e punës në sektorin kryesor të ndërtimitarisë, produktivitetin në punë, shpenzimet e reja për kontributet sociale, shkurtimin e orarit të punës, kohëzgjatjen eventuale të pushimeve, shtesat e ngjashme si dhe faktorë të tjerë relevant.

2^{deri} Shfuqizohet

3 Nëse palët kontraktuese të KPK-së nuk mund të merren vesh deri më 30 shtator, atëherë secila palë e KPK-së mund të prish kontratën për datën 31 dhjetor, me një afat prej dy muajsh.

8. Shtesat e rrogës

Neni 52 Në përgjithësi

1 Gjatë devijimit nga orari normal i punës, orët e punuara brenda ditës janë pa shtesa. Këtu përjashtohen shtesat eventuale për orët jashtë orarit të punës (mbipuna) apo puna gjatë fundjavës. Sipas Ligjit të Punës si punë ditore gjatë verës është koha mes orës 5.00 deri 20.00, kurse gjatë dimrit mes orës 6.00 deri 20.00.

2 Derisa punëdhënësi në bazë të nenit 26 KPK (orët e tepërta), nenit 55 KPK (puna gjatë natës) dhe nenit 56 KPK (puna gjatë fundjavës) është i obliguar të paguajë shtesa të rrogës, mbesin të rezervuara marrëveshjet në KPP-të lokale me përmbajtje tjetër, por të barasvlershme.

3 Shtesat sipas nenit 26 (orët e tepërta), nenit 55 të KPK (puna gjatë natës) dhe nenit 56 KPK (puna gjatë fundjavës) nuk mund të përmbli-dhen së bashku. Gjithnjë duhet të merret shtesa më e lartë.

Neni 53 Shfuqizohet

Neni 54 Koha e udhëtimit

1 Koha e udhëtimit për vajtje ardhje deri në vendtakim nuk llogaritet si orar vjetor i punës sipas nenit 24 të. KPK Ajo duhet të kompensohet me pagën bazë nëse i kalon 30 minuta në ditë.

2 Gjatë punësimit të punëtorëve në marrëdhënie të përkohshme të punës ndërmarrja duhet të kujdeset që vendtakimi për punëtorët me marrëdhënie të përkohshme të punës të jetë i njëjtë si për punëtorët me marrëdhënie fikse të punës.

Neni 55 Puna e përkohshme gjatë natës

1 Gjatë devijimit nga orari normal i punës, d.m.th. gjatë kryerjes përkohësisht të punës gjatë natës, duke përfshirë edhe punën gjatë natës në ato ndërmarrje që punojë me ndërrime, për orët e realizuara brenda intervalit kohor mes orës 20.00 dhe orës 5.00 gjatë verës respektivisht orës 20.00 deri në orën 6.00 gjatë dimrit duhet paguar këto shtesa:

- a) për kohëzgjatje të punës deri në 1 javë: 50 % shtesë rroge
- b) për kohëzgjatje të punës mbi 1 javë: 25 % shtesë rroge

2 Marrëveshje të tjera të kontratave të përgjithshme, sidomos ato për ndërtimin e hekurudhave dhe ndërtimitarinë nën tokë mbesin të rezervuara ashtu sikur edhe neni 58 i KPK (Puna nën tokë).

3 Shfuqizohet

Neni 56 Puna të dielave

Për punën të dielave duhet të paguhet një shtesë rroge prej 50%. Si punë të dielën konsiderohet puna (prej të shtunës në orën 17.00 deri të hënën në orën 5.00 gjatë verës përkatësisht 6.00 gjatë dimrit) dhe gjatë festave zyrtare prej orës 00.00 deri në orën 24.00.

Neni 57 Puna në ujë dhe në baltë

«Punë në ujë dhe në baltë» konsiderohet puna të cilën punëtori nuk mund ta kryej me këpucë normale të punës përkatësisht çizme të shkurtra gome pa iu ekspozuar ndikimeve të dëmshme. Për punën e kryer në ujë dhe në baltë paguhet shtesa në rrogë prej 20% deri 50%.

Neni 58 Puna nën tokë

1 Punëtorët që punojnë në ndërtimitarinë nën tokë kanë të drejtë në një shtesë për punën efektive të kryer në nëntokë gjatë orarit të punës me të drejtë rroge.

2 «Punë nën tokë» konsiderohen tunelet, galeritë, zbrazëtitë nëntokësore dhe vrimat, të cilat ndërtohen, zgjerohen dhe rindërtohen nën sipërfaqen e tokës në formën e minierave⁵. Në kuadër të kësaj dispozite hyn edhe shpimi i vrimave vertikale, thellësia e të cilave është më e madhe se 20 metra (e matur nga rrafshina e përgatitur prej nga bëhet shpimi i vrimës). Shtesa për punën nën tokë paguhet duke filluar thellësia mbi 20 metra.

3 Shtesat për punën nëntokësore dhe sanimet e punëve nën tokë janë të rregulluara në marrëveshjen shtesë të KPK-së për punën nën tokë (shtojca 12).

⁵ Me «Si në miniera» konsiderohen punët nën tokë pa marrë parasysh mënyrën e depërtimit si shpërthimet, depërtimi me makina tunelshpuese, depërtimi me makina prerëse, mënyra e ndërtimit me mbrojtëse etj.

9. Shtesat, mbulimi i shpenzimeve, kompensimet

Neni 59 Shtesa për punë të vazhdueshme natën

1 *Rregulli bazë:* Për punën e vazhdueshme në ndërrimin e natës mes orës 20.00 deri në orën 5.00 gjatë verës respektivisht deri në orën 6.00 në dimër, punë kjo e zakonshme në centralët elektrike, gjatë ndërtimit të galerive nëntokësore si dhe në ato kantiere ku për Bashkësinë punonjëse ekzistojnë mundësi për ushqim dhe strehim, punëtori ka të drejtë në një shtesë prej CHF 2.– në orë.

2 *Rregull tjetër i barasvlershëm:* Lejohet marrëveshja për një shtesë tjetër të barasvlefshme dhe të përshtatur me veçoritë e punës ose kantierit.

3 *Nuk lejohet pagesa paralele e shtesave:* Kjo shtesë nuk paguhet paralelisht me shtesën e punës gjatë natës (neni 55 KPK).

4 Shfuqizohet

Neni 60 Mbulimi e shpenzimeve gjatë transferimit në një vend tjetër pune, kompensimi i drekës dhe i kilometrave të kaluara

1 Nëse punëtorët transferohen në vende të tjera të punës, atëherë atyre duhet t'u paguhet shpenzimet e nevojshme (neni 327a dhe 327b DO).

2 Sipas mundësive ndërmarrja kujdeset për mundësitë e ushqimit të mjaftueshëm në vend të pagesës në dorë të kompensimit. Nëse nuk ekziston mundësia e marrjes së ushqimit në ndërmarrje ose nëse punëtori nuk mund të kthehet në shtëpi gjatë pauzës së mesditës, atij duhet t'i paguhet kompensimi i drekës në vlerë prej së paku CHF 14.–. Palët kontraktuese të KPP-ve lokale mund të merren vesh mbi një shkallë më të lartë të kompensimit. Ata mund të hartojnë dhe aprovonë dispozita plotësuese, të cilat ndër të tjera rregullojnë edhe hollësitë mbi të drejtën në kompensim.

3 Nëse me urdhër të qartë të ndërmarrjes përdoret vetura private, punëtori ka të drejtë në kompensim prej së paku CHF 0.60 për çdo kilometër të kaluar në shërbim të punëdhënësit.

10. Pagesa e rrogës gjatë motit të lig (shfuqizohet)

Neni 61 Shfuqizohet

Neni 62 Shfuqizohet

Neni 63 Shfuqizohet

11. Sëmundja, fatkeqësia

Neni 64 Sigurimi i rrogës në rast të sëmundjes

1 *Pagesa e mëtejme e rrogës përmes sigurimit kolektiv:* Ndërmarrja zotohet që punëtorët e KPK-së t'i sigurojë kolektivisht me mëditje gjatë kohës së sëmundjes në lartësi prej 90% të rrogës për orët e humbura sipas orarit të punës së kontraktuar dhe rrogës së fundit⁶. Me pagesën e mëditjes nga ana palës që ka lidhur sigurimin kolektiv detyrimi i punëdhënësit për pagesë të mëtutjeshme të rrogës sipas nenit 324a dhe 324b të DO nuk vlen.

2 *Kontributet:*

- a) *Mbulimi i kontributeve:* Kontributet për sigurimin kolektiv të pagës i mbulojnë për gjysmë ndërmarrja dhe punëtori.
- b) *Shtyrja e pagesës gjatë sëmundjes:* Nëse ndërmarrja lidh kontratë mbi sigurimin kolektiv gjatë sëmundjes me shtyrje të afatit të pagesës prej maksimalisht 30 ditësh dhe duke rezervuar afatin e pritjes prej një dite varësisht nga rasti i sëmundjes, atëherë ajo gjatë kësaj periudhe duhet të paguajë 90% të rrogës së humbur për shkak të sëmundjes. Megjithatë me këtë rast punëtori duhet të bartë gjysmën e kontributit, i cili është i nevojshëm për mbulesën e plotë të rrogës së fundit prej 90% për shkak të sëmundjes dhe atë prej ditës së dytë. Ndërmarrja duhet të llogarisë kontributin e nevojshëm në bazë të strukturës zyrtare të tarifave (Tabela e tarifave) të sigurimit.

3 *Parakushtet minimale të sigurimit:* Parakushtet e sigurimit duhet të rregullojnë së paku këto çështje:

- a) Fillimi i mbrojtjes nga sigurimi të jetë nga ajo ditë që punëtori në bazë të inkuadrimit fillon punën apo do të duhej ta fillonte atë.
- b) Kompensimi i mungesës së rrogës prej 90% për shkak të sëmundjes duhet të paguhet pas së paku një ditë pritjeje. Në rast se kemi të bëjmë më shtyrje të afatit prej më së shumti 30 ditësh për çdo sëmundje, rroga e humbur gjatë kësaj periudhe paguhet nga punëdhënësi. Kontributet mund të zbriten atëherë dhe për aq sa e tejkalojnë shumën e fitimit të humbur të siguruar (Të ardhurat neto).
- c) Pagesa e mëditjes gjatë sëmundjes në periudhën 720 ditore brenda 900 ditëve të pandërprera.
- d) Pagesën e mëditjes gjatë paaftësisë së pjesshme për punë që i përgjigjet shkallës së kësaj paaftësie dhe nëse ajo është së paku 50 për qind.

⁶ Sipas kuptimit të Ligjit Federal për Sigurimin Shëndetësor (SSH) apo Kontratën e Sigurimit (KS).

- e) Përjashtimi nga e drejta e shfrytëzimit të sigurimit në rast qëndrimi jashtë Zvicrës prej më shumë se tre muajve. Përjashtohen rastet kur punëtori punon jashtë shtetit, dispozitat me përmbajtje tjetër ligjore, qëndrimi në një banjë kurimi dhe pamundësia e kthimit në Zvicër për shkaqe shëndetësore dhe mjekësore.
- f) Lirimi nga kontributet gjatë periudhës së sëmundjes.
- g) Kontributet sipas nenit 324a DO ndaj atyre punëtorëve, të cilët nuk mund të sigurohen apo janë të siguar me kusht për kontributet e pagës.
- h) Ofrimi i mundësisë që punëtori pas largimit nga sigurimi kolektiv në bazë të nenit 71 paragrafi 2 i Ligjit për Sigurimin e rrogës gjatë sëmundjes brenda 90 ditëve të kalojë në sigurimin individual, ku kontributi llogaritet në bazë të moshës së inkuadrimit në sigurimin kolektiv. Nëse është lidhur marrëveshja e sigurimit kolektiv me shtyrje të afatit të pagesës, atëherë është me rëndësi që kushtet e sigurimit të organizohen në atë mënyrë që punëtorët të cilët largohen nga sigurimi kolektiv të mos trajtohen në dëm të tyre në krahasim me ata punëtorë të tjerë të siguar kolektivisht dhe pa shtyrje afati d.m.th. afati i pritjes lejohet të jetë maksimalisht një ditë.

4 *Rregulloret e KPP-ve lokale*: Rregulloret që tashmë janë në fuqi dhe kanë dispozita të tjera në kontratat e përgjithshme lokale të punës mund të vlejnjë edhe më tutje derisa parakushtet e konfirmuara në këtë kontratë respektohen në përgjithësi.

5 *Modeli «Managed care»*: Modelet e tilla janë të lejueshme⁷ nëse plotësohen të gjitha këto kushte së bashku:

- a) respektohen kontributet minimale sipas pikës 3 të këtij neni (duhet të miratohen nga komisioni profesional i paritetit)
- b) nëse si rrjedhojë është një kursim premie prej së paku 10 për qind në krahasim me një sigurim të rëndomtë kolektiv të mëdijës dhe
- c) nëse këtë model e pranojnë të gjithë punëtorët përkatës të ndërmarrjes.

6 *Udhëzimet*: Përndryshe vlejnjë dispozitat e miratuara në mes të palëve kontraktuese dhe sigurime ve në «Dispozitat ekzekutive të sigurimit të mëdijëve në sektorin kryesor të ndërtimitarisë» (shtojca nr. 10).

Neni 65 Sigurimi nga fatkeqësitë

1 *Kontributet në rast fatkeqësie*: Në rast fatkeqësie ndërmarrja punëtorit nuk i jep kontribute derisa SUVA përmes kontributeve të veta mbulon 80% të rrogës së siguar. Ditët e pritjes para kontributeve të

⁷ Vlen vetëm për Sigurimet sipas KS.

SUVA, ndërkaq, duhet të paguhet nga punëdhënësi në lartësi prej 80% të rrogës së siguruar. Me këtë mbulohet plotësisht detyrimi për pagesë të mëtejme të rrogës sipas nenit 324a dhe 324b DO.

2 *Reduktimi i kontributeve nga ana e SUVA-së:* Në rast se SUVA bën anulimin apo reduktimin e kontributeve të sigurimit për shkak të fajit të personit të siguruar apo të rreziqeve të jashtëzakonshme dhe me vetëdije në kuptim të neneve 37 deri 39 LFSF, atëherë e drejta në pagesën e mëtejme të rrogës reduktohet automatikisht nga ana e ndërmarrjes. Kjo vlen po ashtu edhe për ato rroga të cilat tejkalojnë maksimumin e SUVA-së dhe ditët e pritjes për pagesë po ashtu të SUVA-së.

3 *Mbulimi i kontributeve:* Kontributet e sigurimit të fatkeqësive në profesion i paguan punëdhënësi, kurse ato të sigurimit të fatkeqësive jashtë profesionit (në kohë të lirë) duhet t'i bartë punëtori.

12. Pagesa e mëtutjeshme e rrogës në rast vdekjeje, kompensimi me rastin e largimit nga vendi i punës, përkujdesja profesionale (shfuqizohet)

Neni 66 Shfuqizohet

Neni 67 Shfuqizohet

Neni 68 Shfuqizohet

13. Të drejtat dhe obligimet e përgjithshme, masat ndëshkuese

Neni 69 Shfuqizohet

Neni 70 Ndalimi i punës në të zezë

1 Gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës punëtori nuk guxon të kryej punë të profesionit të tij për personin e tretë derisa ai në këtë mënyrë shkel obligimin e besnikërisë, veçanërisht atëherë kur i bën konkurrencë punëdhënësit.

2 Për të konstatuar punën në të zezë komisionet përkatëse të paritetit bëjnë kontrollime të përbashkëta periodike. Parimisht këto kontrollime bëhen një herë në muaj.

3 Në rast veprimi në kundërshtim me ndalimin e punës ilegale, komisioni përkatës i paritetit sipas peshës së rastit mund të shqiptojë vërejtje me paralajmërim ose dënime konvencionale në lartësi maksimale CHF 3.000.–. Dënimi konvencional hiqet nga rroga dhe shfrytëzohet sipas vendimit të komisionit përkatës të paritetit si mjet për zbatimin e KPP-së. Në rast të shkeljeve të përsëritshme punëdhënësi përveç këtij dënimi mund të prishë menjëherë kontratën, duke u bazuar në shkaqe të rëndësishme. Kërkesat e punëdhënësit për mbulimin e shpenzimeve për dëmet e shkaktuara mbesin të rezervuara.

4 Kundër punëdhënësve që me vetëdije lejojnë kryerjen e punës në të zezë me pagesë dhe që nxisin atë, mund të shqiptohet vërejtje paralajmëruese ose dënim konvencional në bazë të nenit 70 paragrafi 3 KPK.

Neni 71 Sjellja në kundërshtim me kontratën nga ana e punëdhënësit

Nëse punëdhënësi i siguron punëtorit një vend pune për një afat të caktuar kontraktues respektivisht për një periudhë të caktuar dhe më vonë nuk respekton me fajin e tij këtë marrëveshje, atëherë ai është i obliguar që punëtorit përkatës t'i paguaj rrogën.

Neni 72 Sjellja në kundërshtim me kontratën nga ana e punëtorit

1 Nëse punëtori nuk përmbush njërën apo disa nga kushtet e numëruara në pikën 2 të këtij neni, atëherë ai për çdo kusht nuk ka respektuar punëdhënësit duhet t'i paguaj në emër të kompensimit një të katërtën e rrogës mujore bazë. Përveç kësaj punëdhënësi ka të drejtë të kërkojë mbulimin e shpenzimeve mbi dëmet e tjera të shkaktuara.

2 Punëtori është i obliguar të kompensojë punëdhënësin në këto raste:

- a) mosrespektim i afatit për fillimin e punës në ditën e caktuar me kontratë, ku tolerohet ky afat:
 1. 10 ditë për punëtorët e huaj që në Zvicër hyjnë për herë të parë,
 2. 5 ditë për të gjithë punëtorët e tjerë që hyjnë në Zvicër;
- b) mosrespektimi me qëllim i afatit të caktuar në kontratë përkitazi me përfundimin e marrëdhënies së punës respektivisht mosrespektimin e afatit për prishjen e kontratës. Me këtë rast tolerohet një afat prej dy ditësh;
- c) mosrëveshjes me qëllim i marrëveshjes së veçantë të punës mbi kohëzgjatjen e pushimit dhe shfrytëzimin e tij. Me këtë rast tolerohet një afat prej dy ditësh.

3 Nëse janë plotësuar parakushtet për kompensim, punëdhënësi për këtë duhet të informojë me shkrim punëtorin më së voni deri në kalimin e periudhës vijuese të rrogës.

4 Nëse punëtori nuk fillon punën pa ndonjë shkak relevant ose largohet nga vendi i punës pa afat të paralajmëruar d.m.th. menjëherë, duhet zbatuar nenin 337d DO (shtojca nr. 3). Nëse punëdhënësi zbaton këtë të drejtë ligjore, atëherë nuk vlen dispozita tjetër sipas paragrafeve 2 dhe 3 të këtij neni.

14. Dispozita të veçanta

Neni 73 Ligji mbi bashkëveprim

1 Palët kontraktuese të KPK-së zbatimin e Ligjit mbi bashkëveprim rregullojnë me një marrëveshje shtesë «Bashkëveprimi në sektorin kryesor të ndërtimitarisë» (shtojca nr. 5). Kjo marrëveshje shtesë është pjesë përbërëse e KPK-së.

2 Marrëveshja shtesë «Bashkëveprimi në sektorin kryesor të ndërtimitarisë» ndër të tjera përmban edhe dispozita mbi informimin në ndërmarrje, sigurimin në punë, perkujdesjen ndaj shëndetit në ndërmarrje, situatat e veçanta dhe përfaqësimin e punëtorëve në organet e ndërmarrjes.

Neni 74 Strehimi i punëtorëve, higjiena dhe rregulli në kantiere

Palët kontraktuese të KPK-së përmes një marrëveshje shtesë përcaktojnë kërkesat mbi higjienën dhe ndërtimin e vendstrehimeve të punëtorëve, masat e nevojshme për mbajtjen e rregullit dhe higjienës në kantiere (shih shtojcën nr. 6). Kjo marrëveshje shtesë është pjesë përbërëse e KPK-së.

PJESA E TRETË: Dispozitat e zbatimit dhe ato përfundimtare

1. Zbatimi i dispozitave normative

Neni 75 Kompetencat

1 *Kompetencat:* Për realizimin dhe zbatimin e KPK-së në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 të KPK-së dhe nenit 357 a dhe 357b DO lidhur me harmonizimin e diferencave apo kontesteve në zonën kontraktuese të palëve lokale kontraktuese kompetente janë palët kontraktuese të KPP-së përkatëse lokale.

2 *Rregull:* KPP-lokale duke u mbështetur në nenin 10 paragrafi 3 nën b të KPK-së, duhet të përmbajë rregullat e nënvizuara në nenin vijuese. Këto rregulla mund të jenë edhe objekt i një rregulloreje, e cila është pjesë integrale e KPP-së lokale.

Neni 76 Komisionet lokale profesionale të paritetit⁸: Formimi, kompetencat dhe detyrat

1 *Formimi:* Palët kontraktuese të KPP-së lokale formojnë një komision lokal profesional të paritetit me status juridik të një shoqate. Statutet duhet të miratohen nga palët kontraktuese të KPK-së. Komisionet lokale profesionale të paritetit të formuara janë shprehimisht të autorizuara për të zbatuar KPK-në përderisa ajo është në fuqi.

2 *Kompetenca:* Palët kontraktuese të KPK-së janë të obliguara që komisioneve lokale të paritetit t'u japin autorizimet e nevojshme rreth përfaqësimit të drejtave të njëjta sipas nenit 357b DO.

3 *Detyrat:* Komisionet lokale profesionale të paritetit⁹ kanë këto detyra:

- a) që sipas porosisë dhe në emër të palëve kontraktuese të KPK-së të zbatojë dispozitat kontraktuese dhe punuese të KPK-së përfshirë edhe shtojcat dhe marrëveshjet shtesë përderisa në KPK apo në një marrëveshje tjetër nuk është arritur një zgjidhje, pastaj të zbatojë KPP-në lokale dhe duke aplikuar KPP-në lokale të zgjidh diferencat dhe kontestet eventuale.

⁸ Adresat e Komisioneve lokale profesionale të paritetit (shih Pjesën e pestë).

⁹ KLPP janë të barabarta me KP-UT (Shtojca 12).

- b) ky komision është para së gjithash i autorizuar për:
1. bërjen e kontroleve të përbashkëta të rrogës dhe hulumtimit e marrëdhënieve të punës në ndërmarrje pas padisë individuale ose sistematikisht;
 2. verifikimi i kalendarit vjetor të punës (neni 25 paragrafi 4 KPK), nëse përveç kësaj KPK nuk përcakton edhe ndonjë kompetencë tjetër, si tek marrëveshja shtesë e KPK-së «Puna nën tokë» apo Marrëveshja shtesë «Ndërtimtaria e ulët tokësore dhe ajo speciale në thellësi»;
 3. të bëjë ndërmjetësimin e nevojshëm në rast të diferencave në mes ndërmarrjes dhe punëtorit, sidomos kur kemi të bëjmë me klasifikimin në kategorinë përkatëse të rrogës (neni 42, 43 dhe 45 KPK);
 4. zbatimin e marrëveshjes shtesë mbi strehimin e punëtorëve, higjienën dhe rregullin në kantiere (shtojca nr. 6);
 5. ndërmjetësimin e nevojshëm në rast kundërthëniesh në mes të ndërmarrjes dhe punëtorit, kur këto kundërthënie kanë të bëjnë me sigurinë në punë dhe përkujdesjen shëndetësore në ndërmarrje;
 6. harmonizimin e diferencave sipas nenit 33 të marrëveshjes shtesë mbi pjesëmarrjen në organet e sektorit kryesor të ndërtimtarisë (shtojca nr. 5);
 7. në rast se shkeljet eventuale të KPK-së (bashkë me KPP-të lokale) gjykohen nga komisioni, atëherë për këtë duhet të njoftohen autoritetet, siç janë entet kantonale të punës, ndërmarrjet publike ndërtimore etj.

4 *Procedura*: Komisioni profesional i paritetit në nivel lokal zhvillon procedurën sipas parimeve bazë të shtetit të së drejtës (Detajet e procedurës janë të përcaktuara në një rregullore të obligueshme të hartuar nga Komisioni Zviceran Paritar i Zbatimit (KZPZ) e që vlen për të gjitha komisionet profesionale të paritetit.

Komisionet lokale të paritetit:

- a) vendosë për kontrollimin e një ndërmarrjeje lidhur me respektimin e KPK-së, me kusht që selia e ndërmarrjes përkatëse të jetë në zonën e tij respektivisht nëse kantieri ndodhet në këtë zonë. Në raste të tjera ai njofton komisionet lokale të paritetit;
- b) bashkë me anëtarët e autorizuar të komisionit, pas paralajmërimit me shkrim, bëhen kontrollime përkritazi me respektimin e KPK-së dhe kontrollohen kantiere po që se selia e ndërmarrjes përkatëse gjendet në zonën e tij respektivisht nëse kantieri ndodhet në këtë zonë. Për këtë qëllim ai mund të kërkojë ndihmë juridike nga komisionet përkatëse të paritetit;

- c) për veprimtarinë inspektuese përpilon një raport kontrolli që i dorëzohet ndërmarrjes përkatëse, e cila duhet të deklarohet në lidhje me këtë brenda një afati të caktuar (dy javë);
- d) detyrat sipas pikës b dhe c ai mund t'ia ngarkojë edhe personave të tretë të specializuar.
- e) pas përfundimit të kontrollit përpilon një vendim me shkrim, i cili duhet të përmbajë vendimin përkatës, një arsyetim të shkurtër edhe të drejtën për ankesë. Në vendim duhet të theksohet:
 1. se a ndërpritet procedura pa pasoja apo
 2. krahas konstatimit të shkeljes së KPK-së respektivisht KPP-së lokale shqiptohet edhe një vërejtje apo sanksion,
 3. a informohen edhe autoritetet dhe
 4. bartja e shpenzimeve të kontrollit dhe procedurës.

5 *Kompetenca*: Kompetent për marrjen e vendimit është komisioni lokal i paritetit në selinë e ndërmarrjes përkatëse. Ai angazhohet edhe atëherë kur një komision tjetër i paritetit njofton për shkelje eventuale të KPK-së. Për ndërmarrjet me seli në botën e jashtme kompetent është komisioni lokal i paritetit në vendin e kantierit. Mbesin të rezervuara rregullat e veçanta si në rastet e punës nën tokë apo punëve të ndërtimitarisë së ulët tokësore dhe të ulët speciale.

6 *Ndihma juridike*: Nëse një komision profesional i paritetit prej të cilit është kërkuar ndihmë juridike sipas pikës 4 të këtij neni (nën a dhe b), refuzon ta ofrojë atë, komisioni zbatues i paritetit në nivel zviceran KZPZ merr vendim për kontrollimin dhe eventualisht për sanksionet që duhet ndërmarrë kundër komisionit kompetent të paritetit.

Neni 77 Gjyqi lokal i arbitrazhit: Krijimi dhe detyrat

1 *Formimi i Gjyqit të Arbitrazhit*: Palët kontraktuese të KPP-së lokale të cilat gjatë hyrjes në fuqi të komisionit të zbatimit të Komisioni Zviceran Paritar i Zbatimit (KZPZ) që posedojnë një gjyq funksional të arbitrazhit, brenda tre muajve të parë pas hyrjes në fuqi të KZPZ të paritetit mund të vërtetojnë gjyqin lokal të arbitrazhit. Ky përbëhet nga një jurist me njohuri specifike mbi të drejtën e punës në funksionin e kryetarit, emërimi i të cilit bëhet nga palët kontraktuese së bashku dhe nga dy gjyqtarë kompetent të arbitrazhit, të cilët gjithashtu emërohen nga palët kontraktuese. Në rast se brenda afatit të caktuar nuk mund të arrihet marrëveshja mbi emërimin e kryetarit të gjyqit, atëherë atë e emëron komisioni zbatues zviceran i paritetit brenda dy muajve pas thirrjes nga njëra palë kontraktuese.

2 *Kompetencat lëndore*: Gjyqi lokal i Arbitrazhit objektivisht është kompetent për:

- a) vlerësimin e dallimeve dhe kundërthënieve në mes të palëve kontraktuese në rastet kur ato nuk mund t'i zgjidh komisioni i paritetit (neni 78 KPK).
- b) vlerësimin e vendimeve të komisionit të paritetit ndaj punëdhënësve dhe punëtorëve që kanë mospajtime. Punëtorët apo punëdhënësit përkatës, të cilët nuk janë anëtarë të palëve kontraktuese të KPK-së, Gjyqin e Arbitrazhit duhet ta njoftojnë me shkrim.
- c) paditë e komisionit të paritetit ndaj punëdhënësve dhe punëtorëve pjesëmarrës.

3 *Procedura e arbitrazhit*: Zhvillimi i procedurës para Gjyqit të Arbitrazhit mbështetet në dispozitat e proceseve civile të atij kantoni ku gjendet selia e Gjyqit të Arbitrazhit. Si seli përkatëse konsiderohet edhe selia e ndërmarrjes. Për zonat kontraktuese që tejkalojnë kufijtë kantonal Gjyqi i Arbitrazhit vendosë se ku do ta ketë selinë dhe në ç'mënyrë do të zhvillojë procedurën.

Neni 78 Marrëveshja dhe arbitrazhi lokal në mes të palëve kontraktuese lokale

1 Diferencat dhe kundërthëniet komisioni lokal i paritetit i shqyrton me rezervë sipas kuptimit të nenit 10 paragrafi 5 të KPK-së.

2 Në rast se nuk arrihet marrëveshja për këtë me anë të padisë mund të njoftohet Gjyqi lokal i Arbitrazhit. Kompetenca objektive përcaktohet sipas nenit 77 paragrafi 2 KPK.

3 Vendimet e Gjyqit të Arbitrazhit janë përfundimtare me rezervën që të ushtrohet ankesë për anulim respektivisht padi sipas të drejtës kantonale.

4 Gjatë kohëzgjatjes së procedurës para komisionit të paritetit dhe para Gjyqit të Arbitrazhit ndalohet çdo diskutim publik mbi rrjedhën dhe përmbajtjen e procedurës së seancave. Informimi korrekt i anëtarëve është i lejuar.

5 Komisioni i paritetit dhe Gjyqi i Arbitrazhit janë të autorizuar të sqarojnë vetëm pyetjet dhe diferencat mbi shqyrtimin dhe zbatimin e dispozitave kontraktuese dhe të punës. Çdo shpallje e dispozitave të reja është e ndaluar dhe e rezervuar vetëm për palët kontraktuese të KPK-së respektivisht palëve kontraktuese të KPP-ve lokale.

Neni 79 Masat ndëshkuese / Sanksionet

1 Nëse komisionet profesionale të paritetit konstatojnë se janë shkelur dispozitat kontraktuese dhe ato të punës, atëherë ky komision kër-

kon nga palët që kanë shkelur dispozitat që t'i përmbahen pa hezitim detyrimeve që kanë marrë përsipër.

2 Komisioni i paritetit ka të drejtë:

- a) të shqiptojë vërejtje;
- b) të shqiptojë dënim konvencional deri në CHF 50 000.–. Në rastet e ndaljes së shumave të tjera (nga punëdhënësi ose punëtori) të të hollave, dënimi konvencional lejohet të arrijë maksimumin e borxhit;
- c) që shpenzimet plotësuese dhe ato të procedurës t'ia ngarkojë asaj pale që palës fajtoje;
- d) të shqiptojë masa ndëshkuese të parapara me nenin 70 KPK «Ndalimi i punës në të zezë»).

2^{deri} Shpenzimet e kontrollit dhe të procedurës duhet t'i bart punëdhënësi dhe / apo punëtori të cilët kanë shkelur dispozitat e KPK-së. Nëse nuk gjendet ndonjë parregullsi apo shkelje e dispozitave të KPK-së atëherë ato barten nga personi që ka iniciuar kontrollin.

3 Dënimi konvencional në radhë të parë duhet të përshtatet në atë mënyrë që punëdhënësi apo punëtori fajtor të pengohen për shkelje të ardhshme të KPK-së. Niveli i dënimit konvencional përshtatet pas vlerësimit të rrethanave të përgjithshme së bashku me kriteret vijuese:

- a) niveli i shumës së të hollave, të cilat punëdhënësi ua ka ndalur punëtorëve të tij (shih nenin 79 paragrafi 2 nën b KPK);
- b) shkeljen e dispozitave të tjera kontraktuese të punës, përveç atyre të kapitalit;
- c) shkelja e njëhershme apo e disahershme e dispozitave të përgjithshme kontraktuese të punës;
- d) madhësia e ndërmarrjes;
- e) fakti se a ka filluar të respektojë dispozitat pala e cila ka qenë fajtoje, pra punëdhënësi apo punëtori, të cilit i është shqiptuar vërejtja;
- f) fakti se a mendon punëtori që pretendimet e tij financiare t'i kërkojë drejtpërdrejtë ndaj punëdhënësi fajtor respektivisht a mund të llogaritet se ai këtë do ta bëjë në ditët e ardhshme.

4 Në KPP-të lokale palët mund të merren vesh edhe për implementimin e përbashkët, që kufizohet vetëm në zbatimin e dënimeve konvencionale të komisioneve të paritetit (neni 357b paragrafi 1 nën c DO), derisa palët kontraktuese dëshirojnë të shfrytëzojnë këtë mundësi dhe disponojnë me një autorizim të nevojshëm sipas nenit 357b paragrafi 2 DO.

5 Dënimi konvencional i shqiptuar brenda 30 ditëve duhet t'i paguhet komisionit lokal të paritetit. Këtë shumë komisioni i paritetit e shfrytëzon për zbatimin dhe aplikimin e KPP-ve.

2. Dispozitat përfundimtare

Neni 80 Dispozitat sipas të Drejtës Obligative

Për çështjet që nuk janë të rregulluara në këtë KPK vlejnë dispozitat e DO-së.

Neni 81 Selia juridike dhe gjyqësore

Palët kontraktuese të KPK-së e njohin qytetin e Cyrih-ut si seli juridike dhe gjyqësore.

Neni 82 Kohëzgjatja e KPK-së

1 KPK 2012–2015 hynë në fuqi më 1 prill 2012 dhe vlen deri më 31 dhjetor 2015, me përjashtim të ndryshimeve në Nenin 64 të KPK-së, i cili do të hyjë në fuqi më 1 janar 2013, por jo më herët se hyrja në fuqi e Marrëveshjes për obligimin e përgjithshëm. Deri më 31 dhjetor 2012 palët kontraktuese bisedojnë për përshtatjet e tjera të KPK-së, sidomos do të vazhdojnë bisedat për pikat e caktuara gjatë vitit 2011. Secila palë kontraktuese mund ta prishë KPK-në, duke respektuar afatin dymujor njëherë më 31 mars 2013, për të gjitha palët.

I^{deri} Si përjashtim nga Neni 82 paragrafi 1 i KPK-së vlejnë dispozitat e Nenit 8 Paragrafi 6 të KPK-së për kohëzgjatjen dhe shuarjen e Fondtit të Paritetit për ndërtimtarinë.

2 Sa i përket mundësisë për prishjen e parakohshme të kësaj kontrate vlejnë dispozitat në nenin 51 të KPK.

PJESA E KATËRT: Shtojcat

- 1 Marrëveshja protokollare e KPK mbi «Kushtet e punës së shëgertëve» si dhe «Të drejtën për nënshkrimin e kontratave shtesë bashkëngjiturë»
- 2 Marrëveshja për përshtatjen e rrogave efektive individuale
- 3 Shfuqizohet
- 4 Shfuqizohet
- 5 Marrëveshja shtesë Bashkëveprimi në sektorin kryesor të ndërtimtarisë «Marrëveshja e bashkëveprimit»
- 6 Marrëveshja shtesë mbi strehimin e punëtorëve, higjienën dhe rregullin në kantiere «Marrëveshja për strehimin»
- 7 Marrëveshja protokollare për juridiksionin ndërmarrësorë përputhje me nenin 2 KPK 2012–2015
- 8 Tabela për llogaritjen procentuale të rrogës së pushimve (neni 34, paragrafi 2 i KPK) dhe rrogës së trembëdhjetë (neni 50 KPK)
- 9 Rrogat bazë sipas Klasës dhe zonave të pagave
- 10 Udhëzues «sigurimi i rrogës në rast të sëmundjes» për sektorin kryesor të ndërtimtarisë
- 11 Shfuqizohet
- 12 Marrëveshja shtesë për KPK për punën nën tokë «Marrëveshja për punën nën tokë»
- 13 Marrëveshja shtesë «Ndërtimtaria e ulët tokësore dhe ajo speciale në thellësi»
- 14 Shfuqizohet
- 15 Katalog për kriteret e klasifikimit për kategoritë e rrogave A dhe Q si dhe fletë udhëzimi i KZPZ mbi pranimin e kualifikimeve profesionale të arritura jashtë Zvicrës
- 16 Parimet themelore të punës me ndërrime
- 17 Marrëveshja shtesë për sektorin e prerjes së betonit
- 18 Marrëveshja shtesë «Gjenevë»

1

2

3

4

5

Shtojca 6 «Marrëveshja për strehimin»

6

7

Shtojca 8 Tabela per llogaritjen e rrogës gjatë pushimit dhe rrogës 13-të

8

9

10

11

Shtojca 12 «Marrëveshja për punën nën tokë»

12

Shtojca 13 Marrëveshja shitesë «Ndërtimtaria e ulët tokësore dhe ajo speciale në thellësi»

13

14

Shtojca 15 Katalog për kriteret e klasifikimit për kategoritë e rrogave A dhe Q

15

16

Shtojca 17 Marrëveshja shitesë për sektorin e prerjes së betonit

17

18

Shtojca 6

6

**Marrëveshja shtesë mbi
strehimin e punëtorëve,
higjienën dhe rregullin në
kantiere «Marrëveshja për
strehimin»**

Marrëveshja shtesë mbi strehimin e punëtorëve, higjienën dhe rregullin në kantiere «Marrëveshja për strehimin»

E vlefshme me KPK 2012–2015

Duke u bazuar në nenin 74 të KPK-së për përmirësimin e strehimit të punëtorëve si dhe për mirëmbajtjen e higjienës dhe rregullit në kantiere palët kontraktuese lidhin këtë marrëveshje shtesë:

Kapitulli 1 Qëllimi dhe juridiksioni

Neni 1 Qëllimi

1 Marrëveshja shtesë në fjalë është rezultat i zbatimit të nenit 9 të KPK-së dhe lëshohet me këtë qëllim:

- a) Punëtorëve, sidomos punëtorëve sezonalë dhe atyre me qëndrim afatshkurtër t'u vë në dispozicion vendstrehime të përshtatshme;
- b) Rregullimin e qëndrimit dhe rregullit në kantier;

2 përmes marrëveshjes në fjalë të merren parasysh kërkesat e drejta të punëdhënësve dhe punëtorëve duke përmirësuar kështu reputacionin (namin) e sektorit kryesor të ndërtimitarisë në opinionin publik.

Neni 2 Juridiksioni

1 Juridiksioni e marrëveshjes shtesë përfshin të gjithë punëdhënësit dhe punëtorët e sektorit kryesor të ndërtimitarisë në tërë hapësirën e Zvicrës sipas nenit 1 deri 3 të KPK-së, nëse nuk janë në kundërshtim me dispozitat e së drejtës publike.

2 Juridiksioni sendor përfshin:

- a) të gjitha vendstrehimet të cilat ofrohen nga punëdhënësi me qëllim banimi. Dispozitat në fjalë vlejnë për dhoma, studio dhe banesa;
- b) të gjitha vendstrehimet për punëtorë të cilat ofrohen nga punëdhënësi në kantiere të mëdha dhe kanë karakter kohor të përkohshëm;
- c) Hapësira qëndrimi dhe pajisje sanitare në kantiere pune.

3 Dispozitat e së drejtës publike të cilat janë më të zgjeruara se dispozitat në fjalë të kësaj rregullore mbeten të rezervuara.¹

¹ Gjendja e datës 1.1.1995: Kantonet Vadt, Gjenevë dhe Valis.

Neni 3 Kriteret e përgjithshme

- 1 Banimi i shëndoshë e siguria e banorëve si dhe vizitorëve duhet plotësuar në përputhje me normat në fuqi për banim të dispozitave të së drejtës publike, dispozitat e mbrojtjes nga zjarri etj.
- 2 Zhurma dhe mbrojtja akustike brenda e jashtë duhet të jenë në përputhje me kërkesat e dispozitave për banim.
- 3 Hapësirat e banimit (duke përfshirë hapësirat sanitare) duhet të kenë ngrohje.
- 4 Për banuesit duhet të ketë një stacion telefonimi në afërsi (distanca e përafërt rreth 150 metra). Në vendbanime për çdo dhjetë banorë duhet të ketë një stacion telefoni (vlera e përafërt për 10–15 banues një stacion telefonimi).

Neni 4 Pajisjet për përgatitjen e ushqimit (kantinat, kuzhinat dhe kuzhinat e përbashkëta)

- 1 Në vendbanime duhet siguruar mundësinë e marrjes së një racioni të ngrohtë, për këtë ekzistojnë këto mundësi:
 - a) Puna e kantinsës;
 - b) kuzhina/kuzhina e përbashkët për përgatitjen individuale të ushqimit;
 - c) organizimi i marrjes së ushqimit në afërsi të vendbanimit.
- 2 *Kantinat*: Për kantinat vlen:
 - a) Në rastin e kantinave apo marrjes së ushqimit në afërsi të vendbanimit duhet të ekzistoj mundësia e furnizimit me ujë të ngrohtë në vendbanim;
 - b) Për pajisjet dhe funksionimin e tyre vlejnjë dispozitat e së drejtës publike.
- 3 *Kuzhinat dhe kuzhinat e përbashkëta*: Për kuzhinat dhe kuzhinat e përbashkëta vlen si në vijim:
 - a) Kuzhinat e përbashkëta duhet të jenë të pajisura si në vijim:
 - 1 Vende për përgatitjen e ushqimit (p.sh pllaka elektrike për zierje) duhet jenë në numër të mjaftueshëm (vlera e përafërt: për një deri në tetë persona një vend për zierje, për çdo person tjetër edhe një vend shtesë për zierje.). Gjatë punës me turne kjo normë mund të jetë më e ulët;
 - 2 Paisje (Lavabo) për larje me ujë të ftohtë e të ngrohtë;
 - 3 Frigorifer / mundësi për ftohje me kapacitet të mjaftueshëm (nëse e mundshme: me mundësi mbyllje me dry);
 - 4 Arkë e përshtatshme personale për ruajtjen e gjërave ushqimore për vendbanime të përbashkëta me mundësi mbylljeje me dry (vlera minimale : 100 litra);
 - b) Kuzhinat e përbashkëta pa hapësira të veçantë qëndrimi gjegjësisht për marrjen e ushqimit janë të lejueshme deri në 12 persona, nëse liria e lëvizjes nuk kufizohet. Për çdo person është i domosdoshëm një vend për ulje me një tavolinë dhe hapësirë të mjaftueshme;
 - c) Kuzhinat e përbashkëta me hapësira të veçanta për qëndrim dhe marrjen e ushqimit janë të pajisura me tavolina të mëdha dhe hapësirë të mjaftueshme për lëvizje.

Neni 5 Hapësirat e qëndrimit dhe të marrjes së ushqimit

Hapësirat e qëndrimit dhe të marrjes së ushqimit duhet të pajisen ne orënditë e domosdoshme. Për çdo person një mundësi për ulje (me mundësi për mbështetje) me hapësirën e domosdoshme të tavolinës. Gjatë punës me turne kjo normë mund të jetë më e ulët.

Neni 6 Dhoma e fjetjes

1 Dhoma e fjetjes tek vendstrehimet permanente të reja duhet të kenë së paku këtë sipërfaqe

- a) Dhoma njëshe (8 m²);
- b) Dhoma dyshe (12 m²).

2 Shtretërit në kabinë dhe dhomat treshe apo katërshë në vendstrehimet përkatëse (16 m² përkatësisht 20 m²) duhet të merren parasysh vetëm në raste individuale dhe në përputhje me nenin 20 të kësaj marrëveshje plotësuese.

3 Çdo banor ka të drejtë të ketë një shtrat funksional me mbulesë shtrati, e veç tjerash edhe një dollap njëpjesësh për rroba, i cili mund të mbyllet, me këto përmasa (1 deri 1.20 x 0.6 x 1.80 m), dhe mundësi për ulje (me mundësi për mbështetje) me tavolinë / burim të rrymës elektrike.

Neni 7 Pajisjet sanitare

1 Për të gjitha vendbanimet parashihet:

- a) Nevojtoare dhe shurrëtoare, lajtoare dhe dush duke ju përmbajtur këtyre vlerave normative të përfaqëta:
 1. Nevojtoare me ulëse: 1 për 5 persona,
 2. Shurrëtoare: 1 për 7 persona,
 3. Lajtoare: 1 për 2 persona,
 4. Dush: 1 për 5 persona;
- b) Priza për rruajtje;
- c) Vlerat e përmendura më lart vlejné për strehimore dhe duhet të zbatohen sipas këtij kuptimi edhe për dhoma, studio dhe banesa.

2 Për pastrimin dhe tharjen e rrobave duhet të ketë pajisje të përshtatshme jashtë hapësirave për fjetje (p.sh. makina larëse, hapësira për tharje apo makina për tharjen e rrobave), apo duhet të organizohet një shërbim pastrimi.

3 Iidhjet në mes të hapësirës për fjetje dhe asaj sanitare duhet të jenë të mbuluara dhe të ndriçuara.

Neni 8 Vendbanimet e përkohshme

Tek vendbanimet e përkohshme (p.sh gjatë kohëzgjatjes së punimeve në kantier) vlerat sipas nenit 3 deri 7 të kësaj rregullore mund të ndryshohen, duke informuar komisionin e autorizuar profesional të paritetit.

Neni 9 Rregullat e ndërmarrjes

1 Rregullat e ndërmarrjes për vendbanimet janë të shpallura në një rregullore shtëpiake në gjuhën e banuesve. Rregullorja e shtëpisë rregullon para së gjithash:

- a) pastrimin e rregullt dhe ajrosjen e hapësirave për një shfrytëzim higjienik
 - b) shfrytëzimin e hapësirave përbashkëta (përgjithshme),
 - c) ndalimin e përgatitjes së ushqimit të ngrohtë në dhomat e fjetjes,
 - d) udhëzimet për pastrimin dhe tharjen e rrobave,
 - e) ndalimin e pirjes së duhanit në hapësira të caktuara,
 - f) kursimin e energjisë elektrike,
 - g) e drejta për vizita dhe e drejta e mysafirëve,
 - h) qetësia e natës,
 - i) rregullat e parkimit,
 - k) rregulli rreth vendbanimeve,
 - l) sjellja në raste rreziku dhe ndihma e parë,
 - m) veprimi për nënshkrimin e një sigurimi ndaj vjedhjes.
- 2 Qiradhënësi organizon:
- a) ndërrimin e mbulesave të shtratit çdo dy javë,
 - b) dezinfektimin dhe pastrimin e mbulesave dhe dyshekëve paradhënies,
 - c) pastrimin dhe ajrosjen e hapësirave,
 - c) largimin e mbeturinave në pajtim me normat për ruajtje të ambientalit,
 - e) shërbimin e pastrimit,
 - f) shërbimin postar dhe ofron dërgimin personal dhe diskret,
 - g) shërbimin në rast rreziku, përkatësisht kutinë e ndihmës së shpejt (së paku një për ndërtesë). I sëmuri, përkatësisht personi që ka pasuar fatkeqësi duhet të vendoset sipas gjendjes individuale të sëmundjes dhe fatkeqësisë,
 - h) përdorimin e pajisjeve për fikjen e zjarrit si dhe udhëzimet në rast të zjarrit.

Neni 10 Kostoja e banimit

1 Kostot e banimit duhet të përcaktohet duke marrë parasysh pajisjet dhe shpenzimet e funksionimit si dhe të banimit komfort dhe parimisht duhet të mbulojnë shpenzimet; marrëveshjet individuale janë të mundshme.

2 Palët kontraktuese e nënshkruese do të hartojnë bazat e llogaritjes së koston së banimit për palët kontraktuese lokale të komisioneve profesionale lokale të paritetit, shih shtojcën e kësaj marrëveshje plotësuese «Elementet e koston për llogaritjen e koston së banimit»).

Kapitulli 3 Hapësirat e qëndrimit dhe pajisjet sanitare në kantiere

Neni 11 Të drejtat e përgjithshme

Në kantiere, duke përjashtuar nenin 14 të kësaj marrëveshje plotësuese, duhet të vendosen hapësira qëndrimi dhe pajisje sanitare pa pagesë. Fjala është për baraka, shtëpiza apo makina ndërtimi, të cilat kanë një dyshe me të mbuluar. Pajisjet duhet të kenë madhësinë e mjaftueshme dhe duhet të kenë mundësinë e mbylljes.

Neni 12 Hapësirat e qëndrimit në kantiere

1 Hapësirat e qëndrimit duhet:

- a) t'u përgjigjen dispozitave të policisë ndaj zjarrit,
- b) të ofrojnë mundësinë e ajrosjes dhe ngrohjes,
- c) të ofrojnë tavolinë dhe një vendulje për çdo përdorues,

- d) të posedojnë një dollap për garderobe
 - e) mundësi për përgatitjen e pijeve të ngrohta si dhe përgatitjen e shujtave të zakonshme të ngrohta duke marrë parasysh dispozitat eventuale ligjore.
- 2 Për tharjen e rrobave të lagëta të punës duhet të merren masa të domosdoshme nga punëdhënësi që të nesërmen punëtorët të kenë mundësinë të punojnë me rroba të thara.

Neni 13 Pajisjet sanitare në kantier

1 Për çdo kantier është e domosdoshme një pajisje sanitare me ujë të pijshëm, mundësi të mjaftueshme pastrimi dhe toaletë, dhe sipas nevojës duhet të ndahen sipas gjinisë.

2 Sipas dispozitave të kanalizimit toaletet duhet të jenë të lidhura me një kanalizim, përndryshe duhet të instalohen toalete të terura. Për çdo 20 punëtor duhet të instalohet një toaletë. Toaletet duhet të jenë të ajrosura dhe me mundësi ndriçimi elektrik. Rekomandohet përdorimi i toaleteve mobile dhe barakave sanitare në kantiere. Nëse gjatë punës së ndërtimit bazë apo ndërtimit të brendshëm të objektit ekzistojnë numër i mjaftueshëm i toaleteve mobile, atëherë nuk ka nevojë për instalimin e pajisjeve tjera të toaleteve.

Neni 14 Përjashtimet

Nëse tek kantieret e përkohshme sipas nenit 12 dhe 13 të kësaj marrëveshje plotësuese për arsye ekonomike e teknike nuk arsyetohen pajisjet sanitare në kantier, atëherë punëdhënësi duhet të kujdeset për masa tjera duke gjetur zgjidhje zëvendësuese të përshtatshëm (p.sh pajisje mobile).

Neni 15 Dispozitat funksionale për hapësira qëndrimi dhe pajisje sanitare në kantiere

1 Hapësirat e qëndrimit duhet të jenë të lira nga pajisjet tjera dhe materiali i ndërtimit. Hapësirat në fjalë duhet pastrohen periodikisht.

2 Pajisjet sanitare duhet të mirëmbahen në gjendje përdoruese. Ato duhet të pastrohen çdo ditë dhe sipas nevojës të dezinfektohen.

3 Punëdhënësi duhet të kujdeset dhe të ofroj sapun të mjaftueshme për pastrimin e lëkurës. Sipas mundësisë duhet të ketë sasi të mjaftueshme të ujit të ngrohtë.

Kapitulli 4 Zbatimi dhe kontrolli

Neni 16 Obligimet e punëdhënësit

1 Punëdhënësi kujdeset për mirëmbajtjen e vendbanimeve / strehimoreve dhe pajisjeve të kantierit.

2 Punëdhënësi emëron personin kujdestar përgjegjës.

3 Vendbanimet si dhe pajisjet në kantiere si dhe gjërat e ruajtura nga punëtorët duhet të sigurohen nga punëdhënësi kundër zjarrit dhe dëmtimit nga uji.

Neni 17 Obligimet e punëtorëve

1 Në të gjitha rastet, kur punëdhënësi përmes kontratës së punës me shkrim obligohet t'i ofrojë punëtorit një vendbanim, punëtori obligohet të shfrytëzojë gjatë juridiksionit së kontratës këtë vendbanim. Për përjashtime kërkohet marrëveshje.

2 Punëtorët duhet t'i përmbahen rregullores shtëpiake. Ata kujdesen para së gjithash për pastërti, qetësi, rregull dhe siguri (ndalohen pajisjet për zierje në dhomë, ndalohen punët e dorës me përçues të rrymës elektrike etj.) dhe duhet t'u përmbahen udhëzimeve të punëdhënësit respektivisht të personit kujdestar të emëruar nga punëdhënësi.

3 Rryma elektrike, gazi dhe uji duhet të konsumohen vetëm kur të jetë e domosdoshme, dhe largimi i mbeturinave duhet të bëhet në mënyrë korrekte.

4 Kostoja e caktuar e banimit llogaritet nga punëdhënësi me pagën.

5 Punëtorët janë përgjegjës për çdo dëm të bërë me qëllim apo nga pakujdesia. Nëse punëtori disa herë nuk u përmbahet udhëzimeve të punëdhënësit apo të personit kujdestar përgjegjës, atëherë punëdhënësi pas vërejtjes paraprake mund ta largojë punëtorin nga vendbanimi dhe hapësirat e përbashkëta.

Neni 18 Obligimet dhe kompetencat e komisionit profesional të paritetit

1 Kontrolli i zbatimit të këtyre dispozitave është kompetencë e komisionit profesional përkatës të paritetit në nivel lokal. Komisioni profesional i paritetit në nivel lokal është kompetent dhe i autorizuar të bëjë inspektime pas paralajmërimit tek qiradhënësi. Tek kantieret e ndërtimtarisë nëntokësore vlen marrëveshja shitesë për punën nën tokë (shtojca 12).

2 Ankesat mbi moszbatimin e kësaj rregullore do të trajtohen pa vonesë nga komisioni profesional i paritetit në nivel regjional.

3 Nëse komisioni profesional i paritetit në nivel lokal gjen parregullsi, atëherë cakton një afat të mundshëm për mënjanimin e tyre. Nëse parregullsitë nuk mënjahohen në afatin e caktuar kohor, atëherë ndërmerren masa tjera, si orientimin e institucioneve të tregut të punës, enteve për dhënien e punës sipas konkursit, entit të shëndetësisë, reduktimin e qirasë gjatë gjetjes së parregullsive të mëdha etj.

Kapitulli 5 Dispozitat përfundimtare

Neni 19 Orientimi i opinionit publik mbi çështjet e hapura

Palët kontraktuese obligohen të përjashtojnë të gjitha masat që mund të njosin reputacionin e rëndësinë e sektorit kryesor të ndërtimtarisë. Ato duhet të heqin dorë nga masat në fjalë, nga dalja në opinionin publik gjatë procedurave, të cilat janë akoma të pazgjidhura nga komisioni profesional i paritetit apo akoma nuk kanë arritur të trajtohen.

Neni 20 Dispozitat kalimtare

1 Normat e hartuara në këtë marrëveshje shtesë vlejnë për vendbanimet e reja, vendqëndrimet dhe pajisjet sanitare të reja sipas nenit 2 të kësaj marrëveshje në fuqi nga 1 maj 1995.

Neni 21 Hyrja në fuqi

1 Kjo marrëveshje shtesë përtërihet për çdo vit, nëse asnjë palë nuk heq dorë nga ajo me shkrim duke ju përmbajtur një afati kohor prej tre muajsh në fund të një viti kalendarik.

2 Nëse Kontrata e Përgjithshme Kombëtare për sektorin kryesor të ndërtimitarisë (KPK) prishet, atëherë marrëveshja shtesë, në devijim të pikës 1 të këtij neni prishet në momentin e prishjes së KPK, përveç nëse palët kontraktuese të KPK merren vesh shprehimisht për vazhdimin e juridiksionit.

Shtojcë

E Marrëveshjes shtesë mbi strehimin e punëtorëve, higjienën dhe rregullin në kantiere:

Elementet e kostos për llogaritjen e qirasë së banimit

Duke u mbështetur në nenin 10 paragrafi 2 të kësaj marrëveshje shtesë për llogaritjen e qirasë së banimit do të merren parasysh këto elemente:

a) Kostoja e investimit:

1. amortizimi i ndërtesës,
2. amortizimi i pajisjeve,
3. përqindja e interesit.

Praktika lokale e së drejtës së qiramarrjes do të merret parasysh.

b) Kostoja e funksionimit

1. mirëmbajtja,
2. rryma elektrike, uji, pastrimi, TV, rrobat etj.,
3. ngrohja,
4. taksat dhe sigurimet.

Shtojca 8

**Tabela për llogaritjen
procentuale të rrogës së
pushimve (neni 34,
paragrafi 2 i KPK) dhe
rrogës së trembëdhjetë
(neni 50 KPK)**

8

Tabela për llogaritjen procentuale të rrogës së pushimve (neni 34, paragrafi 2 i KPK) dhe rrogës së trembëdhjetë (neni 50 KPK)

Llojet e rrogave dhe kompensimeve tjera të paguara nga punëdhënësi për punëtorët		E drejta e punëtorëve për	
		<i>Rrogën pushimeve</i>	<i>Rrogën e trembëdhjetë</i>
1.	Rrogat bazë		
101	Rroga në orë, rroga në javë, rroga në muaj	po	po
2.	Kompensime tjera me karakter të rrogës		
201	Rroga e trembëdhjetë	jo	jo
202	Pjesëmarrje në fitim apo xhiro (qarkullim), shpërblim shtesë, provizione	jo	jo
203	Honorare si anëtar i këshillit drejtues	jo	jo
204	Tantiemë (përqindje nga fitimi)	jo	jo
3.	Rroga gjatë mungesës		
301	Rroga e pushimeve (pagesa apo e drejta për pushim)	jo	po
302	Rroga për ditët e festave	po	po
303	Rroga për mungesa të pa shmangshme sipas KPP	po	po
304	Kompensim në rast të motit të keq sipas KPP	po	po
305	Kompensim i rrogës në rast të punës me orar të reduktuar	po	po
306	Kompensimi i rrogës nga fondi i paritetit gjatë shkollimit apo edukimit të vazhdueshëm	jo ¹⁾	jo ¹⁾
307	Pagesa e rrogës gjatë shkollimit, nëse e tejkalon kompensimin nga fondi i paritetit	po	po
308	Kompensimi i pagës gjatë sëmundjes, kompensimi i pagës gjatë fatkeqësisë nga Suva	jo ²⁾	jo ²⁾
309	Pagesa e rrogës gjatë sëmundjes dhe fatkeqësisë, nëse pagesa e sigurimeve e tejkalon llojin e rrogës 308 (duke përfshirë ditët e para të papaguara nga Suva)	po	po
310	Pagesa e rrogës gjatë shërbimit të obligueshëm ushtarak, shërbimit të mbrojtjes dhe atij civil	po ³⁾	po ³⁾
311	Shpërblimi i besnikërisë në përputhje me nenin 38 paragrafi 4 i KPP	po	po
4.	Rrogat natyrale		
401	Rrogat natyrale	po	po
402	Shtesat për banim	po	po
403	Banesa shërbimi	jo	po
5.	Shtesat dhe premisë (shpërblimet)		
501	Shtesat për orët jashtë orarit të punës	po ⁴⁾	po ⁴⁾
502	Shtesat për punën gjatë natës dhe të dielave	po	po
503	Shtesat për kohën e udhëtimit	po ⁴⁾	po ⁴⁾
504	Shtesat për punën në ujë dhe baltë, shtesa për vështirësi tjera	po ⁴⁾	po ⁴⁾

505	Shtesa për punën nëntokësore	po	po
506	Premi (shpërblime) për durim, përparim dhe sukses në punë	po	po
6. Kompensime dhe heqja e shpenzimeve			
601	Kompensimi i shpenzimeve të drekës	jo	jo
602	Kompensimi i shpenzimeve për transferim, nëse kompensohen shpenzimet	jo	jo
603	Kompensimi i shpenzimeve të rrugës, kompensohen shpenzimet	jo	jo
604	Bileta me çmime të reduktuara-, apo bileta të lira udhëtimi	jo	jo
605	Kompensim i shpenzimeve për transferim	jo	jo
606	Pagesa e shtesave të të gjitha llojeve	jo	jo
607	Shtesat e punës natën, nëse kompensohen shpenzimet	jo	jo
608	Shtesat e punës në lartësi, nëse kompensohen shpenzimet	jo	jo
609	Shtesat për rroba pune në rast të përdorimit të jashtzakonshëm	jo	jo
7. Dhuratat dhe pagesat e ndryshme			
701	Dhuratë, përkatësisht zhdëmtim me rastin e moshës së punës,	jo	jo
702	Dhuratë natyrale	jo	jo
703	Zhdëmtim me rastin e largimit nga puna	jo	jo
704	Pagesa e mëtejme e rrogës në rast vdekje	jo	po
705	Pagesat e punëdhënësit për shpenzimet e shkollimit (p.sh. paratë e kursit)	jo	jo
706	Dhuratat me rastin e jubileut të ndërmarrjes, çdo 25 vjet	jo	jo
707	Kontributet e AHV/IV/EO/ALV si dhe tatimet, të cilat merren përsipër nga punëdhënësi	jo	jo
708	Premitë e njohjes/pranimit për propozime	jo	jo
709	Shtesat e familjes, fëmijëve, të lindjes dhe të martesës	jo	jo
710	Premi tjera të besnikërisë tjera nga shifra 311	jo	jo
8.	Rrogat për punën me akord	5)	5)

- ¹⁾ Pagesa e pushimit dhe pjesës së rrogës së trembëdhjetë janë të përfshira në pagesat e fondit të paritetit.
- ²⁾ Pagesa e pushimit dhe pjesës e rrogës së trembëdhjetë janë të përfshira në pagesën e «Suva», ndërsa në rast sëmundje duhet të sigurohet tek sigurimi i rrogës në rast sëmundjeje
- ³⁾ Pagesa e pushimit dhe pjesës së rrogës së trembëdhjetë janë të përfshira në pagesat e fondit të paritetit.
- ⁴⁾ Pagesa e pushimit dhe pjesës së rrogës së trembëdhjetë është e mundur vetëm atëherë kur orët jashtë orarit të punës (pozicioni 501), koha e udhëtimit (pozicioni 503) përkatësisht shtesat për punën në ujë dhe baltë, dhe për vështirësi tjera (pozicioni 504) llogariten në orë, por jo nëse pagesa bëhet në mënyrë paushalle me para të gatshme sipas marrëveshjes më parë. Nuk kanë të drejtë në pagesën e pushimit dhe pjesës së rrogës së trembëdhjetë, nga pozicionet e përmendura as punëtorët me rrogë mujore.
- ⁵⁾ Gjatë punësimit të punëtorëve në akord ekziston një rregullore në përputhje me nenin 46 KPK (Rroga për punën në akord) dhe nenin 50 KPK (rregullat për pagesën), para së gjithash sa i përket pagesës së pushimit dhe rrogës së trembëdhjetë.

Shtojca 12

**Marrëveshja shtesë
për KPK për punën nën tokë
«Marrëveshja për punën
nën tokë»**

Marrëveshja shtesë e KPK për punën nën tokë «Marrëveshja për punën nën tokë»

e datës 25 maj 2010

Duke u mbështetur në nenin 4 të KPK-së dhe nenin 58 të KPK, palët kontraktuese të KPK-së lidhin këtë marrëveshje plotësuese, e cila vlen për të gjitha ndër-marrjet që kryejnë punë në ndërtimtarinë nën tokë:

Kapitulli 1 Të përgjithshme

Neni 1 Pozita ndaj KPK-së

1 Kjo marrëveshje plotësuese vlen në kuptim të Kontratës së Përgjithshme të Punës si plotësim dhe është pjesë integrale e KPK-së.

2 Nëse në marrëveshjen plotësuese nuk gjinden rregulla atëherë vlen KPK, e nëse edhe atje nuk gjinden dispozitat e duhura atëherë vlen e drejta obligative DO (OR).

3 Në rast kundërthëniesh në mes të marrëveshjes plotësuese dhe të KPK-së, marrëveshja në fjalë ka përparësi.

Neni 2 Juridiksioni

Kjo marrëveshje plotësuese vlen për të gjitha ndërmarrjet (Punëdhënësit) sipas KPK-së, të cilat kryejnë punë nëntokësore¹ në hapësirën gjeografike ku vlen KPK-ja. Këtë marrëveshje plotësuese palët kontraktuese mund ta zgjerojnë edhe në kantiere të tjera të ndërtimtarisë nën tokë (sidomos ndërtimet aneksore).

Neni 3 Deklarata për fuqizim

Palët kontraktuese angazhohen për fuqizimin e tërësishëm apo të pjesëve më të rëndësishme të kësaj marrëveshje plotësuese, sa ma shpejtë që është e mundshme.

Neni 4 Respektimi i dispozitave

Palët nënshkruese të marrëveshjes kujdesen që dispozitat e KPK-së dhe të kësaj marrëveshjeje plotësuese të nënshkruhen dhe të respektohen edhe nga ndërmarrjet që nuk janë të kyçura në Shoqatën e Mjeshtërve të Ndërtimtarisë apo ndërmarrjet e huaja si dhe nga nën-ndërmarrjet dhe ndërmarrjet që ndërmjetësojnë punëtorët (punëtorë me marrëdhënie të përkohshme).

¹ Përshkrimi i nocionit «Puna nëntokësore» në nenin 58 paragrafi 2 KPK.

Kapitulli 2: Realizimi, zbatimi, kontrolli dhe komisioni profesional i paritetit për ndërtimtarinë nën tokë

Neni 5 Parimi themelor

Për realizimin, zbatimin dhe kontrollin e kësaj marrëveshje plotësuese janë kompetente palët kontraktuese respektivisht komisioni profesional i paritetit të ndërtimtarisë nën tokë.

Neni 6 Zgjedhja e komisionit profesional të paritetit nën tokë dhe detyrat e tij

1 Me qëllim të realizimit, zbatimit dhe kontrollit të kësaj marrëveshjeje plotësuese, ekziston një komision profesional të paritetit – nën tokë, i cili përbëhet nga më së shumti pesë anëtarë të secilës palë, të punëdhënës ve dhe punëtorëve që janë të inkuadruar në këtë marrëveshje plotësuese.

2 Sipas nenit 375b paragrafi 1 nën c DO, komisioni profesional i paritetit është i autorizuar për zbatimin e përbashkët të dënimeve konvencionale kundër punëdhënës ve dhe punëtorëve pjesëmarrës. Veprimtarinë kontrolluese komisioni profesional i paritetit mund ta delegojë te komisionet lokale të paritetit të sektorit kryesor të ndërtimtarisë.

3 Detyrat e komisionit profesional të paritetit «nën tokë» bazohen në nenin 76 dhe në vazhdim të KPK-së si dhe në marrëveshjen plotësuese mbi bashkëveprimin në sektorin kryesor të ndërtimtarisë (shtojca nr. 5 e KPK-së) dhe në marrëveshjen plotësuese mbi strehimin e punëtorëve dhe higjienën dhe rregullin në kantiere (shtojca nr. 6 e KPK-së).

Neni 7 Gjyqi i Arbitrazhit

Në rast se brenda komisionit të paritetit nuk arrihet marrëveshja, duke u mbështetur në dispozitat e KPK-së, rasti kontestues mund të bartet në Gjyqin e Arbitrazhit të Zvicrës (neni 14 dhe vazhdim i KPK-së). Vendimi i tij është përfundimtar.

Kapitulli 3 Dispozitat e kontratës së punës ë

Neni 8 Kontrata e punës me shkrim

Të gjithë punëtorët kanë të drejtë në kontratë të punës me shkrim me të dhënat e kategorisë së pagës sipas nenit 21-të, shtojca 12-të e KPK-së.

Neni 9 Punëtorët me marrëdhënie të përkohshme dhe siguria në punë

Punëtorët me marrëdhënie të përkohshme të punës me të drejtë për shtesat e punës në tunel sipas nenit 16, shkronja a (kategoria 1) shtojca 12 e KPK-së mund të punësohen në kantieret e tunelit vetëm nëse dëshmojnë se kanë punuar së paku 6 muaj në sektorin kryesor të ndërtimtarisë. Punëtorët me marrëdhënie të përkohshme të punës duhet vijojnë kualifikimet e njëjta mbi sigurinë si punëtorët me marrëdhënie fikse të punës dhe duhet të dëshmojnë së paku një kualifikim njëditor mbi sigurinë. Testi i kontrollit mjekësor duhet të bëhet para fillimit të punës.

Neni 10 Orari i punës

1 Oraret maksimale vjetore të punës mbështeten në nenin 24 KPK. Orari maksimal javor i punës mbështetet në dispozitat e nenit 25 dhe në vazhdim të KPK-së, si dhe dispozitat e legjislacionit të punës, duke përjashtuar nenin 11 të kësaj marrëveshje plotësuese (planet e punës me ndërrime).

2 Kalendarët e orarit të punës për kantieret përkatëse caktohen nga ndërmarrjet. Për këtë duhet të informohen me kohë dhe para fillimit të punës komisionet profesionale të paritetit, përkatësisht duhet të ndërrohen së paku një herë në vit. Në rast mungese të kalendarit mbi orarin e punës, komisioni i paritetit mbështetur në nenin 11 të kësaj marrëveshjeje, cakton kalendarin mbi orarin e punës për kantierin përkatës.

3 Orari i punës në ndërtimtarinë nën tokë përbëhet nga koha e punës në vendin e punës dhe nga pauza eventuale në vend – nëse nuk është i mundshëm apo i paraparë kthimi në portal pas gjysmës së ndërrimit.

Neni 11 Puna me turne

1 Puna me ndërrime lejohet po qe se për shkaqe teknike apo ekonomike ajo nuk mund të rregullohet ndryshe. Me këtë rast duhet të respektohen dispozitat e KPK-së respektivisht të legjislacionit të punës².

2 Mbi planet e punës me turne të përcaktuar nga ndërmarrja duhet të njoftohet komisioni profesional i paritetit. Në rast të papërshtatshmërisë së planeve ky komision mund të ankohet duke argumentuar apo t'i hedh poshtë këto plane.

Neni 12 Koha e rrugës

1 Si «kohë e rrugës» cilësohet koha që i nevojitet punëtorit për të shkuar nga portali i tunelit në vendin e punës. Kjo kohë dhe eventualisht edhe koha e udhëtimit sipas nenit 54 KPK, duhet të paguhet bashkë me rrogën bazë.

2 Orët e përgjithshme vjetore të punës mund të tejkalohen maksimalisht – bashkë me kohën e rrugës, mirëpo maksimalisht 2300 orë (orari i punës bashkë me kohën e rrugës).

Neni 13 Vendtakimi

Sipas nenit 54 KPK (koha e udhëtimit) parimisht si vendtakim vlen strehimorja bazë apo ajo e banimit në vendin ku zhvillohet puna nën tokë. Nëse koha e udhëtimit të përditshëm deri te portali i tunelit është më shumë se 30 minuta, atëherë ajo duhet të paguhet analog me nenin 54 KPK.

Neni 14 Kompensimi i drekës dhe shpenzimet e transferimit

1 Çdo punëtor ka të drejtë në një kompensim ditor të ushqimit. Lartësia e tij rregullohet sipas kuptimit të Neni 60 të KPK-së.

² Neni 23 në vazhdim i Ligji i Punës si dhe Udhëzimet Administrative (ArGV I dhe ArGV II për Ligjin e Punës).

1.1 Në kantiere me turne të pa ndërprerje sipas nenit 17 paragrafi 2 shtojca 12 e KPK-së çdo punëtor ka të drejtë në një shtesë për kompensim të drekës me një shumë prej CHF 13.-.

1.2 Në të gjitha shtojcat e KPK-së ku ka dhe nëse ka kompensime më të larta të drekës se sa në shtojcën 12, do të vlejë kompensimet më të larta.

1.3 Për përmirësimin e kualitetit të marrjes së ushqimit në kantinë dhe shtimit të ofertave në kantier me punën me turne pa ndërprerje ndërmarrja paguan edhe CHF 3.- shtesë në ditë për çdo punëmarrës. Përmes këtij veprimi partnerët socialë promovojnë një kulturë ushqimi të shëndetshme në mënyrë të ndërgjegjshme dhe ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të kujdesit në kantiere.

2 Kompensime tjera shtesë paguhet në rastet të përshkruara në vijim:

2.1 Gjatë kthimit të përditshëm të punëtorit nga vendi i punës në vendbanim, përkatësisht në magazinën e punëdhënësit sipas nenit 54 të KPK-së.

2.2 Gjatë kthimit jo të përditshëm të punëtorit nga vendi i punës në vendbanim përkatësisht në magazinën e punëdhënësit:

a) Bazuar në planin e vlefshëm të ndërrimeve për ditë të caktuara, punëmarrësi ka të drejtë për zëvendësim të plotë (Strehimi dhe ushqimi). Çdo punëmarrësi duhet siguruar mëngjesi dhe një racion kryesor i llojlojshëm gjatë ditës. Në vend të një mëngjesi, në rast kërkese duhet siguruar një kompensim i barasvlershëm. Banimi dhe racioni i dytë kryesor duhet të kompensohen financiarisht, duke mbështetur kompensimin e ushqimit sipas shifrës 1. të lartpërmendur dhe të shtesës së kujdesit sipas shifrës 1.1. si më sipër. Lartësia e pagesës për Banimin duhet të jetë në lartësinë e çmimit për një dhomë të veçantë në banesën e përkohshme. Përdorimi i një banese të përkohshme të siguruar nga punëdhënësi si dhe konsumimi i racionit të dytë kryesor, punëmarrësit do t'i llogariten, përkatësisht do t'i zbriten nga roga e tij.

Gjatë një ndërprerje të punës më pak se 48 orë, edhe gjatë ndërprerjes punëtori ka të drejtë po ashtu në kompensim të plotë (Strehimi dhe ushqimi) në përputhje me shifrën 2.2 germa a, paragrafi 1 si më sipër. Nëse ndërprerja e punës është më e gjatë se 48 orë atëherë punëtorët nuk ka të drejtë në kompensim të plotë. Në këtë rast shpenzimet e strehimit nuk barten nga punëtori. Nëse punëmarrësi nuk ofron kantinë dhe një strehim të përkohshëm, atëherë kompensimi i plotë duhet të sigurohet.

b) E drejta në kompensimin e kohës së udhëtimit

– për punëtorët që kthehen çdo javë në shtëpinë e tyre për vajtje e ardhje kanë të drejtë në CHF 90.- (kjo shumë paraqet një kompensim të përgjithshëm prej mesatarisht 3 orësh)

– gjatë punës me ndërrime pa ndërprerje CHF 120.- për vajtje e ardhje bashkë (kjo shumë paraqet një kompensim të përgjithshëm prej mesatarisht 4 orësh). Ky kompensim paguhet edhe atëherë kur punëtori nuk udhëton për në shtëpinë e tij.

c) E drejta në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit: për ndërprerjet më të gjata se 48 orë paguhet shpenzimet efektive të udhëtimit me tren, klasa e dytë, mirëpo më së shumti deri tek kufiri i vendit. Nëse organizohet ndonjë transport i përbashkët apo punëtori nuk udhëton për në shtëpi atëherë ky kompensim nuk paguhet.

Neni 15 Shtesat dhe mbishtesat në përgjithësi

Punëtorët të cilët punojnë nën tokë me ndërrime apo pandërprerë me ndërrime kanë të drejtë në shtesa dhe shtime normale sipas nenit 56 KPK (puna të dielave) si dhe neni 59 KPK (puna e pandërprerë natën). Punëtorët të cilët angazhohen në punë të pandërprerë në orarin normal të punës, do të kompensohen me shtesën e të shtunës sipas Neni 27, paragrafi 3 i KPK-së, nëse punohet pesë ditë radhazi.

Neni 16 Shtesat për punën nën tokë

Shtesat për punët nën tokë sipas nenit 58 paragrafi 2 i KPK janë:

- a) *Kategoria 1:* CHF 5.– në orë pune për punëtorët që kryejnë këto veprimtari: shpërthimi (shpimi), gërmimi dhe punët për siguri duke përfshirë unazat gjatë shpimit të pusit, izolimi dhe injektimi (duke përjashtuar rastet e përmendura nën 2). Punët në betonimin e vendit për veshjen e jashtme e të brendshme dhe konstruksonet e lidhura me këtë veshje.
 - b) *Kategoria 2:* CHF 3.– në orë pune për punët e brendshme nëse për kantieri nuk kërkohet veshja përkatësisht nëse kantieri në vendin e punës posedon një veshje. Si punë të brendshme vlejnë para së gjithash: Shtresa e themelit, lidhjet anësore, shtresat, ndërtimet e elementeve të fabrikua më parë, ndërtimet e brendshme të pavarura nga veshjet, si ndërtimet e mëhershme të vendstrehimit (bunkerit) si dhe (tek tunelet e rrugëve) pas veshjes së brendshme injektimit e kryera si dhe largimi i ujit me pajisjet e largimit të ujit me shtresë nga themeli.
- 2 Në rast të sanimit të tuneleve, në këto raste duhet të paguhet shtesat për punën nën tokë sipas nenit 16 paragrafi 1 germa a dhe b, dhe atë pavarësisht nëse puna në tunel bëhet nën tokë apo mbi tokë.
- a) Shtesa e kategorisë së 1 duhet të paguhet vetëm punët e përcaktuara në nenin 16 paragrafi 1 germa a, në rastet kur ka thyerje, zgjerim dhe punë rikonstruktive me gurë dhe kontaktit me shkëmbinj, dhe atë në të gjitha rastet për gjithë gjatësinë e tunelit.
 - b) Shtesa e kategorisë së 2 është e caktuar për punët sipas nenit 16 paragrafi 1 germa b, për tërë gjatësinë e tunelit, por vetëm për rastet kur gjatësia e tunelit është 300 metra apo më shumë.

Neni 17 Shtesat për punën e pandërprerë me turne

1 Tek puna e pandërprerë me ndërrime shtesa për një orë pune është CHF 1.50 në orë. Përmes kësaj është plotësuar plotësisht kërkesa për një shtesë për të gjitha orët e punës të kryera të shtunave sipas nenit 27 paragrafi 3 i KPK.

2 Puna e pandërprerë me ndërrime sipas kësaj dispozite është atëherë kur sipas planeve të punës me ndërrime të njohura nga sekretariati shtetëror për ekonomi (SECO) punohet gjatë shtatë ditëve të javës, pra edhe të shtunave dhe të dielave. Kjo vlen për ndërmarrjet me një dhe me shumë ndërrime.

Neni 18 Shtesat e punës natën

Shtesat e punës natën për punë të vazhdueshme gjatë natës paguhet sipas Neni 59 të KPK.

Neni 19 Shtesa në kohë për punën gjatë natës

1 Shtesat në kohë për punën gjatë natës duke filluar nga 1 gushti 2003 llogariten sipas nenit 17b i legjislacionit të punës.

2 Shtesa në kohë për punën gjatë natës është në planet e punës me turne të ndër-marrjes dhe duhet të zbatohet në përputhje me numrin e përgjithshëm të orëve të punës sipas KPK-së.

Neni 20 Rrogat bazë

Për të gjitha kantieret e punës nën tokë, të cilat janë në varësi të kësaj marrëveshjeje plotësuese, vlejné këto rroga bazë (rrogat mujore dhe rrogat në orë) të zonës «E KUQE» të rrogave bazë sipas nenit 41 KPK, në përputhje me Marrëveshjet përkatëse shtesë.

Neni 21 Kategoritë e rrogave për ndërtimtarinë nën tokë

1 Parimisht për ndërtimtarinë nën tokë vlejné kategoritë e pagave sipas nenit 42 e në vazhdim të KPK-së.

2 Mirëpo për kategoritë A dhe Q vlejné këto emëtime:

- Kat. A: minator, punëtor tuneli me përgatitje profesionale (deri tani [gunitëur, jumbist], makinist) dhe personeli i punëtorisë (ndihmës mekanik, ndihmës elektrikist etj.) pa përgatitje profesionale i pranuar nga ana e punëdhënësit.
- Kat. B: Ndërtues tuneli (deri tani [gunitëur, shofer i TBM – së, jumbist]) dhe personeli i punëtorisë me përgatitje profesionale (axhustator, mekanik, elektrikist, makinist, shofer i kamionëve) me librezë profesionale apo të njohur nga ana e punëdhënësit. Të drejtë në pagën e kategorisë Q kanë edhe punëtorët me librezë profesionale të pranuar në nivel federal një zeje të kryer në sektorin kryesor të ndërtimtarisë apo poseduesit e dëftesës profesionale të kryer jashtë Zvicrës me vlerë të njëjtë.

Neni 22 Vendbanimet në kantiere

1 Për vendbanimet gjatë punës nën tokë vlen parimisht shtojca 6 e KPK-së

2 Tek kantieret me vend strehimore të përkohshme punëtorët kanë të drejtë në një dhomë njëshe me madhësi sipas shtojcës 6 të KPK-së.

Kapitulli 4 Dispozitat përfundimtare

Neni 23 Kohëzgjatja e kontratës

1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi parimisht më 1 janar 2011, sidoqoftë më së shpejti në datën deklarimit për detyrimin obligativ të përgjithshëm nga Këshilli Federal (Bundesrat). Vlefshmëria e marrëveshjes është analoge me vlefshmërinë e KPK.

2 Ndryshimet eventuale apo përshtatjet e kësaj marrëveshjeje plotësuese mund të arrihen nga palët e KPK-së gjatë kohëzgjatjes së juridiksionit.

3 Shfuqizuar

Neni 24 Dispozitat kalimtare për ushqimin dhe zhvendosjen

Për kantieret e ndërtimitarisë që punojnë më 1 janar 2011, rregullat ekzistuese specifike të ndërtimitarisë vlejnë deri sa të jenë të hapura këto kantiere.

Për Shoqatën e Mjerhtërive Ndërtimitarisë (SHMN)

D. Lehmann, W. Messmer, H. Bütikofer

Për Sindikatën Unia

H. U. Scheidegger, A. Rieger, A. Kaufmann

Për Sindikatën Syna

E. Zülle, K. Regotz, P.-A. Grosjean

Shtojca 13

**Marrëveshja shtesë
«Ndërtimtaria e ulët tokësore
dhe ajo speciale në thellësi»**

Marrëveshja shtesë «Ndërtimtaria e ulët tokësore dhe ajo speciale në thellësi»

Bazuar në nenin 4 te KPK-së, palët kontraktuese lidhin këtë marrëveshje shtesë për të gjitha punët në ndërtimtarinë e ulët tokësore dhe të ulët speciale.

1. Të përgjithshme

Neni 1 Pozita ndaj KPK-së

Kjo marrëveshje shtesë vlen në kuptim të kontratës së përgjithshme si plotësim dhe është pjesë integrale e KPK-së sipas nenit 9 KPK. Në rast dyshimi, kjo marrëveshje ka përparësi ndaj KPK-së.

Neni 2 Juridiksioni

1 *Në aspektin hapësinor dhe të ndërmarrjeve:* Kjo marrëveshje shtesë vlen për të gjitha ndërmarrjet dhe kantieret, veprimtaria e të cilave kryesisht ndërlidhet me ndërtimtarinë e ulët tokësore apo ndërtimtarinë e ulët speciale, siç janë shpimi me sondë, mbështetja speciale me hunj, muret me të çara, ngritja e mureve të shtuposura e të papërshkueshme nga uji, ngulja e hunjve në tokë, injektimet, jeting-u, ulja e nivelit të ujit, nxjerrja e burimeve të ujit, të kryera në fushën e juridiksionit të KPK-së apo për ndërmarrjet që posedojnë ndonjë repart për veprimtari të këtitlla.

2 *Juridiksioni Personalisht:* Kjo marrëveshje shtesë vlen për të gjithë punëtorët e punësuar në ndërmarrjet e numëruara nën pikën 1 të këtij neni (pa marrë parasysh mënyrën e pagesës dhe vendin ku punojnë), të cilët janë aktiv në kantiere dhe ndërmarrje ndihmëse të ndërmarrjeve ndërtimore. Kjo ka të bëjë sidomos me:

- a) kryepunëtorët (më parë kryemjeshtër për shpim II)
- b) punëtor për punë tokësore, mekanik, axhustator, drejtues i makinave të mëdha si vozitësit e ekskavatorëve, drejtues i mjeteve të vogla lëvizëse, personeli ndihmës.

Kjo marrëveshje plotësuese nuk vlen për kryepunëtorët e ndërtimtarisë së ulët (kryemjeshtër për shpim I).

- 3 Shpallja e obligueshme e Kontratës për tërë degën-fuqizimi.

Neni 3 Respektimi i përgjithshëm i dispozitave

Palët kontraktuese të marrëveshjes kujdesen që dispozitat e KPK-së dhe të kësaj marrëveshjeje shtesë të nënshkruhen dhe të respektohen edhe nga ndërmarrjet që nuk janë anëtare në Shoqatën e Mjeshtërve të Ndërtimtarisë respektivisht në Shoqatën e Punëdhënësve të Ndërtimtarisë së ulët tokësore dhe speciale në thellësi apo ndërmarrjet e huaja si dhe nga nën-ndërmarrjet dhe ndërmarrjet që ndërmjetësojnë punëtorët (me marrëdhënie të përkohshme pune).

Neni 4 Zbatimi

1 Për realizimin, zbatimin dhe kontrollin e kësaj marrëveshjeje shtesë, kompetent është komisioni lokal i paritetit në selinë e kantierit. Për këshilla profesionale ai mund të thërrasë një ekspert të emëruar nga palët kontraktuese të kësaj marrëveshjeje plotësuese.

2 Kur bëhet fjalë për punë që ndërlidhen me ndërtimtarinë nën tokë sipas shtojcës 12 të KPK, me përjashtim të pikës 1 të këtij neni, kompetent është komisioni profesional i paritetit për ndërtimtarinë nën tokë. Për këshilla profesionale ai mund të thërrasë një ekspert të emëruar nga palët kontraktuese të kësaj marrëveshjeje shtesë.

2. Pjesa materiale

Neni 5 Orari i punës

1 Dispozitat e KPK-së mbi orarin e punës aplikohen.

2 Kalendar i orarit të punës për ndërmarrjet përkatëse përcaktohet nga ndërmarrja apo eventualisht nga bashkësia punonjëse. Kalendar i orarit të punës duhet të dorëzohet me kohë para fillimit të punës respektivisht të përtërihet çdo vit pranë:

- a) komisionit lokal të paritetit në selinë e kantierit apo
- b) komisionit profesional të paritetit për ndërtimtarinë nën tokë nëse është fjala për punë që ndërlidhen me ndërtimtarinë nën tokë sipas shtojcës 12 të KPK.

Neni 6 Kategoritë dhe zonat e rrogave

1 Në plotësim të nenit 42 të KPK-së personeli i shpimit renditet në këtë kategori të rrogave:

Kategoria e rrogës

Emërtimi

V (kryepunëtor)

Kryepunëtor (më parë kryemjeshtër i shpimit II), i cili ka përfunduar shkollën përgatitore për ndërtimtarinë e ulët dhe speciale apo nëse nga punëdhënësi është emëruar si kryepunëtor.

Q (Punëtor i kualifikuar me profesion)

punëtor për punë tokësore, mekanik, axhustator etj.

A (Punëtor i kualifikuar)

specialistë të kualifikuar për punë të shpimit, drejtues makinash, të cilët:

1. disponojnë me diplomë profesionale apo
2. përcaktohen si të tillë nga ndërmarrja. Me rastin e ndërrimit të vendit të punës në një ndërmarrje tjetër punëtori mbetet në kategorinë A

B (Punëtor me njohuri profesionale)

Punëtor për shpim me njohuri profesionale, drejtues i makinave të vogla, siç është vozitësi i dampetit etj., i cili në bazë të kualifikimit të mirë nga punëdhënësi është klasifikuar nga kategoria C në kategorinë B. Me rastin e ndërrimit të vendit të

punës në një ndërmarrje tjetër punëtori mbetet në kategorinë B.

C (Punëtor pa njohuri profesionale)

Punëtor për shpim pa njohuri profesionale (fillerstar, punëtor ndihmës).

2 Për të gjitha kantieret që janë në varësi të kësaj marrëveshjeje plotësuese vlejnjë së paku rrogat bazë të vitit 2013 (rrogat mujore dhe paga e orës) të zonës së kaltër të rrogave bazë sipas nenit 41 KPK (prej datës 1 prill 2012):

Zonat	Kategoritë e pagave				
	V	Q	A	B	C
E KALTËR	6056/34.40 (6026/34.25)	5531/31.40 (5503/31.25)	5327/30.25 (5300/30.10)	4958/28.20 (4933/28.05)	4459/25.35 (4437/25.20)

Neni 7 Shtesat e rrogës

1 *Puna të shtunave:* Për punën të shtunave – nëse nuk është fjala për shfrytëzimin paraprak apo të mëvonshëm si ditë pushimi paguhet kjo shtesë:

- prej orës 5.00 (verës) respektivisht prej orës 6.00 (dimrit) deri në orën 17.00: 50 %
- prej orës 17.00 100 %

2 *Puna të dielave dhe gjatë festave të përcaktuara me ligj:* Për punën të dielave (deri të hënën në orën 05.00 gjatë verës respektivisht 06.00 gjatë dimrit) apo punën gjatë festave të përcaktuara me ligj, por jo gjatë festave lokale, paguhet një shtesë prej 100 për qind.

3 *Orët për mirëmbajtjen e pompave:* Me përjashtim të pikës 2 të këtij neni për mirëmbajtjen e pompave nuk paguhet kurrfarë shtese.

Neni 8 Kompensimi i shpenzimeve me rastin e transferimit, koha e udhëtimit

1 *Parimi themelor:* Vlejnjë dispozitat e KPK-së me përjashtim të dispozitave vijuese:

2 *Kompensimi i shpenzimeve në rast të moskthimit të përditshëm në selinë e ndërmarrjes:* Nëse kthimi i përditshëm në selinë e ndërmarrjes nuk është i mundshëm, shtesat në rrogë dhe kompensimi i shpenzimeve është si vijon:

- CHF 70.– për çdo ditë pune në rast të fjetjes në bujtinë dhe të ngjashme;
- CHF 37.50 për çdo ditë pune në rast të fjetjes në baraka, automjete banimi etj., ku ekziston mundësia e zierjes së ushqimit apo kantina me fjetje falas;
- kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit me transportin publik (bileta e klasës së dytë) nga vendi i punës në selinë e ndërmarrjes për çdo fundjavë duke përjashtuar pjesën nën d të kësaj pike
- nëse anulohet udhëtimi në pushim, atëherë gjatë ditëve të lira të punës paguhet shtesa ashtu si gjatë ditëve të punës. Në rast të kthimit të përjavshëm në selinë e ndërmarrjes, koha e udhëtimit për vajtje-ardhje, e cila tejkalon tri orë, kompensohet së bashku ashtu si koha e punës (pa shtesa).

3 *Kompensimi i shpenzimeve në rast të kthimit të përditshëm në selinë e ndërmarrjes:* Në rast se është i mundshëm kthimi i përditshëm në selinë e ndërmarrjes, shtesa (kompensimi paushall i drekës) arrin në CHF 12.50 për çdo ditë pune.

4 *Kompensimi i shpenzimeve efektive*: Nëse punëtori pretendon se shtesat që i paguhen atij sipas pikës 2 dhe 3 të këtij neni nuk mbulojnë shpenzimet për fjetje dhe ushqim dhe nëse këtë e dëshmon me llogari, atëherë atij duhet t'i mbulohen shpenzimet e tjera nëse nuk mund të gjenden mundësi më të lira fjetjeje dhe ushqimi.

Neni 9 Ditët e festave

1 *Festat që kompensohen*: Festat që kompensohen mbështeten në aplikimin e nenit 38 të KPK-së sipas rregullores që vlen në selinë e kantierit.

2 *Kompensimi i përgjithshëm (paushall)*: Ndërmarrjet kanë të drejtë që në vend të pagesës së festave sipas pikës 1 të këtij neni të bëjnë një kompensim paushall në lartësi prej tre për qind (3%) të rrogës. Kështu kompensimi për mungesën e rrogës gjatë festave të përcaktuara me ligj mbulohet plotësisht.

3. Dispozitat përfundimtare

Neni 10 Kohëzgjatja e kontratës

1 *Hyrja në fuqi*: Kjo marrëveshje shtesë hyn në fuqi bashkë me KPK-në dhe parimisht vlen për aq kohë sa vlen edhe KPK-ja duke përjashtuar pikën 3 të këtij neni.

2 *Ndryshimet*: Ndryshimet eventuale apo përshtatjet e kësaj marrëveshje shtesë mund të arrihen nga palët e KPK-së dhe nga Shoqata e Punëdhënësve të Ndërtimitarisë së ulët dhe asaj speciale gjatë kohëzgjatjes së juridiksionit.

3 *Prishja e marrëveshjes*: Kjo marrëveshje shtesë mund të priset nga Shoqata e Mjeshtëurve të Ndërtimitarisë bashkë me Shoqatën e Punëdhënësve të Ndërtimitarisë së ulët dhe asaj speciale dhe / apo nga Shoqatat e Punëtorëve (Sindikatat) që janë pjesëmarrëse në këtë marrëveshje shtesë, duke respektuar afatin tre mujor, gjithnjë në fund të vitit.

Shtojca 15

**Katalog për kriteret e
klasifikimit për kategoritë e
rrogave A dhe Q si dhe fletë
udhëzimi i KZPZ mbi
pranimin e kualifikimeve
profesionale të arritura
jashtë Zvicrës**

Katalog për kriteret e klasifikimit për kategoritë e rrogave A dhe Q

Duke u mbështetur në nenin 3 paragrafi 1 dhe nenin 42 Komisioni Zviceran Paritar i Zbatimit (KZPZ¹) për klasifikim në kategoritë e rrogave A dhe Q përcakton si në vijim:

1. Kategoria e rrogës A (Punëtor i kualifikuar i ndërtimtarisë)

Si katalog në përputhje me nenin 42 paragrafi 2 i KPK për punëtorin vlen përfundimi me sukses i këtyre profileve kualifikuese

1.1 Absolventët e një profili para profesional në sektorin kryesor të ndërtimtarisë me një leje zyrtare të aftësisë në përputhje me nenin 49 të Ligjit federal mbi arsimimin profesional (BBG);

1.2 Drejtues i makinave të ndërtimit me kualifikim në përputhje me rregulloren e provimit për drejtues të makinave të ndërtimit të datës 15 gusht 1988 (duke përfshirë makinistët me kualifikim në kantonet Nojshatel, Valis, Vaud dhe Gjenevë);

1.3 Absolventët e moduleve, në kuadër të «Projekts Spanien/Portugal», të cilat janë vendosur në mes të palëve sociale nëse numri i orëve mësimore të vijuara është së paku 300.

– Të ashtuquajturat «Integrationskurse» llogariten me 100 orë. Pjesa tjetër e kohës duhet të arrihet përmes kurseve kualifikuese të projekteve dhe/apo vijimit të kurseve për punë dore / zanate në ndërtimtari.

– Vijimi i kurseve duhet të dëshmohet.

– Kurset tjerë punëdore/zanati në ndërtimtari të cilat mbahen jashtë vendit mund të llogariten nëse janë të barasvlerëshëm.

– Punëdhënësi duhet të miratojë pjesëmarrjen në modulet dhe kurset dhe të përcaktojë bashkë me punëtorin për vijimin e kurseve që janë të arsyeshme dhe në përputhje me aftësinë dhe me kërkesave të ndërmarrjes. Nëse punëdhënësi ka dhënë miratimin parimor atëherë nuk lejohet të pengohet apo të ndalohej vijimi i kurseve me qëllim të mosarritjes së numrit të duhur të orëve mësimore për klasifikimin në kategorinë e rrogës A të rrogës.

1.4 Absolventët e të tre kurseve bazike për veshjen e mureve për betonim dhe punët e betonit, kanalizimet, përforcimet e unazave dhe pusët, ndërtimi i muraturës në Qendra e Aftësimit Profesional (QAP/SHMN) (Kurset 2311, 2313, 2331 të QAP programit shtesë të kurseve) me vërtetim të QAP/SHMN;

1.5 Absolventët e arsimimit për drejtimin e vinçit me QAP/SHMN dhënie me sukses të provimit. Drejtues i vinçit me leje në përputhje me rregulloren e vinçit, nëse punon më shpesh se herë pas here si drejtues i vinçit.

¹ Zëvendëson katalogun të datës 25 mars 2002 dhe të datës 26 maj 2005.

- Nëse punëtori punon vetëm herë pas here, d.m.th më pak se 20% të ditëve të punës si drejtues i vinçit, atëherë ai ka të drejtë në kategorinë e rrogës B.
- Se a bëhet fjalë për punë herë pas here duhet të merren vesh me shkrim punëdhënësi dhe punëtori në fillim të vitit

1.6 Absolventët e kurseve për punëtorët e shtrimit të rrugëve në Qendrën e Aftësimin Profesional (QAP/SHMN) (Kurset 2313, 2710, 2552, 2555, 2573 të QAP programit shtesë të kurseve) me vërtetim të QAP/SHMN;

1.7 Absolventët e kurseve bazike 1 dhe 2 të Shoqatës Zvicerane të ndërmarrjeve të Shpimit dhe prerjes së Betonit në përputhje me programin e vjetër arsimor, përkatësisht Absolventët e kurseve bazike 1 deri 3 në përputhje me programin e ri arsimor prej korrikut 1997;

1.8 Absolventët e kursit² «Maurer-Grenzgänger SEI-ECAP» (Muratori frontaliери SEI-ECAP) të projektit – Progetto frontaliери dell’Edilizia- të mbajtura pas datës 8 shtator 1994, me vërtetim të zyrës së arsimit profesional të kantonit të Tesinës.

2. Kategoria e rrogës Q (Punëtorë i kualifikuar i ndërtimtarisë me profesion)

2.1 Profesionet e mësuara në degën kryesore të ndërtimtarisë sipas Entit Federal për Formim Profesional (BBT/OFFT/UFFT):

Punëtor i kualifikuar me dëftëse profesionale konfederale (EFZ-CFC) dhe së paku tri vite veprimtari në kantiere zvicerane të ndërtimtarisë (koha e përvetësimit të profesionit pranohet si veprimtari) në këto profesione:

- Murator
- Ndërtues rrugësh
- Shtrues rrugësh me gurë
- Ndërtues themelesh
- Gurore/Gurgdhendës

2.2 Profesionet e përvetësuara të BBT/OFFT/UFFT në repartet ndihmëse në ndërmarrje të sektorit kryesor të ndërtimtarisë nëse ndërmarrja i nënshtrohet fushës së juridiksionit të KPZ-së. Punëtorët me dëftëse profesionale konfederale (EFZ-CFC) dhe së paku tri vite veprimtari në profesion (koha e përvetësimit të profesionit pranohet si veprimtari) nëse gjatë përvetësimit të profesionit janë të punësuar në ndërmarrje të ndërtimtarisë.

Për shembull:

- Elektromekanik
- Mekanik
- Axhustator tubacioni
- Shofer kamioni
- Zdrukthëtar ndërtimtarie
- Zdrukthëtar çatie/marangoz

2.3 Punëtorët me dëftëse profesionale konfederale (EFZ-CFC) në përputhje me shifrën 2.1 dhe 2.2 të këtij katalogu të klasifikimit me mësim të shkurtuar dhe veprimtari trivjeçare në kantieret zvicerane të ndërtimit;

² Në përputhje me praktikën e përhershme të KZPZ mbi klasifikimin e kategorisë së rrogës A, punëdhënësi duhet dhënë pajtueshmërinë e tij për vijimin e kursit.

- 2.4 Punëtorët me dëftesa të huaja profesionale: shihe fletëudhëzimin e KZPZ për pranimin e dëftësave të huaja profesionale (krahaso shtojcën e këtij katalogu);
- 2.5 Poseduesit e dëftësës profesionale konfederale «Prerës i kualifikuar i betonit» në përputhje me rregulloren e provimit të datës 11 maj 1992;
- 2.6 Poseduesit e dëftësës profesionale konfederale «Shëf montues në skelari» në përputhje me rregulloren e provimit të datës 10 gusht 1992;

Fletë udhëzimi i KZPZ mbi pranimin e kualifikimeve profesionale të arritura jashtë Zvicrës

1. Kriteret e pranimit për një klasifikim në kategorinë e rrogës Q

- Kohëzgjatja e arsimimit 3 vite,
- Duhet pjesa praktike dhe teorike/pjesa shkollore
- Arsimimi duhet të jetë përfunduar me një provim, të pranueshëm nga dispozitat e së drejtës publike

2. Kualifikimet ekzistuese të pranuar si të barasvlershme

2.1 Gjermania/Austria

- Arsimimi në një profesion të sektorit kryesor të ndërtimitarisë është i barasvlershëm.

2.2 Italia

- Librezat e shkollës «Scuola tecnica» dhe dëshmia për 1 vit përvojë pune në kantieret e Zvicrës është e barasvlershme.

2.3 Danimarka

- Arsimimi si murator me Letrën e Shoqërisë (Murerfagets Fællesudvalg) të Ministrisë së arsimit është e barasvlershme.

3. Veprimet në raste dyshimi

Nëse arsimimi dhe përvoja profesionale vihen në dyshim përkatësisht nëse bëhet fjalë për librezat profesionale nga vende tjera rekomandohen veprimet në vijim:

- Të kërkohen kopjet e dëftesave me përkthimin e vërtetuar (duhet të sigurohen nga punëtori),
- Të kërkohen sipas mundësisë rregulloret e arsimimit dhe provimet si dhe eventualisht qëllimet e mësimit/planet e orëve të mësimit etj. (duhet të sigurohen nga punëtori),
- Dokumentacioni duhet dërguar në këtë adresë: BBT, Abt. Berufsbildung, Effingerstrasse 27, 3003 Bernë, duke kërkuar një vlerësim të barasvlerësimit.

Shtojca 17

**Marrëveshja shtesë për
sektorin e prerjes së betonit**

Marrëveshja shtesë për sektorin e prerjes së betonit

Shoqata Zvicerane e Ndërmarrjeve për Shpim dhe Prerje të Betonit (SHPB) me pajtim të Shoqatës së Mjeshtëreve të Ndërtimtarisë – dhe ndërmarrjeve të prerjes së betonit me shoqatat e punëtorëve të Kontratës së Përgjithshme të Punës për sektorin kryesor të ndërtimtarisë në Zvicër (KPK) për sektorin e prerjes së betonit lidhë këtë marrëveshje shtesë të KPK:

Kapitulli 1 Të përgjithshme

Neni 1 Pozita ndaj KPK-së

Kjo Marrëveshje shtesë vlen në kuptim të Kontratës së Përgjithshme të Punës si plotësim dhe pjesë integrale e KPK-së sipas nenit 9 të KPK. Nëse kjo marrëveshje plotësuese nuk parasheh rregullore të veçantë, atëherë vlen KPK, respektivisht Kontrata e Përgjithshme e Punës në nivel regional.

Neni 2 Juridiksioni

1 Në aspektin hapësinor dhe të ndërmarrjeve: Kjo marrëveshje shtesë vlen për të gjitha ndërmarrjet në hapësirën e konfederatës Zvicerane. Në aspektin e ndërmarrjeve kjo marrëveshje plotësuese vlen për të gjitha ndërmarrjet të cilat pjesën më të madhe të punës e kryejnë në sektorin e prerjes së betonit (sa i përket aktiviteteve të ndara shih marrëveshjen protokollare mbi nenin 2 të KPK, shtojca 7). Marrëveshja shtesë vlen edhe për ndërmarrjet e huaja për prerjen e betonit të cilat kryejnë punë në Zvicër si dhe për ndërmarrjet që ndërmjetësojnë punëtorë si dhe nën-ndërmarrjet të cilat punësojnë punëtorë në këtë sektor.

2 Juridiksioni personal: Kjo marrëveshje shtesë vlen për të gjithë punëtorët e punësuar në ndërmarrjet sipas pikës 1 të këtij neni (pa marrë parasysh mënyrën e pagesës dhe vendin ku punojnë).

3 Shpallja e obligueshme e Kontratës për tërë degën-fuqizimi.

Neni 3 Zbatimi

Për realizimin, zbatimin dhe kontrollin e kësaj marrëveshjeje shtesë si dhe fondacionit të zbatimit dhe përgatitjes profesionale vlejnë dispozitat e KPK.

Kapitulli 2 Pjesa materiale

Neni 4 Orari i punës dhe koha e udhëtimit

1 Për arsye të raporteve të veçanta në sektorin e prerjes së betonit nenet gjegjëse të KPK-së mbi orarin e punës (neni 23, 24, dhe 54) plotësohen, përkatësisht zëvendësohen përmes këtyre dispozitave

2 Orari vjetor i punës për personelin e kantierit është 2030 orë. Për të gjithë punëtorët tjerë vlen rregullorja e orarit të punës sipas KPK-së.

3 Për punëtorët të cilët udhëtojnë nga shtëpia në vendin e punës (kantier) dhe / apo nga vendi i punës udhëtojnë për në punëtori apo për në shtëpi vlen aktiviteti në vendin e punës si orar i punës sipas pikës 2.

4 Koha e udhëtimit do të kompensohet me një shumë paushall, varësisht nga distanca prej vendit të punës (kantieri) deri në ndërmarrje (magazinë/vendtakim) si në vijim:

Distanca në mes të ndërmarrjes dhe kantierit (distanca ajrore)	njëra rrugë CHF	vajtje ardhje CHF
A Nën 10 km	6.–	12.–
B 10–15 km	12.–	24.–
C 15–25 km	18.–	36.–
D 25–50 km	24.–	48.–
E mbi 50 km	vlen si orar i punës sipas pikës 2	vlen si orar i punës sipas pikës 2

5 Gjithashtu si orar i punës në kuptimin e pikës 2 vlen:

- Puna përgatitore dhe përfundimtare në magazinë punëtorie
- Koha e udhëtimit në mes të dy apo më tepër kantierëve në ditë.

6 Orari maksimal vjetor i punës duke përfshirë kohën e udhëtimit është 2300 orë (për llogaritjen e orëve të përgjithshme vlejnë CHF 24.– kompensim i udhëtimit si një orë e kohës së udhëtimit, CHF 12.– për 1/2 orë udhëtimi etj.).

7 Në regionet kodrinore malore në vend të distancës ajrore, mund të llogaritet distanca efektive rrugore.

Neni 5 Kategoritë dhe zonat e rrogave

1 Në plotësim të nenit 42 të KPK-së personeli ndahet në këto kategori

Kategoria e rrogës

Emërtimi

V (kryepunëtor)

Parakushtet sipas kategorisë së rrogës Q dhe përveç kësaj udhëheqja e dy apo më tepër grupeve dhe bashkëpunimi në përgatitjen e punës.

Q (Prerës i betonit me përgatitje/ trajnues i objektit ndërtues)

Prerës betoni me përgatitje profesionale të njohur në nivel federal sipas rregullores së provimeve më 11.05.92 apo prerës ndërtimtarie me leje të aftësisë apo përgatitje të barasvlefshme profesionale.

A (Prerës betoni)

Punëtor me përvojë gjegjëse profesionale dhe vijimi i së paku dy kurseve bazike të organizuara nga SHPB, sipas konceptit të mëhershëm së paku tri kurse bazike sipas konceptit kualifikues të vitit 1997.

B (Prerës betoni pa përgatitje profesionale)

Punëtor ndërtimtarie pa njohuri profesionale në sektorin e prerjes së betonit, pa leje profesionale, i emëruar nga punëdhënësi nga kategoria e rrogës C në kategorinë e rrogës B (gjatë ndërrimit të punës në një ndërmarrje tjetër punëtorët kanë të drejtë në kategorinë e rrogës B).

C Punëtor ndërtimtarie

Punëtor ndërtimtarie pa njohuri profesionale në sektorin e prerjes së betonit.

2 *Rroga bazë*: Për ndërmarrjet që i nënshtrohen vlefshmërisë së kësaj marrëveshje shtesë, duke përjashtuar nenin 41 të KPK-së së paku vlejshëm pagat bazë në vazhdim (prej datës 1 prill 2012):

Zonat	Kategoritëe rrogave				
	V	Q	A	B	C
E KUQE	6312/37.30 (6281/37.15)	5611/33.15 (5583/33.00)	5402/31.95 (5375/31.80)	5091/30.10 (5066/29.95)	4530/26.80 (4507/26.65)
E KALTËR	6056/35.80 (6026/35.60)	5531/32.70 (5503/32.55)	5327/31.50 (5300/31.35)	4958/29.30 (4933/29.15)	4459/26.35 (4437/26.25)

3 Zonat e pagave: Në zonën e kuqe bëjnë pjesë qyteti Bern si dhe kantonet e Gjenevës, qytetit të Bazelit, Bazel Land, Vadit dhe Cyrih. Regjionet tjera bëjnë pjesë në zonën e kaltër të rrogave.

4 Rrogat e personelit tjetër (magazinë, zyre etj) përcaktohen në bazë individuale në kontratën e punës.

Neni 6 Shtesat e pagës

Si plotësim i nenit 56 të KPK-së të shtunave paguhet një shtesë e pagës prej 30%.

Neni 7 Kompensimi i shpenzimeve

1 *Kompensimi i ushqimit*: Për dallim nga neni 60 i KPK-së të gjithë punëtorëve që punojnë në kantiere i paguhet një shtesë prej CHF 15.– për një racionin kryesor.

Në marrëveshjet regionale / lokale janë të mundshme shtesa më të larta.

2 *Shpenzimet e fjetjes*: Gjatë punës së punëtorëve larg vendbanimit punëdhënësi mund të urdhëroj fjetjen në vendin e punës. Fjetjet jashtë vendbanimit duke përfshirë marrjen e mëngjesit paguhet të gjitha nga punëdhënësi

Kapitulli 3 Dispozitat përfundimtare

Neni 8 Kohëzgjatja e kontratës

1 *Hyrja në fuqi:* Kjo marrëveshje shtesë hyn në fuqi më 1.1.2005 dhe parimisht vlen për aq kohë sa vlen edhe KPK duke përfshirë paragrafin 3 të këtij neni.

2 *Ndryshimet:* Ndryshimet eventuale apo përshtatjet e kësaj marrëveshje shtesë mund të arrihen nga Shoqata Zvicerane e ndërmarrjeve të shpimit dhe prerjes së betonit SHPB me shoqatat përfaqësuese të punëtorëve të KPK-së me pajtimin e SHMN gjatë kohëzgjatjes së juridiksionit.

3 *Prishja e marrëveshjes:* Kjo marrëveshje shtesë mund të priset nga njëra anë nga Shoqata Zvicerane e ndërmarrjeve të shpimit dhe prerjes së betonit SHPB dhe/apo nga shoqatat e punëtorëve që janë pjesëmarrëse në këtë marrëveshje shtesë, duke respektuar afatin tre mujor, gjithnjë në fund të vitit.

Për Shoqatën Zvicerane të ndërmarrjeve të shpimit dhe prerjes së betonit SHPB

W. Autenried, D. Andreoli, M. Dätwyler

Për Shoqatën e Mjeshtërive të Ndërtimitarisë SHMN

D. Lehmann, W. Messmer, H. Bütikofer

Për Sindikatën Unia

H. U. Scheidegger, A. Rieger, J. Robert

Për Sindikatën Syna

E. Zülle, K. Regotz, P.-A. Grosjean

PJESA E PESTË: Adresat e Komisioneve të Paritetit për sektorin Kryesor të ndërtimitarisë

Komisionet lokale paritare të profesionit (PBK-CPP)

Të dhënat tjera nën rubrikën «Kontakte» në faqen e internetit www.svk-bau.ch gjegjësisht nën «contact» në faqen www.cpsa-construction.ch

Kantoni	Komisioni	Rruga, Kodi postar, Vendi	Telefoni Faksi
AG	Paritätische Berufskommission für das Bauhauptgewerbe Kanton Aargau	Graben 10 Postfach 5001 Aarau	062 834 82 82 062 834 82 85
AI AR	Paritätische Berufskommission des Bauhauptgewerbes beider Appenzell	Kornhausstrasse 3 Postfach 1946 9001 St. Gallen	071 227 68 48 071 227 68 49
BE	Paritätische Berufskommission für das Bauhauptgewerbe Bern	Florastrasse 13 Postfach 19 3000 Bern 6	031 350 51 80 031 351 80 61
BE	Paritätische Berufskommission für das Bauhauptgewerbe Biel-Seeland	Florastrasse 13 Postfach 19 3000 Bern 6	031 350 51 80 031 351 80 61
BE	Commission paritaire profession- nelle du bâtiment et du génie civil du Jura bernois	Route de Sorvilier 21 2735 Bévillard	032 492 70 07 032 492 70 34
BL BS	Regio-PBK Paritätische Berufskommission für das Bauhauptgewerbe der Region Basel	Bahnhofstrasse 16 Postfach 1124 4133 Pratteln 1	061 826 98 24 061 826 98 28
FR	Commission paritaire profession- nelle de la construction et du génie civil dans le canton de Fribourg	29, rte A. Piller Case postale 1762 Givisiez	026 460 80 23 026 460 80 25
GE	Commission paritaire genevoise du Gros œuvre (CPGO)	14, rue Malatrex 1201 Genève	022 949 18 18 022 949 18 19
GL	Paritätische Berufskommission für das Baugewerbe des Kantons Glarus	Lämmlibrunnenstr. 41 Postfach 647 9004 St. Gallen	071 446 98 41 071 446 98 44

GR	Kantonale Paritätische Berufs- kommission für das Baugewerbe Graubünden	Comercialstrasse 20 Postfach 110 7002 Chur	081 257 08 00 081 257 08 09
JU	Commission paritaire jurassienne du bâtiment et du génie civil	Chemin de la Perche 2, 2900 Porrentruy	032 465 15 75 032 465 15 72
LU	Paritätische Berufskommission Bauhauptgewerbe Kanton Luzern	Tribschenstrasse 9 Postfach 2268 6002 Luzern	041 360 23 23 041 360 23 03
NE	Commission Paritaire neuchâtoise de la maçonnerie et du génie civil	Les Longues Raies 13 Case postale 148 2013 Colombier	032 843 41 32 032 843 41 31
OW NW	Paritätische Berufskommission Bauhauptgewerbe Kantone Ob- und Nidwalden	Tribschenstrasse 9 Postfach 2268 6002 Luzern	041 360 23 23 041 360 23 03
SG	Paritätische Berufskommission für das Bauhauptgewerbe St. Gallen	Kornhausstrasse 3 Postfach 1946 9001 St. Gallen	071 227 68 48 071 227 68 49
SH	Paritätische Berufskommission für das Bauhauptgewerbe Kanton Schaffhausen	Postfach 280 8203 Schaffhausen	052 625 97 41 052 625 97 49
SO	Paritätische Berufskommission für das Bauhauptgewerbe des Kantons Solothurn	Goldgasse 8 Postfach 226 4502 Solothurn	032 622 64 11 032 623 45 35
SZ	Paritätische Berufskommission Bauhauptgewerbe Kanton Schwyz	Tribschenstrasse 9 Postfach 2268 6002 Luzern	041 360 23 23 041 360 23 03
TG	Paritätische Berufskommission für das Bauhauptgewerbe des Kantons Thurgau	Thomas-Bornhauser- Str. 23 a, Postfach 392 8570 Weinfelden	071 622 36 22 071 622 36 25
TI	Commissione professionale paritetica dell'edilizia e del genio civile del Cantone Ticino	Viale Portone 4 Casella postale n 1220 6501 Bellinzona	091 821 10 60 091 825 48 45
UR	Paritätische Berufskommission Bauhauptgewerbe Kanton Uri	Tribschenstrasse 9 Postfach 2268 6002 Luzern	041 360 23 23 041 360 23 03
VD	Commission professionnelle paritaire de la branche maçonnerie et génie civil du canton de Vaud	En Riond Bosson Case postale 1131 Tolochenaz	021 802 88 88 021 802 88 80

VS	Commission paritaire du bâtiment et du génie civil du canton du Valais	11, rue de l'Avenir Case postale 62 1951 Sion	027 327 32 65 027 327 32 81
ZG	Paritätische Berufskommission Bauhauptgewerbe Kanton Zug	Tribschenstrasse 9 Postfach 2268 6002 Luzern	041 360 23 23 041 360 23 03
ZH	Paritätische Berufskommission Bauhauptgewerbe Kanton Zürich	Sempacherstrasse 15 8032 Zürich	044 385 90 80 044 385 90 81

Paritätische Berufskommission Untertagbau PK-UT (Anhang 12 LMV)

Paritätische Berufskommission Untertagbau (PK-UT) pkut@baumeister.ch	Weinbergstrasse 49 Postfach 8042 Zürich	044 258 83 16 044 258 83 21
---	---	--------------------------------

Schweizerische Paritätische Vollzugskommission des Bauhauptgewerbes SVK-CPSA (Art. 13 und 13^{bis} LMV)

Schweizerische Paritätische Vollzugskommission des Bauhauptgewerbes (SVK) info@svk-bau.ch www.svk-bau.ch	Weinbergstrasse 49 Postfach 8042 Zürich	044 258 84 84 044 258 84 85
---	---	--------------------------------

**Weitere Informationen zum LMV
und zu Vollzugsfragen finden Sie unter
www.svk-bau.ch**

Shënimet